



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

T R A N S K R I P T

**I MBLEDHJES PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË
KOSOVËS, E MBAJTUR MË 25 PRILL 2013**

**SA PLENARNE SEDNICE SKUPŠTINE REPUBLIKE KOSOVA,
ODRŽANE 25. APRILA 2013. GODINE**

**PRILL - APRIL
2013**

Rendi i ditës

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës,
2. Koha për pyetje parlamentare,
3. Miratimi i procesverbalit të seancës së mëparshme,
4. Interpelanca e ministrit të Shëndetësisë, z. Ferid Agani, sipas kërkesës së deputetes Time Kadrijaj, mbështetur edhe nga 9 deputetë tjerë lidhur me gjendjen në shëndetësinë e Kosovës,
5. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për tregun dhe produktet e naftës në Kosovë,
6. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për administrimin e punës në zyrë,
7. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për provimin e jurisprudencës,
8. Zgjedhja e një anëtari në Komisionin për Kërkesa Pronësore,
9. Miratimi i Marrëveshjes së deputetëve nga radha e komuniteteve tjera joshumicë dhe zgjedhja e nënkryetarit të Kuvendit nga këto komunitete.

Dnevni red

1. Vreme za deklarisanja izvan dnevnog reda,
2. Vreme za poslanička pitanja,
3. Usvajanje zapisnika sa prethodne sednice,
4. Interpelacija ministra Zdravstva, g. Ferid Agani, prema zahtevu poslanice Time Kadrijaj, podržan još od 9 drugih poslanika, u vezi sa stanjem u zdravstvu Kosova,
5. Prvo razmatranje Nacrta zakona o tržištu nafte i naftnim proizvodima na Kosovu,
6. Drugo razmatranje Nacrta zakona za administriranje rada u kancelariji,
7. Drugo razmatranje Nacrta zakona o pravosudnom ispitu,
8. Izbor jednog člana u Komisiji za imovinske zahteve,
9. Usvajanje Sporazuma poslanika iz redova ostalih nevećinskih zajednica i izbor potpredsednika Skupštine iz ovih zajednica.

Mbledhjen e drejtoi nënkryetari i Kuvendit, zoti Xhavit Haliti.

KRYESUESI: Të nderuar zotërinj deputetë,

Zonja deputete,

I hap punimet e mbledhjes plenare të Kuvendit të Republikës së Kosovës, sipas rendit të ditës të përgatitur nga Kryesia e Kuvendit, në marrëveshje me kryetarët e grupeve parlamentare.

Fillojmë me pikën e parë të rendit të ditës:

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës

Fillojmë me të paraqiturit për fjalë. Fjalën e ka kërkuar zonja Sahatqija.

TEUTA SAHATQIJA: Faleminderit, nënkryetar!

Unë desha ta përsëris kërkesën e cila ka dalë prej seancës së 28 shkurtit, në të cilën është diskutuar për pensionet e nderprara nga Serbia prej vitit 1999.

Ne e dimë që pas kërkesës, me një vonesë bukur të gjatë, është formuar një komision, por asnjë fjalë, asnjë qëndrim, asnjë mesazh ndaj pensionistëve të cilët janë duke pritur për përgjigje, nuk ka ardhur deri më tash.

Dëshiroj të shfrytëzoj foltoren e Kuvendit dhe dëshiroj që të kërkoj përsëri prej Qeverisë dhe prej Komisionit, i cili është formuar, që t'u japë një përgjigje qytetarëve tanë, pensionistëve tanë të cilët e kanë ndërtuar këtë shtet dhe të cilët padrejtësisht janë të privuar prej të drejtës së tyre për marrjen e pensionit.

Prandaj, edhe një herë dëshiroj që Qeveria, edhe Ministria edhe ky komision të dalë me një qëndrim të qartë dhe të bën të ditur se çka është duke punuar, sa kërkesa kanë ardhur deri më tash, sa kërkesa janë zgjidhur edhe cili është statusi i tyre, cila ka qenë puna e tyre dhe rezultati i punës së tyre deri më sot? Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Muja e ka fjalën.

SHAIP MUJA: Zoti kryesues, faleminderit!

Temën të cilën dëshiroj ta trajtoj sot është e iniciuar me Ditën e Tokës që është trajtuar ndërkombëtarisht nga institucionet ndërkombëtare si ditë e cila popullata përkushtohet që ta mirëmbajë tokën dhe krijohet përshtypja që në Republikën e Kosovës ekzistojnë një numër shumë i kufizuar edhe institucional, po edhe një përkushtim i kufizuar për trajtimin e tokës.

Toka në Republikën e Kosovës duhet të jetë më mirë e trajtuar, e monitoruar dhe me një strategji të qartë, qoftë nga Ministria e Ambientit, qoftë nga Ministria e Bujqësisë, sepse nga kjo pjesë varet edhe shumë shëndeti i përgjithshëm i popullatës. Prandaj, edhe institucionet ndërkombëtare të cilat janë të involvuara në ndihmesën që të analizohen edhe pjesë të kontaminuara të tokës nëpër Republikën e Kosovës, duhet ta kenë me dije

që nëse nuk ngritin institucione, nuk ngritin kapacitete të cilat garantojnë një analizim më të mirë të tokës duke krijuar edhe kapacitetet lokale, duke i aftësuar kapacitetet lokale ekzistuese, por jo vetëm duke sjell nga jashtë disa analistë të cilët përshkruajnë vetëm në mënyrë deskriptive, ne nuk do të kemi asnjëherë një qasje strategjike se si duhet ta trajtojmë tokën dhe si duhet ta planifikojmë çështjen e tokës e cila është një diçka shumë e rëndësishme.

Pika tjetër e cila desha ta diskutoj, është protesta e cila është bërë për nenin 9.2 të Ligjit të duhanit, i cili është kundërshtuar edhe nga unë në leximin e dytë dhe e kundërshtoj prapë, është shkelje e të drejtave të njeriut, dhe po qe se interpretohet drejt nga aspekti juridik ne nganjëherë po nxitohemi e po votojmë, mirëpo nuk po analizohet mirë. Në Bashkimin Evropian vetëm katër shtete nga të gjitha shtetet tjera e kanë këtë ligj, do të thotë, o jemi ne më të mençurit o i kemi plotësuar të gjitha kushtet paraprake për të ardhur për ta plotësuar një ligj i cili nuk është as në prioritet dhe i cili, e lus presidenten që të ketë një arsyeshmëri dhe mos ta nënshkruajë atë ligj dhe ta kthejë në rishqyrtim ose vetëm nenin 9.2 dhe i cili nevojitet që të rishikohet më drejt, qoftë në planin e të drejtave të njeriut, qoftë në planin social, qoftë në planin e planifikimeve të prioritetëve që i ka Republika e Kosovës. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Haxhiu e ka fjalën.

TEUTA HAXHIU: Faleminderit, nënkryetar!

Të nderuar deputetë,

Unë sot do ta ngre një çështje të cilën dje në një gazetë ditore është një shkrim me titull “Ekzekutohen kolegjet”. Është një shkrim që paraqet një shqetësim për mua si deputete, por konsideroj edhe për shumë qytetarë e aq më tepër për studentët e disa kolegjeve.

Po citoj, në këtë shkrim thuhet: “Vendimi i Agjencionit të Akreditimit është një vendim për mbylljen e menjëhershme të dy degëve të paakredituara të Kolegjit „Universum“ në Gjakovë dhe në Prizren, të cilat kanë vepruar ilegalisht, po e përsëris ilegalisht që nga fillimi i vitit akademik përkundër vërejtjeve të bëra nga Agjencioni”.

Gjithashtu, është edhe vendimi tjetër për mbylljen e dy degëve të paakredituara të Kolegjit të Biznesit në Prizren dhe në Vushtrri, gjithashtu që kanë vepruar ilegalisht, pra që nga fillimi i vitit akademik.

Vendimet i janë përcjellë MASHT-it dhe pritët ekzekutimi i tyre.

Është një shqetësim të cilin unë e kam ngritur disa herë në Kuvendin e Kosovës, është një vendim, konsideroj shumë i vonuar. Të fillohet në vitin akademik dhe tani kur është semestri i dytë, të merren vendimet e tilla - kush po pëson këtu? Po pësojnë të gjithë ata studentë, po pësojnë familjet e tyre të cilët po e ndajnë edhe kafshatën e gojës për t'i shkolluar fëmijët e tyre. Ku është Ministria që nuk po i merr hapat me kohë për të mos ardhur deri te kjo gjendje?

Prandaj, është një shqetësim që me të vërtetë konsideroj që ka edhe shumë e shumë vende të tjera që duhet të ndërhyhet.

Unë kam kërkuar edhe në Komisionin për Arsim që Agjencia të vijë e të raportojë. Ka ardhur vitin e kaluar, por ka qenë dashur që Agjencia ta njoftojë edhe Komisionin për këtë vendim, në mënyrë që ne të dalim e të marrim hapa më të shpejtë për të mos ardhur te një gjendje e tillë.

Prandaj, meqë ministri nuk është këtu, unë po e pyes ministrin se kur do të fillojë me ekzekutimin e tyre dhe të na tregojë se a ka edhe shumë degë tjera të cilat janë të paakredituara e studentët e ngratë nuk janë të informuar? Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Hoti e ka fjalën.

AFRIM HOTI: Faleminderit, nënkryetar!

Unë do të ngre një problem rreth bujqësisë, rreth farërave. Mungesa e prodhimit vendor është shumë e lartë dhe shumica e prodhuesve bujqësorë, pemët, perimet, drithërat dhe prodhimet blektorale i importojnë nga vendet fqinje, duke e shndërruar Kosovën kështu në një vend eksportues të parave.

Për mungesën e prodhimeve bujqësore në Kosovë fajtor kryesor është Qeveria e Kosovës. Fara për mbjellje kryesisht importohet nga vendet fqinje. Shpesh ndodh që cilësia e farës e importuar nga Serbia të mos përputhet me të dhënat e shënuara në etiketë, cilësia e dobët e farës së importuar dhe mospërshtatja e farës në kushtet klimatike të Kosovës, është njëri nga faktorët për rendimet e ulëta mesatar që realizohen në Kosovë.

Në rastin më të keq, kjo farë e importuar nga Serbia mund të mos mbijë fare. Në këto probleme kanë hasur bujqit e komunës së Rahovecit, pothuaj se e gjithë puna e tyre pranverore ku bëjnë përgatitjet për mbjelljen e produkteve të tyre bujqësore ka shkuar huq pasi që nuk e kanë numrin e mjaftueshëm të fidaneve për t'i mbjell në arat e tyre.

Si gjithë kategoritë e tjera të shoqërisë edhe bujqit, kjo Qeveri i ka lënë në harresë. Të gjitha farërat e importuara para se të futen në treg, Agjencia e Ushqimit është e obliguar që në kufi të bëjë testimin e farërave. Analizat duhet të bëhen në kushte laboratorike dhe kjo procedurë mund të zgjasë 4 deri në 5 ditë. Si duket farërat që kanë hyrë nga Serbia nuk kanë kaluar nëpër një procedurë të tillë, kjo është e tmerrshme, sepse të gjithë ata bujq që jetojnë nga puna e tyre nuk kanë se çfarë të mbjellin tani në pranverë, përpos konkurrencës së pabarabartë me produktet e vendeve fqinje që subvencionohen në shtetet e tyre, bujqit në Kosovë duhet të ballafaqohen edhe me koston e farës së prishur që vjen nga Serbia. Asnjë shtet normal nuk do të lejonte të ndodhë një gjë e tillë. Edhe ajo farë që importohet nga Serbia dhe që nuk është e dështuar plotësisht, cilësia e saj është shumë e dobët, duke sjellë rendimente shumë të ulëta.

Prandaj, është më se e domosdoshme krijimi i një programi nacional që do ta zhvillonte bujqësinë, sepse bujqësia punëson, prodhon dhe është një kontribut i rëndësishëm i ekonomisë së vendit dhe padyshim ndikon në zhvillimin e përgjithshëm, por këtë duhet ta

bëjë një qeveri e përgjegjshme, që kujdeset për qytetarët e vet. Kjo Qeveri në secilin rast e ka dëshmuar se nuk është e tillë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Halit Krasniqi e ka fjalën.

HALIT KRASNIQI: Faleminderit, kryesues!

Kabinet i nderuar,

Të nderuar deputetë të Parlamentit të Kosovës,

Në këtë sallë të këtij Kuvendi, kemi shumë zhvillime nga më të ndryshmet, prej podiumit të një teatri eksperimental e deri te tabelë-shpallje për deputetët dhe ato probleme dhe preokupime që i ngrenë ata.

Unë nuk dua të merrem me asnjërin nga këto, dua të merrem me një shqetësim që është krijuar nga një lapsus lingua, që është krejt normale dhe është e falshme.

Kjo nuk do të më preokuponte aq shumë dhe nuk do të më shtynte që ta ngre këtë, sikur të mos e dëgjoja dhe të mos e lexoja një akademik që është marrë me këtë lapsus lingua.

Në deklaratën e akademikut Rexhep Qosja, në “Top Chanel”, që deputetët e Kuvendit të Kosovës, për një seancë, edhe kur mungojnë, marrin nga 250 euro, mua më irritoi dhe natyrisht që më lëndoi, sepse kjo nuk është e vërtetë dhe këtë të pavërtetë duhet ta bëjmë publike, sepse shumica prej nesh mund të kenë edhe konflikte edhe me publikun dhe me opinionin me të cilin kemi kontakte përditë.

Unë lus sekretarinë, lus Kryesinë e Kuvendit që ta bëjë të njohur për publikun vërtet sa është i vërtetë ky fakt që është bërë i njohur për publikun padrejtësisht, kështu që kërkoj nga sekretaria e Kuvendit, nga Kryesia e Kuvendit që ta bëjë përmirësimin e kësaj të dhëne publike, e një pavërtete të madhe që neve na atakon dhe na bën natyrisht të mos ndihemi mirë. Faleminderit!

KRYESUESI: Zoti Salih Morina e ka fjalën.

SALIH MORINA: Faleminderit, kryesues!

Të nderuar Kabinet qeveritar,

Të nderuar kolegë deputetë,

Unë sot do ta ngre një çështje e cila ka të bëjë me një shqetësim dhe po ashtu me një kërkesë që bëhet nga afaristët dhe banorët e fshatit të rrethinës së Kijevës, Malishevë, buzë magjistrales Prishtinë-Pejë dhe i drejtohet Ministrisë së Infrastrukturës, me të cilën kërkesë besoj që nga këta afaristë, që iu janë drejtuar kësaj Ministrie, e cila ka të bëjë për mosndryshimin e trasesë së rrugës ekzistuese në fshatin Mleqan deri në dalje të Kijevës, në magjistralen Prishtinë-Pejë, në ndërtimin e magjistrales së re.

Afaristët e bizneseve në këtë magjistrale llogarisin se në rast të ndryshimit të vijës së magjistralsë ekzistuese do të ketë humbje të mëdha për bizneset e tyre e pasojat do t'i bartin edhe mbi 10 mijë banorë të kësaj rrethine që disa prej tyre janë të varur kryesisht nga këto biznese.

Unë kërkoj nga ministri këtu në këtë rast që ta shqyrtojë këtë çështje, sepse të gjitha këto biznese dhe këta afaristë kanë nënshkruar, e kanë vendosur firmën në këtë kërkesë dhe i janë drejtuar këtij institucioni dhe po ashtu me që ministri është këtu unë këtë kërkesë do t'ia dorëzoj edhe ministrit me nënshkrimet e këtyre mbi 60 afaristëve dhe kërkoj që edhe një herë të rishqyrtohet, sepse nga informacionet që kanë edhe këta afaristë dhe këta qytetarë dhe po ashtu nga informacionet që i kam edhe unë, tashmë Qeveria e ka marrë një vendim për shpronësimin, do të thotë për pagesat e shpronësimit të trasesë me devijim, pra me ndryshim. Do të ishte mirë që të kihet parasysh edhe një herë që të analizohet dhe në njëfarë forme të pengohet ky shpronësim, sepse të gjithë këta afaristë të cilët i kanë ndërtuar bizneset e tyre, kanë kryer të gjitha obligimet dhe taksat për kyçje në këtë rrugë, prandaj kërkoj edhe një herë që me mirëkuptimin tuaj ministër, të keni parasysh, sepse qytetarët e kësaj rrethine, do të thotë, humbin bizneset e tyre për të cilët kanë investuar bukur shumë dhe njëkohësisht ka të bëjë edhe me çështjen e punësimit të një numri bukur të madh të qytetarëve të kësaj rrethine të cilët punojnë nëpër këto biznese. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Lama e ka fjalën.

ALMA LAMA: Faleminderit, zoti kryesues!

Qeveria e Kosovës në mënyrë të vazhdueshme deklaron se prioritet i saj është anëtarësimi në Bashkimin Evropian, mirëpo rruga për në BE, përveç sfidave të shumta në plotësimin e standardeve, kërkon edhe plotësimin e disa kriterëve teknike. Një nga detyrat e domosdoshme është përkthimi asquis communautaire që janë ligjet komunitare të BE-s, ligjet substanciale, politikat, legjislacioni primar e sekondar, objektivat, traktatet e rregulloret, gjykimi nga Gjykata Evropiane e Drejtësisë, Keislllo e tjerë. Pra janë rreth 150 mijë faqe. Kjo është një punë shumë voluminoze e cila kërkon edhe një buxhet mjaft të madh.

asquis communautaire është përkthyer në gjuhën shqipe nga Shqipëria dhe në takimet që i kemi pasur ne si Komisioni me deputetë të Shqipërisë, por edhe me Ministrinë e Integrimeve atje, ata janë treguar të gatshëm ta ndihmojnë Kosovën në lidhje me këtë material.

Deri tani Ministria e Integrimeve nuk e ka parë të arsyeshme të bashkëpunojë në këtë drejtim. Unë i kam pyetur, i kam shtruar disa herë pyetje ministres së Integrimeve në lidhje me këtë çështje, mirëpo ajo ka preferuar të mos përgjigjet. Mbase, arsya sepse zonja Çitaku nuk përgjigjet, është sepse ajo dëshiron ta shpenzojë buxhetin të cilin e ka në dispozicion duke angazhuar miq dhe shokët e saj për të përkthyer asquis communautaire. Që kjo Qeveri nuk ka asnjë respekt për mënyrën se si e shpenzon buxhetin, është marrë vesh prej kohësh, mjafton të shohim sot mediet dhe do të shohim se vetëm në tremujorin e parë Qeveria e Kosovës, vetëm për udhëtime ka shpenzuar mbi 2 milionë e 100 mijë euro. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Rexhepi e ka fjalën.

EMILIJA REXHEPI: Zahvaljujem, poštovani predsjedavajući!

Uvaženi ministri,
Kolege poslanici,
Poštovani građani,

U materijalu koga smo danas dobili od strane Nezavisne komisije za medije odnosno predsednika Šefki Ukaj, stoji da je pomenuta komisija 15 februara 2013. godine donela odluku o objavljivanju liste slobodnih frekvencija za radio i lokalne tv stanice, gde je među ostalog dobijena lokacija za Rečane, što Bošnjačkoj zajednici u ovom trenutku znači puno zbog buduće lokalne samouprave kako bi stepen pružanja informacija i pokrivenost signala tog područja napokon bio pokriven.

Koristim priliku da se u ime Bošnjačke zajednice Župskog kraja zahvalim Komisiji za nezavisne medije na dobijenoj frekvenciji. Zahvaljujem se!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Idrizi e ka fjalën.

NIJAZI IDRIZI: Faleminderit i nderuari kryesues!

Të nderuar ministra,

Të nderuar deputetë,

Pikat kufitare me Luginën e Preshevës të ngjajnë me një gjendje lufte. Kushdo që kalon aty vërehen qytetarë që mbajnë fëmijë në krahë, që kanë çanta, thasë nëpër duar dhe i kalojnë ato pikërisht sikur në kohën e luftës.

Kjo po ndodh për shkak se ata njerëz kanë nevojë që ta vizitojnë Kosovën ku i kanë lidhjet familjare dhe miqësore.

Arsyeja pse ndodh kjo është se për qytetarët e të dy anëve janë aplikuar tarifa të larta të sigurimeve të makinave për të cilën gjë është folur disa herë në këtë Parlament.

Nuk është normale një makinë që të sigurohet për një vit qytetari të paguajë rreth 800 euro. Ju jeni në dijeni për shkak të krizës së madhe ekonomike pjesa më e madhe e qytetarëve të asaj ane janë të papunë.

Kohëve të fundit kanë filluar që të ndiqen njerëzit edhe nëpër komunën e Gjilanit dhe të Kamenicës nëse zihen që nuk i kanë përmbushur këto obligime. Ata madje dënohen edhe me nga 150 euro që duket se është diçka e padrejtë.

Pak vende, pak hapësira, pak regjione gjen në botë ku një pjesë e popullsisë siç ka qenë ajo e Luginës së Preshevës, pothuaj se të gjithë kanë shprehur vullnetin e tyre që të bashkohen me Kosovën, ata madje kanë organizuar referendum, kanë organizuar edhe luftë të armatosur dhe një vend si vendi ynë asaj dashurie, asaj dëshire të tyre t'i kthehet me një qasje të tillë refuzuese.

Do t'i kisha lutur institucionet përgjegjëse që këta njerëz t'i lirojnë nga këto tarifa të larta dhe ata të paguajnë tarifa që i paguajmë ne si qytetarë tanë, sepse në të vërtetë për qytetarët serbë edhe të kësaj ane dhe të asaj ane një gjë e tillë nuk po ndodh, ata janë të

favorizuar, janë të diskriminuar pozitivisht dhe paguajnë vetëm 200 euro për sigurimet njëvjeçare të makinave.

Ne duhet ta tërheqim një paralele dhe ta aplikojmë edhe një reciprocitet në këtë pikë me qëllim që edhe qytetarët shqiptarë të asaj ane dhe këta këtej të paguajnë tarifa të njëjta dhe të kenë mundësi të qarkullojnë lirshëm dhe lirë nëpër të dyja anët e kufirit. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Hamiti e ka fjalën.

SABRI HAMITI: Faleminderit, zoti nënkryetar i Kuvendit!

Kolegë të nderuar,

Në disa ditët e fundit kam marrë një letër elektronike me të njëjtin tekst, të përsëritur në një afat kohe nga dy javë, të cilën e shkruan në emrin tim këtu në Kuvend, preshevari i dëshpëruar, Muhamet Ibrahim - Rahovicë, Preshevë.

Unë për kah natyra, letra personale nuk përcjell për njerëzit që s'i njoh, por meqë problemi i tij është, nuk është i tij, po ai e artikulon si individ dhe mua më drejtohet mendoj si deputet e jo si individ, atëherë unë ndjej nevojë që këtë përgjigje ta jap këtu në Kuvend, e jo me rrjeta sociale ose portë elektronike.

Po i bie shkurt, zoti Muhamet Ibrahim, në të vërtetë e shkruan një letër me mjaft emocione, sepse ai edhe e nënshkruan – preshevari i dëshpëruar, dhe unë nuk po hy të lexoj emocionet. Po unë po përkujtoj që pak a shumë këto mblidhen: a mendoni për ne, a na doni, a s'na doni, pak a shumë, është pak më i qëndisur teksti, po kjo është esenca.

Kjo ka të bëjë me çfarë bëjmë ne dhe çfarë mund të bëjmë ne për situatën e shqiptarëve në Preshevë, ose siç po thuhet - Luginën e Preshevës? Dhe këto kanë të bëjnë me problemet e tyre, të statusit të tyre, problemet e nevojave të tyre, problemet e qarkullimit të tyre kah Kosova dhe çështje politike, më në fund të fundit.

Unë, zotit preshevar të dëshpëruar, Muhamet Ibrahim nga Rahovica e Preshevës, i them nga kjo foltore që Kosova, po duhet të mendojë, për iniciativa ligjore, madje edhe vendime institucionale të cilat do të mund të krijojnë lehtësi të qarkullimit të preshevarëve në Kosovë ashtu siç qarkullojnë të gjithë qytetarët tjerë, pa tarifa të veçanta, pa kushtëzime të veçanta.

Kosova, në institucionet e veta, sidomos arsimore, mund të përshpejtojë që diplomat e tyre të bëhen të vlefshme për të konkurruar për punë.

Kosova, në kuptimin politik dhe unë personalisht nga kjo foltore po i drejtohem këtij dhe atyre të cilët ky i mbron...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Ia jepni edhe 15 sekonda!

SABRI HAMITI: ...se mund ta vazhdoj, po ma jep frazën e fundit.

Me lëvizjet e fundit, të quajtura normalizimi Kosovë-Serbi, është shansi i drejtuesve të Luginës së Preshevës që të kërkojnë të drejtat e tyre reciprokisht me serbët në Kosovë dhe është detyrim moral dhe parimor i bashkësisë ndërkombëtare që është e involvuar në këto bisedime e normalizime dhe e Qeverisë së Kosovës dhe institucioneve të Kosovës, që t'i mbështetin në të drejtat e tyre të qarkullimit të lirë dhe në statusin e tyre politik dhe social. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Bytyçi e ka fjalën.

KYMETE BYTYÇI: I nderuar, zoti kryesues,
Të nderuar kabinet qeveritar,
Të nderuar kolegë deputetë,

Sot do të flas për një kategori të njerëzve që ishin në krye të proceseve që ranë për lirinë, pavarësinë dhe demokracinë e Kosovës, njerëz këta që asnjëherë nuk u zbuluan kush i vrau, drejtësia u bë e verbër edhe pse dihet se kujt i penguan këta janë dëshmorë, i pëlqeu dikujt apo jo.

Pra, do të flas për Fehmi Aganin, Xhemajl Mustafën, Enver Malokun, Shaban Manën, Ismet Racin, Ukë Bytyçin, Smajl Hajdarin e Tahir Zemajn. Këto personalitete ishin në krah të presidentit historik të Republikës së Kosovës, pra të doktor Ibrahim Rugovës, i cili edhe i ka dekoruar këto figura me Medaljen e Artë të Pavarësisë, për kontributin e dhënë për lirinë, pavarësinë dhe demokracinë e Kosovës. Mirëpo, fjalët e tyre, ende pra këto familje, ende nuk e gëzojnë asnjë status dhe përkujdesje me institucionet, pra të shtetit të Kosovës.

Qeveria dhe Kuvendi i Republikës së Kosovës e kanë për obligim që këto kategori të veprimtarëve dhe luftëtarëve të shquar që u vranë në përpjekje për ndërtimin e institucioneve demokratike dhe jetësimin e idealin e lirisë dhe të pavarësisë, t'i trajtojnë me ligj, duke u njohur statusin e dëshmorëve të kombit, sepse kontributi jetësor i këtyre personaliteteve të shquar kombëtar dhe shkrirja e jetës së tyre për çështjen kombëtare duhet të vlerësohet nga institucionet e Republikës së Kosovës, ashtu siç janë duke u respektuar nga populli i Kosovës.

Zoti kryesues,

Ju dhe të gjithë ne i njohim kontributet e këtyre burrave të shquar, andaj ju takon juve dhe këtij Kuvendi që t'i rekomandojë Qeverisë së Republikës së Kosovës që t'iu përcaktojë statusin e dëshmorit të kombit këtyre personaliteteve të shquar kombëtar. Nëse kjo nuk bëhet nga ana e juaj, atëherë unë së bashku me disa kolegë deputetë do të ndërmarrim një nismë në të cilën do t'i drejtohem me një kërkesë formale kryeministrit të Qeverisë së Republikës së Kosovës, që t'i japë zgjidhje kësaj çështjeje njëherë e përgjithmonë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Balje e ka fjalën!

HAMZA BALJE: Zahvaljujem se!

Poštovani predsedavajući,

Poštovani Vladin kabinet,

Kolege zastupnici,

Znamo da se od sledeće školske godine uvodi 12 godišnje osnovno i srednje obrazovanje koje će biti obavezno. Međutim ove godine imamo i 13 razred koji završava a imaćemo ga i uporedo sa 12 koji će maturirati sledeće godine zajedno sa njima tako da će biti 12 i 13 razred diplomske generacije.

Ova generacija je nakon rata prošla sve faze reforme u obrazovanju, počevši sa 7 godina svoje osnovne obrazovanje, onda i dodati 9 razred u osnovnoj školi a sada i 13 u srednjoj. U ime roditelja iz Bošnjačke zajednice, koji smatraju da za ovu generaciju 13 razred uzaludno gubljenje vremena, opterećenje za učenike kao i za roditelje, sačinili smo i zahtev i dostavili ga Ministarstvu za obrazovanje na razmatranje. Međutim do dan danas nismo dobili nikakav odgovor od kompetentnih organa i imajući u vidu ove zahteve roditelja, obraćam vam se još jednom sa ovim zahtevom da se ova prelazna faza prevaziđe i omogući se ovim učenicima da polože makar dopunske ispite da bi istekli pravo na diplomu, kako bi nastavili svoje studije, imajući u vidu da je u pomenutim reformama ova generacija već izgubila dve godine. Zahvaljujem se.

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti ministër Mujota, dëshiron ta marrë fjalën.

MINISTRI FEHMI MUJOTA: Faleminderit, i nderuari nënkryetar!

Të nderuar anëtarë të kabinetit të Qeverisë,

Të nderuar deputetë,

I nderuari deputet Salih Morina,

Shqetësimin që e keni ngritur dhe kërkesën që sapo e dorëzuar në emër të afaristëve dhe të banorëve të fshatrave prej Mleqani deri në Kijevë, zyrtarisht e mora tash nga ju, meqë është seancë publike, por kemi pasur informacion brenda Ministrisë për një kërkesë të tillë dhe e ndjej për obligim që të sqaroj juve, publikun po edhe nënshkruesit e kësaj kërkesë, në këtë rast, se projekti nacional i rrugës magjistrale Prishtinë – Pejë, është një projekt i cili ka marrë një mbështetje të plotë nga Kuvendi i Kosovës dhe është një ndër prioritetet e Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe prioritet i Ministrisë së Infrastrukturës për Ndërtim.

Ne ndihemi shumë mirë që këtë vit kemi mundësi që të bëjmë zgjerimin nacional, përkatësisht magjistrale Prishtinë-Pejë edhe për më tepër se 9 kilometra dhe bëhet fjalë për aksin rrugor në të cilin nuk ka pasur projekt, i cili duhet bërë në mënyrë profesionale dhe Ministria i ka marrë të gjitha masat e duhura, ka angazhuar një kompani projektuese, kompaninë “Proing”, e cila e ka bërë projektin mbi bazën e të gjitha fakteve dhe natyrisht edhe mbi bazë të gjendjes në terren.

Prandaj ne si Ministri dhe unë si ministër, nuk e mbaj të drejtën, nuk e kam të drejtën as përgjegjësinë për të ndërhyrë në projektet profesionale. Kjo është një zgjidhje projektuese, një zgjidhje e cila e ka gjetur zgjidhjen më të mirë duke iu përshtatur terrenit dhe natyrisht duke pasur për bazë standardin e kësaj rruge që duhet të ndiqet, duke pasur

për bazë sigurinë për qytetarët dhe duke pasur për bazë natyrisht edhe elementet tjera plotësuese siç janë vlerësimet e larta për shpronësimet ose problemet shpronësore.

Prandaj, zgjedhja përkatësisht projektimi është i njësisë për projektim në mënyrë profesionale, vendimi i Qeverisë është i ligjshëm për shpronësimet të pronave përgjatë segmentit ku do të kalojë kjo rrugë dhe ne jemi të obliguar që të vazhdojmë me projektin. Prandaj, ne e kuptojmë shqetësimin e biznesmenëve, në këtë rast të afaristëve, që janë përgjatë kësaj rruge, por në qoftë se e ndjekim këtë logjikë, atëherë ne sigurisht se do të ballafaqoheshim me kërkesat tjera të ngjashme sikur që është fjala edhe për ndërtimin e autostradës Prishtinë-Shkup, ndoshta do të vijnë kërkesat që autostrada duhet të kalojë përgjatë rrugës ekzistuese, por projekti është diku tjetër dhe duhet ta zbatojmë plotësisht ashtu siç është projekti.

Dhe meqë jam në foltore, të nderuar deputetë, e ndjej të nevojshme që një shqetësim të ngritur këtyre dy ditëve, ta bëj publike për opinionin dhe mbi të gjitha në Parlament dua ta them këtë dhe jo përmes medieve ose nëpërmjet intervistave apo deklaratave tjera që janë pjesë e tjetërkujt në kuptimin profesional.

Është raportuar për një vjedhje në ndërtesën ku aktualisht është Ministria e Infrastrukturës e vendosur dhe ka pasur përpjekje që të prezantohet si një diçka shumë skandaloze, unë ndjej për obligim që publiku të jetë i informuar në kohë dhe të bëj me dije se çka, për çka bëhet fjalë në këtë rast.

Sipas një raportimi që ka bërë një zyrtar i Ministrisë së Infrastrukturës në të cilin objekt ndodhin edhe shumë institucione tjera dhe në të cilin kanë qasje edhe shumë e shumë zyrtarë tjerë dhe të njerëzve - palë të shërbimeve në këtë objekt, ka raportuar në momentin kur ka dalë në vendin e punës se në zyrën e tij kanë humbur disa gjësende personale të tij, kanë humbur, është thyer faktikisht kasaforta në të cilën janë gjetur në këtë rast në vlerë prej 10 deri 15 euro mbushje telefonike dhe diploma origjinale e zyrtarit. Domethënë, është kjo deklaratë e zyrtarit, zyra e të cilit është thyer, është vjedhur apo sido që e quajmë. Ne si akt, si veprim e gjujmë shumë dhe kemi kërkuar nga autoritetet e ndjekjes që ta vërtetojnë këtë rast, të shohin se për çfarë bëhet fjalë, a është fjalë për një vjedhje, thjeshtë si një vjedhje që për fat të keq ndodhin në vendin tonë, qoftë edhe brenda institucioneve, a bëhet fjalë për motive tjera, kjo është çështje e organeve të ndjekjes, por nuk bëhet fjalë për humbje të kurrfarë vlerave financiare, nuk bëhet fjalë për çëqe financiare apo gjëra tjera, të cilat kanë mund të ngritin shqetësim në opinion. Por, për më tepër si ministër më takon të them që kam bërë kërkesën që të zbardhet rasti deri në fund dhe pavarësisht të dëmit material që mund të jetë shumë i vogël, dëmi moral mund të jetë jo i vogël për thyerjen ose vjedhjen brenda një zyre të një zyrtari të Ministrisë. Prandaj, ndiej nevojën ta njoftoj publikun drejtpërdrejt.

Dhe, po ashtu, edhe për një çështje tjetër që ndoshta ka nevojë sërish të sqarohet pak më tepër publiku, ditëve të fundit kemi pasur një debat, ndoshta jo shumë të duhur përmes rrugës së interpretimeve ose komenteve mediale, në raport me Komisionin për Mbikëqyrjen Financiare.

Unë ju them si ministër i Ministrisë së Infrastrukturës, me korrektësinë më të madhe, u jam përgjigjur të gjitha kërkesave, secilit do komision, sidomos Komisionit Funkcional Mbikëqyrës, që e mbikëqyrur Ministrinë e Infrastrukturës, por edhe Komisionit për Mbikëqyrjen e Financave me transparencën më të lartë brenda detyrave, obligimeve, përgjegjësi dhe atë që e përcakton ligji.

Të nderuar deputetë,

Meqë ka qenë një kërkesë e Komisionit për Buxhet e Financa që të ketë një qasje përkatësisht të bëjë interpretimin sipas ligjit që e ka Komisioni rreth të gjeturave të Auditorit të Përgjithshëm, ne kemi bërë shpjegimin e detajuar para Komisionit për Buxhet, për Mbikëqyrje të Financave.

Por, megjithatë, ka pasur një kërkesë që disa prej projekteve në të cilat nuk ka pasur qasje Auditori i Përgjithshëm, të ketë më tepër njohuri Komisioni për Buxhet dhe Financa, që është përkatësisht Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave, që është shumë korrekte, shumë e drejtë dhe ne e kemi dhënë edhe përgjigjen zyrtarë edhe përgjigjen drejtpërdrejt. Dhe, unë dua të ju sjell vetëm disa fakte që, ndoshta në këtë rast nuk është mënyra më e duhur, por megjithatë Parlamenti është vendi ku ministrat duhet të flasim dhe deputetët duhet t'i sqarojnë gjërat.

Gjatë kohës prej marrjes së mandatit tim si ministër i Infrastrukturës, për hir të informimit të publikut, dua të ju bëj me dije se në adresë të Ministrisë së Infrastrukturës, përkatësisht në adresë të ministrit kanë ardhur 7 kërkesa me data të caktuara, prej datës 11 gusht 2011, të nderuar deputetë, deri në datën e fundit 17 prill 2013 drejtuar nga EULEX-i për hetimin që është e njohur publikisht se tash e tri vite vazhdon në Ministrinë e Transportit dhe Telekomunikacionit dikur, Ministria e Infrastrukturës tani. Dhe mbi bazën e të gjitha obligimeve ligjore dhe mbi bazën e të gjitha përgjegjësi institucionale ne kemi qenë korrekt në ofrimin, në bashkëpunimin dhe në dhënien e të gjitha atyre të dhënave për të cilat kanë qenë të interesuara këto organe të drejtësisë, përkatësisht këto organe që po e hetojnë këtë rast. Dhe ne nuk kemi dashur në asnjë mënyrë, sikur që edhe sot, tani e konfirmoj, që të mos ndikojmë në asnjë mënyrë as në të keqen e këtij rasti dhe të jemi korrekt në ofrimin e fakteve që gjërat të zbardhen si duhet. Por ka një parim i cili mbron të drejtën e institucionit që të mos bëjë publike secilin rast prej tyre. E natyrisht që edhe EULEX-i këtë rast e ka pasur parasysh dhe nuk e bën publike çdo detal dhe çdo informatë që shkon.

Prandaj, për këto kërkesa që i ka bërë EULEX-i, të kemi parasysh, bëhet fjalë për një hetim të mëhershëm të cilin nuk duhet ta lëndojmë në asnjë mënyrë, nuk duhet të marrim rol mbi prokurorinë askush, as në Kuvend, as në Qeveri dhe askund, secili të bëjë punën e tyre.

Dhe desha të ju informoj se në vazhden e atyre kërkesave që ne shpresojmë të përfundojë si një proces dhe të shohim se çfarë krejt është puna e saj, Auditori i Përgjithshëm nuk ka pas qasje në disa prej këtyre projekteve dhe ka dhënë raportimin e tyre. Edhe ne e kemi informuar Komisionin mbikëqyrës për financa, ndërsa që tani publikisht Komisionit për mbikëqyrje të financave i them që nga të gjitha dokumentet, në të gjitha procedurat e

zhvilluara brenda Ministrisë, të cilat kanë ndodhur në këtë periudhë kohore, janë jo të lirë, por ata e kanë edhe detyrë, kanë përgjegjësi dhe kanë të drejtë, ndërsa edhe ne po ashtu jemi të obliguar, jemi përgjegjës për këtë dhe jemi të detyruar që të ofrojmë të gjitha të dhënat dhe do të keni qasjen e plotë, por kujdes, të mos e marrim rolin e atyre që nuk e kemi. Domethënë, as Kuvendi, as Qeveria, t'i lëmë gjërat të zhvillohen ashtu siç është e paraparë dhe të jemi korrekt në raport me Auditorin, në raport me Komisionin, në raport me Qeverinë dhe në raport me Ministrinë.

Dhe, po ashtu, një informatë plotësuese për këtë, meqë bëhet fjalë për 7 projekte siç thuhet, për mirëmbajtjen e rrugëve, të cilat po ashtu EULEX-i e ka pasur një kërkesë për të pasur qasje çfarë ka ndodhur, ndjej për obligim të informoj publikun se kjo është një kontratë për vitin 2011 - 2012 dhe po të varej nga vullneti personal i ministrit ose nga vullneti politik, ju them me përgjegjësinë më të madhe, që ato kontrata do i kisha ndërprerë, për shkak se nuk kam qenë shumë i kënaqur me kualitetin që bëhet mirëmbajtja e rrugëve, por ligji nuk e mundëson një gjë të tillë, ligji thotë ndryshe, dhe unë dua të respektoj ligjin dhe dua të mos ketë asnjë ndërhyrje në organet të cilat janë përgjegjëse për këto, në këtë rast Departamenti i Prokurimit dhe, unë publikisht e them, që nëse duhet të kemi kujdes që politika të mos ndikojë në organet të cilat kanë përgjegjësi të plotë

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Edhe një minutë, ju lutem!

MINISTRI FEHMI MUJOTA: ...t'i përmbahet plotësisht kësaj dhe përkundër një vendimi tim që ato kontrata të ndërpriten, të shkohet një proces i ri, megjithatë organi shqyrtues i prokurimit, të nderuar deputetë, ka marrë vendim i cili e obligon Ministrinë e Infrastrukturës që të vazhdojë ato kontrata. Ka vepruar drejt apo s'ka vepruar drejt, nuk është çështje ime që të gjykoj, prandaj e ndjeva për obligim të informoj Kuvendin, të njoftoj publikun për të gjitha këto zhvillime dhe të jem korrekt në raport me Kuvendin, me Komisionin, natyrisht edhe me publikun. Faleminderit shumë.

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Morina ka kërkuar replikë!

SALIH MORINA: Faleminderit kryesues!

Unë vetëm desha ta sqaroj vetëm opinionin dhe ministrin se në këtë Kuvend ndryshimi i trasesë do të thotë nuk është marrë kurrfarë vendimi, do të thotë nuk ka ardhur që në Kuvend të bëhet ndryshimi i kësaj trasesë. Unë edhe një herë e përsërita, thashë është interes i atyre 70 afaristëve - 70 bizneseve për të cilat nëse bëhet devijimi dhe shkon, do të thotë, në kahe tjetër atëherë unë e di shumë, dhe jam i sigurt, dhe ju e dini që do të jetë shumë më i kushtueshëm. Prandaj skicat në rrugën aktuale e cila është ekzistuese, do të thotë kanë qenë të vendosura qysh më herët dhe nëse ka të bëjë këtu diçka me grupin e interesit do të thotë është mirë që të dihet, zoti ministër, se vendim në këtë Kuvend nuk është marrë asnjëherë për ndryshimin e asaj traseje, prandaj shqetësimi i qytetarëve do të thotë është me vend që përpos shuarjes së këtyre 70 afaristëve - 70 bizneseve do të thotë kemi edhe humbje me vende të punës, siç e theksova edhe më herët. Faleminderit shumë!

KRYESUESI: Zoti ministër, urdhëro!

MINISTRI FEHMI MUJOTA: I nderuar deputet, ndoshta nuk jam kuptuar drejt, ndoshta nuk e kam thënë saktësisht ashtu siç është dashur ta them, por unë nuk thashë që Kuvendi ka marrë vendim për ndryshim të trasesë dhe nuk ka nevojë Kuvendi të marrë vendim për ndryshim të trasesë së rrugës magjistrale. Kjo çështje është thjesht profesionale e Ministrisë e cila bën projektimin dhe unë si ministër nuk e marr përgjegjësin që zgjidhjen profesionale inxhinierike ta ndikoj, të ndërhyj ose ta ndryshoj për çështje të interesit të një grupi që ju, siç e quani, grup i interesave. Prandaj, nëse aludimi është se ka grup interesi që mendon se duhet ndryshuar kjo trase, atëherë po ashtu aludimi mund të jetë se ka grup interesi i cili dëshiron me çdo kusht të shkojë në këtë drejtim, sepse do të ketë një shpronësim jashtëzakonisht të lartë në këtë segment rrugor. Po kjo nuk është bërë vetëm për shpronësimin që është një prej elementeve, por është bërë për çështje të sigurisë, për çështje të standardit të rrugës dhe unë nuk mund ta ndryshojë këtë vendim që e ka marrë Ministria për Projektim, dhe ne duhet ta zbatojmë këtë projekt, i cili është ofruar për Ministrinë.

Prandaj, unë besoj se zgjidhja do të jetë e mirë edhe për qytetarët e këtyre fshatrave, por edhe për të gjithë Kosovën, sepse është një aks rrugor i cili ka një fluks shumë të madh të lëvizshmërisë së automjeteve në komunikacion. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Sadriu e ka fjalën.

ALI SADRIU: Faleminderit, zoti kryesues!

Problemin që e ngriti ministri është një problem që ne kemi pretenduar dhe pretendojmë ta sjellin raportin komplet me të dhëna konkrete, me dokumente konkret.

Problemi rreth autostradës është problem që e ka ngritur “Vetëvendosja” disa herë në Kuvend me kërkesë që duhet të sillët kontrata e auto-rrugës. Problemin mandej e kanë ngritur kongresmenët amerikanë gjatë vizitës që na e kanë bërë dhe kanë kërkuar nga unë si kryetar i Komisionit, prezentë kanë qenë edhe disa deputetë që unë po i shoh këtu dhe do që nuk janë këtu, por ajo është e incizuar, me shumë argumente kanë kërkuar sqarime të gjithë këtij procesi.

Përgjigja jonë ka qenë kjo: Autorruga është një prioritet mbi prioritete dhe është sqaruar gjerësisht, por nuk do të lejojmë në momentin kur i kemi të dhënat që në emër të saj të ketë diçka që opinionin të mos njoftohet.

ZAP-i e ngre këtë problem dhe në raportin e vet thotë se 7 kontrata, duke e përfshirë edhe auto-rrugën “Ibrahim Rugova” janë në proces të hetuesisë nga EULEX-i.

Ne organizojmë dëgjim publik, sepse domi ta kemi edhe medaljen tjetër, dhe e kemi edhe deklaratën e ministrit ku i premtim Komisionit se do të na i sjellë të gjitha kontratat.

Mandej kemi pritur një kohë dhe ne nuk e kemi pasur kontratën. Në emër të Komisionit kam kërkuar që Ministria t'ia sjell Komisionit këto kontrata për t'i analizuar, për ti parë. Ministri na përgjigjet se këto kontrata nuk mund t'i kemi, sepse janë në proces të hetimit.

Për të gjitha këto janë dokumentet, ju lutem. Është raporti i Auditorit, është procesverbali i mbledhjes së dëgjimit publik dhe është shkresa që unë i kam dërguar në emër të Komisionit dhe është shkresa e ministrit që e ka sjellë, janë dokumentet.

Unë sot kam kërkuar dhe ministrit i kam bërë një adresim të ri. Meqë nga mediet është ngritur se kjo kontratë nuk po hetohet në EULEX të më bjerë shënime a është apo nuk është. Nëse nuk është, pse na njoftojnë se është? Pse fshihet atëherë? Nëse realisht është aty, pse nuk na sillet kontrata?

Ne e kemi për qëllim vetëm për ta shikuar, për të bërë analizë e komente. Nuk kemi të drejtë ne të bëjmë analizë pa e parë kontratën. Prandaj ky është një proces në vijim dhe ne do ta shtyjmë deri në skaj, sepse jemi përgjegjës para popullit, para këtij Kuvendi dhe para miqve tanë. Është një projekt me rëndësi të veçantë dhe ne do ta trajtojmë me rëndësi të veçantë. Dokumentet janë aty, populli thotë: “nëse pitja është hëngër, tepsia ka mbetur”.

(Mbledhjen e merr nën drejtim kryetari i Kuvendit, zoti Jakup Krasniqi.)

KRYETARI: Faleminderit! Fjalën e ka ministri Mujota.

FEHMI MUJOTA: Faleminderit, i nderuar kryetar!
I nderuari deputet Sadriu, po e përsëris edhe një herë.

Që nga tani, krejt çka ka kërkesa Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave le të urdhërojë e t'i marri të gjitha dokumentet, ashtu si e parasheh ligji, vetëm mos të kërkonin që unë të dal mbi ligjin, mbi ligjin nuk dal!

Krejt do t'i keni ato, të plota dhe ju e keni harruar edhe një fakt se kontrata kur është nënshkruar për autostradën ka qenë një Komision ndërministror, atëherë në përbërje të ministrave, kryesisht të Partisë Demokratike, të Lidhjes Demokratike dhe të grupeve të partive pakicave kombëtare në Kosovë.

Me sa di, ka qenë edhe zoti Lutfi Zharku, anëtar i këtij Komisioni, bashkë me Fatmir Limaj, Mahir Yagcillarin, Ahmet Shalën dhe nuk e di edhe kush tjetër. Pesë veta, më duket, kanë qenë anëtarë të Komisionit. Dhe kjo kontratë, e nënshkruar atëherë dhe deri tani, ka ngritur shumë gjëra të panevojshme në publik, mendoj.

Nuk kam asgjë për të fshehur unë si ministër, nuk kam për të fshehur asgjë as për projekte tjera që do të vijnë, vetëm duhet të përmbajë rregullat e plota që i përcakton ligji, që i përcaktojnë kontratat ndërkombëtare dhe që përcaktojnë proceset e mundshme për të cilat tash edhe ndodhet Kosova dhe unë s'dua të ndërhy në këto.

Prandaj, unë po ju siguroj që ju si Komision për Mbikëqyrje të Financave do i keni të gjitha dokumentet, madje edhe më shumë se që ju mendoni se mund të ofrojmë dhe në çdo kohë, por në asnjë mënyrë të mos ndërhyjmë në procese për të cilat nuk jeni përgjegjës as ju, e as unë. Duhet ta ruajmë këtë vijë të cilën na ka përcaktuar mandati dhe autoritetet e përgjegjësitë të cilat i ushtrojmë të gjithë së bashku.

Ndërsa, në qoftë se ka motive që unë nuk e besoj, motive të caktuara tjera, qoftë politike, e ju them se nuk është koha tani për të bërë këto gjëra, sepse faktet kanë folur, faktet sërish do të flasin dhe unë do të jem i përgjegjshëm që të përgjigjem, të raportoj për çdo gjë për të cilën jam përgjegjës, por jo për ato për të cilat nuk qenë pjesë, nuk jam pjesë dhe nuk jam i obliguar të përgjigjem. Faleminderit!

KRYETARI: Replikë, deputeti Ali Sadriu.

ALI SADRIU: Zoti ministër,

Ju jeni ministër i kësaj Ministrie dhe të gjithë komunikimin ne do ta bëjmë me ministrin aktual, pavarësisht procesit në të cilin ka ndodhur.

Këto sqarime që i dhatë janë të mira, ne presim të realizohen konkretisht. Pra, është fjala që t'i dërgoni kontratat për t'i analizuar.

Për neve nuk e lehtëson, edhe për opinionin, edhe për Kuvendin aspak, sepse nuk kemi pretendime në ministrin, po kushdo që e ka bërë atë, nëse eventualisht ka diçka që duhet të vërehet, është shumë mirë që ne, dhe e kam fjalën edhe për Grupin ndërministror, nëse është përgjegjës le të adresohet, për shënimet ne në asnjë rast nuk kemi dalë jashtë mandatit tonë. Kemi raportuar bile më pak se që ka dashur, se që figuron në raportin e auditorit dhe unë mendoj se nuk ka logjikë që Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike të mos i ketë të gjitha dokumentacionit. Kjo që e thatë është e mirë dhe unë pres të realizohet. Atëherë, ne drejt do ta informojmë Kuvendin dhe të gjithë tjerët që janë të interesuar rreth atij projekti, me atë rëndësi aq të veçantë.

KRYETARI: Urdhëro, ministër, kundër-replikë.

MINISTRI FEHMI MUJOTA: I nderuari deputet,

Unë përsëri po tërheq vërejtjen për diçka. Kur ju thoni të marrim kontratat, të analizojmë, publiku sikur kupton se ju do të merrni rol tjetër, që nuk e keni. Kujdes, ju jeni Komision për Mbikëqyrje Financiare, t'i shihni të gjitha gjërat financiare, por kur thoni t'i mbikëqyrim, të analizojmë këtë kontratë, besoj se po hyn në një proces shumë të thellë që ka filluar tre vjet e këndeje dhe unë nuk besoj se do t'ia dilni asnjëherë në skaj, ashtu si duhet, sepse nuk e keni këtë mandat, nuk e keni këtë përgjegjësi.

Prandaj, për çështjet që kanë të bëjnë me kontratë, që e përsërita edhe një herë, vendimi i Organit shqyrtues të prokurimit, çdo ministër është i obliguar ta zbatojë, madje nuk e zbaton ka sanksione. Unë e thashë edhe një herë, ka qenë vendim i drejtë apo i padrejtë, nuk është çështje ta gjykoj unë, ta vlerësoj unë, është çështje e dikujt tjetër. Por kam qenë i obliguar si ministër dhe si Ministri ta zbatojmë vendimin e OSHP-ës për kontratat e

mirëmbajtjes. Për çështjen e autostradës është çështje shumë më komplekse dhe ju do të merrni krejt ato që i lejon ligji, që i lejojnë rregullat dhe krejt ato për të cilat ju jeni përgjegjës dhe ne jemi përgjegjës para Komisionit për të raportuar edhe një herë.

KRYETARI: Fjalën e ka Ali Sadriu.

ALI SADRIU: Zoti ministër, kontratën apo kontratat për të cilat po diskutojmë, as Zyra e Auditorit Gjeneral nuk e ka pasur qasjen, prandaj ne nuk dalim mbi atë mandat. Ne kërkojmë për ta analizuar sa është në harmoni me ligjin dhe sa nuk është në harmoni me ligjin. Faleminderit!

KRYETARI: Kryetari i Grupit të LDK, deputeti Ismet Beqiri e ka fjalën.

ISMET BEQIRI: Kryetar, faleminderit!

Vërtet e kemi ngritur disa herë këtë temë dhe këtë që e tha zoti Sadriu kurrë nuk bie ndesh me detyrat që i ka deputeti dhe obligimin që e ka për ta informuar Parlament se çfarë ka ndodhur me atë kontratë. Por nuk është mirë për t'i ngatërruar gjërat dhe të thuhet ka qenë një Komision ndërministror.

Po ka qenë ai, por nuk ka vendosur ai komision për ta ndërruar trasenë, zoti ministër. Ajo ka ndodhur në këtë Qeveri. Ju e dini punën. E keni ndërruar trasenë edhe prej 2010 e këtej po flasim, nuk është LDK-ja në Qeveri më, nëse s'e dini këtë, po ua rikujtoj. Komisioni ndërministror e ka pasur një tjetër obligim në atë kohë, të merrej me autostradën, ta ideojë projektin, i cili kurrë s'iu soll këtij Kuvendi, prandaj nuk është mirë për t' i ngatërruar gjërat me periudha që nuk korrespondojnë.

Në 2010 e këtej po flasim, është bërë kontrata e çdo gjë, dhe ju e dini që traseja, qytetarët e dinë që po ashtu që asnjëherë nuk është marrë vendim në këtë Kuvend, as për autostradën kah do të shkojë, po as për ndryshim, dhe aq më shumë për ndryshim. Ju e dini këtë dhe është mirë të mos i ngatërroni gjërat që tash ta zhvendosni diku përgjegjësinë.

Ajo që është e rëndësishme është nëse është çdo gjë legale, pse të mos e kemi atë kontratë?

KRYETARI: Ministër, e ke fjalën.

MINISTRI FEHMI MUJOTA: I nderuari kryetar i Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike, zoti Beqiri,

Pikërisht konfirmime atë që edhe unë e thashë pak më herët, jam për atë që të përmbahemi asaj e të mos i ngatërrojmë gjërat. Kontrata është nënshkruar në vitin 2010, atëherë kur kemi qenë në bashkë koalicion. Unë vetëm po zbatoj kontratën e cila është nënshkruar dhe e cila po zbatohet në terren. Nuk ka asnjë vendim për ndryshim tjetër, përveç asaj që ka qenë në kontratë dhe kështu po vazhdon.

Ndërsa, për përvojën e krijuar dhe për nisjen e projektit të ri që do shkojë autostrada Prishtinë-Shkup, çdo gjë do të jetë... Keni parasysh se nuk ka pasur projekt zbatues për autostradën që po ndërtohet deri tash. Ka qenë një formë - projekto, zbato. Dhe unë nuk jam autoritet... Jo, ka qenë një projekt krejtësisht në letër, në vijë e cila nuk ka qenë përcaktues se çfarë do bëj. Unë flas për aspektin profesional që kam shpjegime nga inxhinierët. Projekto – zbato, projekti është realizuar dhe sot e kësaj dite jemi kah e realizojmë këtë projekt. Jo si ide, nuk flasim si ide, nëse flasim për idetë, ato kurrë s'kanë munguar në këtë vend. Edhe një projekt fillestar që ka qenë në kohën e ministrit Zef Morina ose Qemajl Ahmeti, ne e dimë, pastaj në kohën e ministrit Fatmir Limaj, projekti kur ka filluar, ka pas shumë nevojë për ndërhyrje dhe forma e projektimit projekto - zbato, është zbatuar deri në fund të këtij projekti, ndërsa me projektin e ri do të jetë më ndryshe, sepse përgatitjet kanë qenë më të gjata dhe sigurisht se do të kenë projekt zbatues, të njohur publikisht, të njohur me kohë dhe çdo gjë do të shkojë si duhet. Po mos të bëjmë një veprim i cili duket sikur, në momentin kur po zhvillohet një proces i rëndësishëm, tash ju e dini që Ministria e Infrastrukturës ka hapur konkursin publik për autostradën e re dhe tashmë është përzgjedhur këshilltari i transaksionit, kompanitë janë para kualifikuar, tri kompani. Jemi në një proces shumë të rëndësishëm, mos të përpiqet që të njolloset projekti më i përparshëm që është një projekt i vlerësuar shumë lartë për nga kualiteti, për nga standardi i ndërtuar dhe për nga shpejtësia. Të mos njolloset...

(Ndërprerje e incizimit)

KRYETARI: Fjalën e ka kryetari i Grupit Parlamentar të LDK-së, Ismet Beqiri.

ISMET BEQIRI: Zoti ministër, ju e dini se keni qenë edhe kryetar komune, asnjë metër nuk mund të ndryshojë traseja pa pëlqim të Kuvendit. Këtë punë e dini. Kjo vlen edhe për komunë e lëre më për Kuvend. Ju e dini që kemi të bëjmë me shpronësime. Asnjë metër katror nuk guxon të ndryshohet traseja nëse ky Kuvend s'merr vendim.

Mos ua thoni njerëzve gjërat që s'janë. Qytetarët e shohin. Ju e dini që ka pasur ndryshim të trasesë. Ju i dini këto, prandaj mos thoni s'ka pasur projekt, po pastaj është bërë projekto - zbato, por nuk është ashtu. Ka pasur edhe projekt ekzekutiv, por është ndryshuar, por ajo që është e rëndësishme, i nderuar ministër nuk guxon të ndryshohet traseja dhe ky Kuvend është dashur të pyetet. Dhe ju e dini që ka ndryshuar dhe nuk është pyetur Kuvendi. Kjo është e vërteta.

KRYETARI: Urdhëro, ministër!

MINISTRI FEHMI MUJOTA: Faleminderit! I nderuari Beqiri! Prej momentit që kam marrë detyrën e ministrit të Infrastrukturës, unë nuk di që ka ndodhur ndryshim i trasesë.

Nëse e keni një fakt të tillë, më thoni kur ka ndodhur ndryshimi i trasesë dhe nga kush?

KRYETARI: Faleminderit! Deputetja Valbona Dibra e ka fjalën.

VALBONA DIBRA: Faleminderit, kryetar!

Unë desha të ndërlidhem me debatin që u zhvillua këtu dhe të jap një sqarim, se u tha këtu që kontratat nuk janë sjell në Komisionin për Mbikëqyrje të Financave Publike.

Ne kemi marrë sqarim edhe nga Auditori i Përgjithshëm se kontrata është në prokurori dhe normalisht se Auditori është i vetëdijshëm, edhe ne si anëtarë të Komisionit duhet të jemi të vetëdijshëm që mos të kërkojmë diçka çka është në prokurori, sepse ndikojmë në proces. Këtë desha ta them si sqarim për qytetarët, për arsye se nuk është ndërhyrje në proces nëse ne i kërkojmë kontratat. Dhe auditori e ka sqaruar se nuk mund t'i kërkojë ato kontrata për deri sa janë në prokurori. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Vazhdojmë me pikën e dytë të rendit të ditës:

2. Koha për pyetje parlamentare

Për këtë seancë janë parashtruar 6 pyetje parlamentare. Fillojmë me pyetjen e parë.

Deputetja Teuta Haxhiu, pyetje për zëvendëskryemministren Hajredin Kuçi. Deputete, zëvendëskryeministri dhe ministri Kuçi nuk është këtu. Doni ta bëni pyetjen? Fjalën e ke.

TEUTA HAXHIU: Faleminderit kryetar!

Kryetar, meqë janë dy ditë që na ndajnë nga 14-vjetori i masakrës në Mejë, unë dua ta bëj pyetjen dhe shpresoj se do ta marr përgjigjen me shkrim, ose me gojë, për t'iu drejtuar edhe unë qytetarëve dhe për t'iu treguar se premtimet e vazhdueshme nga zëvendëskryeministri Kuçi kanë qenë që të ndihmohet financiarisht ndërtimi i kompleksit në Mejë, pra vlerë e cila kalon mbi 1 milion dhe është përkundër dëshirës është një vlerë e papërbalueshme për komunën, prandaj kanë qenë premtimet e tij me vlerë saktë se sa do të ndihmojë dhe unë kisha dashur ta pyes se sa do të jetë ajo vlerë dhe kur do të fillojë ndihma pra financiare dhënë komunës për ta ndërtuar, në fakt për ta përfunduar këtë projekt, sepse ndërtimi i tij ka filluar, punimet po vazhdojnë por është një gjë që është mirë të mos parcializohen, pra të mos të fillojnë familjarët të japin edhe më shumë nga vetja, pra jashtë atyre që kanë dhënë si familje, pra të japin edhe financiarisht, prandaj kisha dashur të di se kur do të fillojë të bëhet ky premtim? Faleminderit!

KRYETARI: Deputetja Albulena Haxhiu, pyetje për zëvendëskryemministren dhe ministrin Hajredin Kuçi.

ALBULENA HAXHIU: Faleminderit, kryetar!

Fillimisht më duhet të shpreh shqetësimin tim për mungesën e vazhdueshme të ministrave, sidomos në kohën e pyetjeve parlamentare. Unë mendoj se kjo është përgjegjësi ndaj qytetarëve, por edhe ndaj këtij Kuvendi dhe është shkelje e Rregullores së punës të Kuvendit dhe Kushtetutës së Republikës së Kosovës, meqë Qeveria e ka për obligim që t'i përgjigjet Kuvendit.

Çështja të cilën e kam parashtruar për ministrin e Drejtësisë ka të bëjë pra që në procedurën gjyqësore të padrejtë, në të cilën është vendosur në dëm të dy ndërmarrjeve shoqërore “Apiko” dhe “Iliria”, duke i falur ngastrat e këtyre ndërmarrjeve Manastirit të

Deçanit, në aktgjykimin e Dhomës së Veçantë të Gjykatës Supreme për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit theksohet se Ministria e Drejtësisë me anë të letrës së vet, pra ka deklaruar se në pajtim me nenin 67 pika 4 të Ligjit mbi menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësi lejon dhe detyron Ministrinë e Drejtësisë që të përfshihet në procedurë, e në këtë rast të përfaqëson edhe interesat e Agjencisë Kosovare të Privatizimit.

Përkundër këtij detyrimi ligjor, Ministria e Drejtësisë nuk ka insistuar fare për përfaqësimin e nevojshëm të AKP-së dhe është vetëkënaqur me një shkresë të cilën e ka komunikuar në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme, andaj pyetja parlamentare për ministrin e Drejtësisë është se pse ka qenë Ministria e Drejtësisë pasive në këtë çështje me kaq interes të rëndësishëm publik? Dhe meqë ministri, pra nuk është këtu, unë do të kërkoj edhe përgjigje me shkrim për këtë çështje. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Deputeti Bekim Haxhiu, pyetje për ministrin Ferid Agani.

BEKIM HAXHIU: Faleminderit, i nderuar kryetar!

Të nderuar ministra,

I nderuar ministër i Shëndetësisë, Ferid Agani,

Drejtuesit e organizatave të veteranëve të luftës, nga pas lufta janë vetëvrarë 26 veteranë të UÇK-së, derisa disa të tjerë këtë numër e çojnë deri në 44 ushtarë të UÇK-së të vrarë pas luftës.

Ky fenomen është sa i dhimbshëm aq edhe tronditës i vetëvrasjes së ushtarëve të UÇK-së, ndërkohë po edhe aq shqetësues kjo dukuri kërkon trajtim institucional.

I nderuar ministër,

Në një takim që e keni mbajtur me drejtuesit e veteranëve të Luftës së UÇK-së, ju i nderuar ministër iu keni premtuar atyre para dy vjetësh se do ta ngrini një qendër të rehabilitimit, andaj kjo pyetje është edhe pyetje e vetë drejtuesve të veteranëve të UÇK-së se çfarë keni ndërmarrë deri më tani për ngritjen e kësaj qendre të rehabilitimit? Faleminderit!

KRYETARI: Ministër, e ke fjalën.

MINISTRI FERID AGANI: Faleminderit zoti kryetar!

I nderuari zoti kryetar,

Kabinet qeveritar,

Të nderuar deputetë,

I nderuar zoti deputet,

Ministria e Shëndetësisë ka marrëdhënie jashtëzakonisht të mira me organizatat e veteranëve të luftës dhe jemi të njohur me problematikat e tyre në aspekte të ndryshme, përfshirë edhe këtë problematikë tejet të dhimbshme për vendin, e cila prek jo vetëm kategorinë e veteranëve të luftës si më të ndjeshmen, por edhe qytetarë të tjerë të vendit dhe shkaqet për këtë i tejkalojnë larg kompetencat e Ministrisë së Shëndetësisë, meqenëse bëhet fjalë për një problem kompleks social i cili kërkon adresim, po flas për

problemin e vetëvrasjeve në vend, një adresim gjithëpërfshirës i cili kërkon edhe investime të konsiderueshme.

Gjatë takimit që unë kam pasur me organizatat e veteranëve të luftës, në asnjë moment nuk kam dhënë premtim për ngritjen e ndonjë qendre rehabilituese , sepse kjo i tejkalon kompetencat dhe mandatin e ministrit të Shëndetësisë, meqenëse një qendër e tillë duhet të jetë në kompetencën në radhë të parë do të thosha të vetë Qeverisë së Kosovës ose së paku të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Social e cila duhet të merret me krijimin e kushteve adekuate për rehabilitimin e personave të cilët kanë kaluar nëpër periudha të caktuara traumatike.

Ajo që unë atyre u kam premtuar është zotimi im që do të mundohemi të dizajnojmë programe të veçanta për trajtimin e traumave psikike dhe atë në bashkëpunim me kolegët nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës, gjë që jemi duke bërë dhe jemi shumë afër dizajnit të një projekti i cili do të paraqitet para Qeverisë së Kosovës për mbështetje financiare duke qenë se i tejkalon mundësitë financiare të buxhetit të Ministrisë së Shëndetësisë. Faleminderit!

KRYETARI: Deputet, ke pyetje shtesë?

BEKIM HAXHIU: Faleminderit, i nderuar kryetar!

Faleminderit ministër,

Ajo që plotësisht është në kompetencën e Ministrisë së Shëndetësisë, ngritja e qendrave të rehabilitimeve edhe për trajtime postraumatike dhe besoj i nderuar ministër e dini që shëndeti mendor është në kuadër të Ministrisë së Shëndetësisë suaj, dhe në bazë të hulumtimeve dhe në bazë të konstatimeve të ekspertëve të cilët janë marrë me këtë fushë është konstatuar se në gjitha vendet e dala nga lufta te të cilët ka qenë i rritur ky fenomen i vetëvrasjeve, ata të cilët kanë investuar në ngritjen e shëndetit mendor dhe qendër të rehabilitimit dhe trajtimin e këtyre personave me trauma të luftës, ka ndikuar që ky numër dukshëm të zvogëlohet. Prandaj nuk mendoj se duhet të largohet si pjesë e përgjegjësisë tuaj dhe të shpërndahet në kuadër të dikastereve tjera qeverisëse, për arsye se kemi të bëjmë me një problem postraumatik, kemi të bëjmë me një problem shëndetësor dhe me trajtim...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Ministër, e ke fjalën.

MINISTRI FERID AGANI: I nderuar zoti deputet, kur është në pyetje problematika e shëndetit mendor mendoj se e keni të qartë se unë i kam shumë më mirë se ju të qarta të gjitha dimensionet e problemit, edhe në aspektin profesional, dhe po e theksoj edhe një herë se në qoftë se në Kosovë është punuar diçka në lëmin e shëndetësisë në drejtim të tejkallimit të problemeve të rënda që popullata e Kosovës i ka trashëguar dhe përjetuar, në të vërtetë janë rezultat i traumave të rënda psikike të periudhës së okupimit dhe periudhës së luftës, atëherë është bërë në lëmin e shëndetit mendor. Ju e dini se është ngritur një sistem i tërë i shërbimeve të reja të shëndetit mendor në vend me 7 qendra të shëndetit

mendor që më vonë janë plotësuar edhe me 3 tjera edhe me shtëpi për integrim në bashkësi, me programe të veçanta të rehabilitimit për të sëmurët mendor kur është fjala, por problemi i rehabilitimit të luftëtarëve dhe veteranëve të luftës i tejkalon mundësitë dhe kapacitetet e programeve që Ministria e Shëndetësisë duhet t'i afrojë.

Vetë fjala rehabilitim nuk nënkupton trajtimin. Bëhet fjalë për rehabilitim psikosocial.

Për ta dëshmuar pak më qartë, kur ka qenë programi për sigurimin e protezave për shembull për veteranë të luftës, ai program nuk është zhvilluar nëpërmjet Ministrisë së Shëndetësisë në Qeverinë e Kosovës, por në krye të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale. Besoj se jeni i informuar për këtë.

Prandaj, jo për t'i ikur përgjegjësisë, përkundrazi, propozimi ka qenë i imi që ne të dizajnojmë një program të veçantë për ndihmë dhe do ta bëjmë këtë, dhe jemi në rrugë të mirë që ta sigurojmë një program kualitativ, natyrisht duhet siguruar edhe mjetet financiare.

KRYETARI: Faleminderit, ministër!

Ju njoftoj se ministri i Arsimit, Buja, ka paralajmëruar që s'mund të jetë këtu. I ka dy pyetje. Deputetja Ganimete Musliu ka bërë pyetje dhe deputeti Arsim Bajrami. Deputet Bajrami, doni ta bëni pyetjen? Jo. Faleminderit!

Atëherë, deputetja Kymete Bytyçi ka bërë pyetje për ministrin Dardan Gashi, por ministri nuk është këtu. A doni ta bëni pyetjen?

KYMETE BYTYÇI: Pasi s'është ministri këtu, atëherë unë do ta transferoj pyetjen time për seancën e radhës. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Pra, kjo pikë e rendit të ditës ka përfunduar. Prania elektronike është 83 deputetë, prania fizike 62 deputetë. Vazhdojmë me pikën e radhës:

3. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve plenare të mbajtura më 11 dhe 18 prill 2013

Pyes nëse ka vërejtje në procesverbale?

(Ndërhyrje)

Po, është fjala për dy procesverbale, më 11 dhe 18 prill 2013.

A ka vërejtje ndokush në këto procesverbale? Nëse nuk ka, atëherë së pari po votojmë për prani. Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim dhe votojmë tash. Pra, e votojmë praninë.

63 deputetë janë. Me këtë prani, që është dëshmuar, ne nuk mund të hyjmë në votim. Edhe një herë, lus deputetët dhe regjinë të përgatiten për prani. Votojmë tash!

Jo, nuk kam të them asgjë, veç dua të ju lajmëroj që të pranishëm janë 65 deputetë, prania elektronike 62 deputetë. Jo, nuk dua ta përsëris më. As pa kartela jo. Kjo është përgjegjësi juaja, jo imja. E kemi numrin 62, prandaj mund të votojmë.

Konstatohet se e Kuvendi miratoi procesverbalin e mbledhjeve plenare, të mbajtura më 11 dhe më 18 prill 2013.

Fjalën për rend dite e ka kërkuar deputetja Teuta Sahatqija.

TEUTA SAHATQIJA: Faleminderit, kryetar!

Sa i përket rendit të ditës, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, kisha kërkuar që Qeveria ta tërheqë Ligjin për tregun dhe produktet e naftës, pasi ky ligj, në disa nene, do t'i cek vetëm nenet 5.7 dhe 5.8, është në kundërshtim me nenin 10 të Kushtetutës, në të cilin flitet për ekonomi. Dhe, ky nen thotë se ekonomia e tregut me konkurrencë të lirë është bazë e rregullimit ekonomik të Republikës së Kosovës, përderisa këto nene e kundërshtojnë këtë parim të konkurrencës së lirë, duke u pamundësuar bizneseve të vogla dhe duke krijuar një lloj të monopolit. Prandaj, mendoj që ky ligj nuk duhet të procedohet, por t'i kthehet Qeverisë.

KRYETARI: Mendoj që kur të vijë në rend të ditës, për këtë çështje duhet të kërkohet mendimi i kryetarit të Komisionit, dhe pastaj vendos Kuvendi. Fjalën e ka deputetja Duda Balje.

DUDA BALJE: Zahvaljujem!

U ime Parlamentarne grupe "6+" zahtevamo da se deveta tačka dnevnog reda odloži za sledeću sednicu.

KRYETARI: Për këtë na duhet një votim formal. Kush është për këtë mocion, që e kërkoi deputetja Duda Balje? Faleminderit! Shumica e deputetëve. A ka kundër? Nuk ka. Mbetet për seancën e radhës. Pra, pika 9 e rendit të ditës - Miratimi i marrëveshjes së deputetëve nga radhët e komuniteteve joshumicë dhe zgjedhja e nënkryetarit të Kuvendit nga këto komunitete shtyhet për seancën e radhës.

Vazhdojmë me pikën e katërt të rendit të ditës:

4. Interpelanca e ministrit të Shëndetësisë, z.Ferid Agani, sipas kërkesës së deputetes Time Kadrijaj, mbështetur edhe nga 9 deputetë tjerë lidhur me gjendjen në shëndetësinë e Kosovës

Deputetja Time Kadrijaj dhe grupi i deputetëve nënshkruar, në bazë të nenit 44 të Rregullores së Kuvendit, ka parashtruar kërkesë për ta ftuar në interpelancë ministrin e Shëndetësisë, zotin Ferid Agani, lidhur me gjendjen e shëndetësisë në Kosovë.

Ju njoftoj se në bazë të Rregullores së Kuvendit, interpelanca mund të zgjasë deri në tri orë.

Përfaqësuesi i interpelancës e mban të drejtën e fillimit të debatit në kohëzgjatje deri në 10 minuta dhe në përmbyllje të debatit deri në 5 minuta, neni 44, pika 7, i Rregullores së Kuvendit.

Në bazë të nenit 44, pika 8, të Rregullores së Kuvendit, ministri Ferid Agani e paraqet dhe arsyeton qëndrimin e Qeverisë së Kosovës për çështjen e shtruar në interpelancë në kohëzgjatje prej 15 minutash.

Koha e ndarë për diskutime sipas grupit parlamentar dhe deputetëve pa grup parlamentar është si vijon: Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike i ka 50 minuta, 8 minuta për ministrin, do të thotë i mbeten 42 minuta. Grupi i Lidhjes Demokratike 27 deputetë, 40 minuta. Grupit të “Vetëvendosjes”, 12 deputetë, 18 minuta. Grupit të AAK-së, 12 deputetë, 18 minuta. Grupit Koalicioni Kosova e Re, 9 deputetë, minus dy për ministrin, 11 minuta. Grupi i SLS-së, 13 minuta, pasi të tjerët shkojnë për ministrin. Grupi “6+”, 7 minuta, 2 minuta për ministrin dhe nëntë deputetë pa grup deri në 2 minuta për deputet, gjithsej 18 minuta. Kjo është koha e ndarë sipas fuqisë së grupeve parlamentare.

E ftoj deputeten Time Kadrijaj që, në cilësinë e propozuesit të interpelancës, ta marrë fjalën. Besoj që 10 minuta i mjaftojnë.

TIME KADRIJAJ: Faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar deputetë,

Qytetarë të Kosovës,

Gjendja e rëndë e sistemit të shëndetësisë në Kosovë është e papranueshme, por jo edhe e papritur.

Një Qeveri që nuk e ka prioritet shëndetësinë dhe një ministri, e cila gjithë mandatin merret veç me letra, e ka qëndruar larg çdo përballjeje të drejtpërdrejtë me probleme të shëndetësisë, më mirë nuk dinë ose nuk mund.

Gjendja në shëndetësi është pasojë e keqmenaxhimit, që fillon në krye të qeverisjes së vendit dhe në gjithë zinxhirin e saj menaxhues.

Kjo Qeveri deri më sot nuk e ka pasur qëllimin e ndryshimit të gjendjes në shëndetësi dhe as që ka bërë përpjekje serioze për ta përmirësuar sistemin shëndetësor.

Që nga marrja e mandatit si ministër i Shëndetësisë, doktor Ferid Agani u zotua se do ta reformojë sistemin e shëndetësisë duke ndërtuar mekanizma të kontrollit, fillimisht nëpërmjet ndryshimit të Ligjit për shëndetësi, miratimit të Ligjit për sigurime shëndetësore, si dhe plotësim-ndryshimit të legjislacionit të brendshëm për mbarrëvajtjen e punës së kësaj ministrie dhe institucioneve në varësi të saj.

Gjatë mandatit të tij e kanë karakterizuar një sërë aferash, të cilat e dëmtojnë rëndë Buxhetin e Kosovës, por edhe e ulin imazhin e shëndetësisë, në përgjithësi.

Ky sistem, sipas edhe vetë ministrit, është totalisht i korruptuar dhe i centralizuar. Ndërsa asnjë masë në këtë drejtim nuk e ka ndërmarrë.

Institucioneve shëndetësore u është marrë autonomia e veprimit. Çdo hap i institucioneve shëndetësore është i kontrolluar nga kjo ministri.

Fakti qëndron në refuzimin e zbatimit të vendimit të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës të Shërbimit Civil të Kosovës për rihapjen e konkursit për drejtorë të klinikave dhe shërbimeve në Qendrën Klinike Universitare, i cili vendim as sot e kësaj dite nuk po zbatohet.

Qendra Klinike Universitare e Kosovës punon me ushtrues detyre të klinikave dhe shërbimeve që nga viti 2010. Këtu i kam kopjet dhe vendimet e Gjykatës Supreme, por edhe të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës dhe ministri në fakt këto vendime i ka zbatua parcialisht, e jo tërësisht.

Pastaj, është rasti i zyrtarëve të lartë në Ministrinë e Shëndetësisë, të cilët njëkohësisht janë edhe specialistë. Përsëri Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës ka marrë vendim që këta në mënyrë jologjore gjenden në vendet e tyre të punës.

Skandali me citostatikë, ku në listën e furnizimit me citostatikë është futur dhe produkti ‘Palonosentron’, i cili në fakt nuk është citostatik, dhe në këtë formë e ka marrë buxhetin më të madhe për citostatikë. Kush është ndëshkuar për këtë gabim?

Pastaj skandali me insulina, kur institucionet shëndetësore janë furnizuar me insulinë me dy banderola, një e Serbisë dhe një e Kosovës. Dhe, nëse këto insulina nuk do të raportoheshin nga disa menaxherë shëndetësorë, ende do të vazhdonin me këtë praktikë, sepse nuk ka kontroll nga organet kompetente, ose këto bëhen qëllimisht. Bile-bile, thuhet që në përbërjen e insulinës nuk ka pas substancë aktive dhe numri i pacientëve me diabet është shtuar nëpër institucionet shëndetësore.

Tash në publikimet televizive thuhet se në barnatoret private po gjenden në shitje insulinat që janë nga lista esenciale.

Rasti i penjve kirurgjikë, kualiteti i dobët i tyre, mospajisja e spitaleve dhe e Qendrës Klinike Universitare me barna nga lista esenciale, si dhe material harxhues, detyrimi i pacientëve për t’u vetëshërbyer me medikamente janë çështje për të cilat ministri është dashur, jo vetëm të thirret në interpelancë, por edhe të ndërmerren masa adekuate ndëshkuese, ashtu siç ndodh në shtetet e zhvilluara.

Mungesa e anestetikëve këto ditë në institucionet shëndetësore dhe pamundësia e operimit të pacientëve në klinikat dhe spitalet rajonale, janë edhe një rast i pajustificueshëm, kur kihet parasysh se anestetikët nuk gjenden në barnatoret private, sepse këto janë barna nga lista esenciale dhe vonimi i operimit të pacientëve është çështje jetësore.

Një çështje shumë e ndjeshme, e cila kohëve të fundit po artikullohet në media, është çështja e specializantëve, e cila po zvarritet çdo muaj dhe nuk po i gjendet zgjedhja adekuate, çështje kjo e cila është shqetësuese, duke e marrë në konsideratë numrin e madh të tyre.

Raportimi i fundit i KDI-së w ka bërë një prezantim përmbledhës nga monitorimi i prokurimit në këtë ministri. Problemet kryesore në këtë lëmi mbeten përshtatja e kriterëve për biznese të caktuara, moszbatimi i kontratave me kohë dhe sipas kriterëve të përcaktuara, mungesa e sanksioneve për operatorët e papërgjegjshëm, planifikimi i dobët i projekteve dhe mungesa e transparencës dhe llogaridhënies.

Problemet brenda inspektoratit shëndetësor dhe animi i juaj nga njëra palë, veç sa e dëmton imazhin tuaj dhe të Ministrisë së Shëndetësisë. Joprofesionalizmi i zinxhirit menaxhues të institucioneve shëndetësore, dhënia e kompetencave të dyfishta dhe moskordinimi i efektivitetit të punës e shfaqin një pasqyrë reale të punës të kësaj ministrie.

Mosfunksionalizimi i Spitalit të Mitrovicës dhe pamundësia e delegimit të mjekëve në këtë spital, përsëri është një dështim.

Kjo Qeveri po pretendon ta reformojë sistemin shëndetësor në tërësi, kurse për 5 vjet nuk ka arritur ta rregullojë asnjë spital - Qendrën Klinike Universitare të Kosovës.

Ne konsiderojmë që pas të gjitha këtyre fakteve që i cekëm më lart, ministri Agani është dashur edhe më herët të ftohet në interpelancë, ndërsa nga deputetët e Kuvendit të Kosovës kërkoj që të votohen rekomandimet e propozuara. Pas debatit që do të zhvillohet sot në këtë Kuvend, nëse disa nga kolegët e kanë ndonjë rekomandim shtesë, ju propozoj që të lajmërohen dhe bashkë t'i koordinojmë rekomandimet. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, deputete! Fjalën e ka ministri i Shëndetësisë, zoti Ferid Agani.

MINISTRI FERID AGANI: Faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar deputetë,

I nderuar zoti ministër,

Unë fillimisht e falënderoj Grupin Parlamentar të AAK-së dhe deputetët nënshkrues të kërkesës për interpelancë, për mundësinë që të parashtroj para institucionit më të lartë përfaqësues të shtetit vlerësimin tim për gjendjen aktuale në shëndetësinë kosovare dhe punën e Ministrisë së Shëndetësisë, për t'u ballafaquar me sfidat e shumta të trashëguara dhe të shtresuara me dekada, si brenda institucionit, si në udhëheqje, ashtu edhe brenda gjithë sektorit.

Nëse duhet ta përmbledhim me një fjali situatën aktuale, atëherë do të vlerësoja se gjendja në shëndetësinë kosovare cilësohet me vështirësi të shumta, por njëkohësisht është shumë më e mirë se para dy vjetëve, në fillim të mandatit tim, veçanërisht në aspektin e perspektivave për ta arritur një sistem evropian të shërbimeve shëndetësore.

Rrugëtimi deri në këtë pikë ka qenë i përmbushur me probleme tejet serioze që në masën më të madhe ishin rezultat i sistemit anakronik të centralizuar dhe të politizuar shëndetësor, e si i tillë me kohë u korruptua në masë të madhe, veçanërisht në sektorin farmaceutik, si dhe në sektorin e punësimit të njëkohshëm, në sektorin publik dhe privat.

Dhe, njëkohësisht administrata tejet fragjile shtetërore në Ministrinë e Shëndetësisë, me probleme të shumta dhe të trashëguara, në mes të mandatit u godit me arrestime dhe procedura hetimore e gjyqësore të zyrtarëve më të lartë shtetërorë për çështje që nuk kishin të bënin me mandatin e kësaj ministrie.

Situatën e bënte më të ndërlikuar nënfinancimi tejet serioz i shërbimeve shëndetësore në të gjitha nivelet e kujdesit shëndetësor, përkundër rritjes së vazhdueshme të ndarjeve buxhetore, por jo në masën e duhur.

Të nderuar deputetë,

Ishin këto probleme tejet serioze dhe të trashëguara nëpër dekada, të cilat i kam pritur, por dua ta pranoj, jo në këtë masë dhe intensitet.

Që nga fillimi i mandatit tim e kam dituar se e vetmja rrugëdalje nga situata aktuale është reformimi i sistemit aktual shëndetësor dhe reformimi i organizimit të brendshëm të Ministrisë së Shëndetësisë, krahas vendosjes së shëndetësisë në prioritetet politike të Qeverisë dhe institucioneve të tjera relevante të shtetit.

Jemi në ditët kur të dy këta mekanizma themelorë për tejkalimin e problemeve aktuale janë vendosur. Fillimisht, pas më shumë se dy vjetëve të përpjekjeve, do të hyjë në fuqi Ligji i shëndetësisë, që do ta ndryshojë sistemin shëndetësor të vendit në mënyrë përmbytëse dhe, së dyti, dje në Qeveri u miratua Rregullorja e re për organizimin e brendshëm të Ministrisë së Shëndetësisë, e cila do të mundësojë që ta bartë këtë reformë me sukses.

Të përkujtoj se Ligji i shëndetësisë është miratuar në maj të vitit 2012 në Qeverinë e Kosovës dhe se është miratuar në dëgjim të parë në Kuvendin e Kosovës më 28 qershor të vitit 2012. Pra, plot 10 muaj ai ka pasur rrugëtim në Kuvendin e Kosovës.

Njëkohësisht, në Kuvendin e Kosovës u miratuan edhe shumë ligje të tjera, të cilat e mbështesin rregullativën dhe kornizën ligjore të domosdoshme për zbatimin e reformës. Në radhë të parë u miratua Ligji për kontrollin e duhanit, si instrument tejet i fuqishëm ligjor për ruajtjen e shëndetit publik të popullatës dhe po ashtu në dëgjim të parë u miratuan Projektligji për odat e profesionistëve shëndetësorë, Projektligji për transplantimin e organeve, Projektligji për transplantimin e indeve dhe qelizave dhe Projektligji për produktet medicinale dhe pajisjet mjekësore.

Para miratimit në Qeveri është edhe Projektligji për sigurime shëndetësore, me të cilin do të rumbullakohet korniza legjislative, e cila përfundimisht do të ndajë shëndetësinë kosovare nga aktualiteti i mbijetesës. Të theksoj se Projektligji i sigurimeve shëndetësore është i dakorduar me Bankën Botërore, me Fondin Monetar Ndërkombëtar dhe me

kënaqësi konstatohet se i gjithë ky proces reformues është përgatitur dhe zhvilluar në bashkëpunim me këto institucione relevante ndërkombëtare, me Organizatën Botërore të Shëndetësisë, me Komisionin Evropian, me komunitetin e donatorëve dhe, në anën tjetër, edhe me një bashkëpunim të ngushtë me profesionistët vendorë dhe vendimmarrësit në sektorin e shëndetësisë, siç është Federata e Sindikatave të Punëtorëve Shëndetësorë, me të cilën Ministria e Shëndetësisë e ka nënshkruar kontratën e vetme sektoriale në Republikën e Kosovës.

Në vijim, më lejoni t'i numëroj vetëm disa prej arritjeve kryesore të Ministrisë së Shëndetësisë në periudhën e kaluar dyvjeçare.

E filluam punën në Institutin Onkologjik, përfshirë shërbimet kemoterapeutike dhe radioterapeutike për herë të parë.

Filloi puna në shërbimin e Kardiokirurgjisë. U mbulua me 95% popullata me imunizim në kuadër të programit të zgjeruar të imunizimit. U akredituan në nivel ndërkombëtar Qendra e laboratorëve testues të Institutit Kombëtar të Shëndetit Publik me ISO standarde dhe nga Organizata Botërore e Shëndetësisë u certifikuan laboratorë të mikrobiologjisë për fruth, rubellë, shytë dhe tuberkulozë.

U bë licencimi i prodhuesit të parë farmaceutik për eksportin e barnave në bazë të certifikatës të prodhimit të mirë. U licencua prodhuesi i parë vendor i pajisjeve mjekësore. U punësuan 239 mjekë dhe stomatologë, prej të cilëve 145 në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës. U punësuan 153 infermierë, prej të cilëve 75 në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës. U siguruan 100 vende të reja të punës për Spitalin e Mitrovicës, me qëllim të përmirësimit të punës në këtë spital. U dhanë 550 kontrata për specializime. Për herë të parë u ndanë 18 specializime për mjekë dhe stomatologë nga Presheva, Bujanovci dhe Medvegja, dhe një specializim për mjekë nga Mali i Zi, prej këtyre 10 me financim nga Ministria e Shëndetësisë.

U realizua një program tejet i begatshëm i simpoziumeve profesionale dhe shkencore me ekspertë ndërkombëtarë. U bë kontraktimi i parë i institucioneve shëndetësore në sektorin privat dhe në këtë mënyrë mjetet financiare u kanalizuan drejt institucioneve vendore shëndetësore, e jo atyre të huaja.

U punësuan 300 punëtorë shëndetësorë në sektorin privat të shëndetësisë. U realizuan investime të huaja e donacione në vlerë prej 15 milionë eurove, vetëm brenda vitit 2012. U bë dhe vazhdon të bëhet zhvillimi sistematik i sistemit të informacioneve shëndetësore dhe për këtë qëllim janë siguruar edhe 7 milionë euro donacion nga Qeveria e Luksemburgut për periudhën e ardhshme.

Të nderuar deputetë,

Janë këto vetëm disa prej arritjeve të Ministrisë së Shëndetësisë, të cilat premtojnë se jemi në rrugë të mirë për t'i adresuar problemet e shumta me të cilat ballafaqohet sektori shëndetësor, disa prej të cilave janë përmendur në kërkesën për këtë interpelancë.

Fillimisht dua të deklaroj se jam plotësisht koshier për vështirësitë dhe mangësitë e theksuara në sektorin e planifikimit, prokurimit dhe furnizimit me barna dhe material harxhues, që e paraqesin edhe pjesën kryesore të kërkesës për interpelancë.

Ministria e Shëndetësisë është duke punuar me vendosmëri të madhe që këto mangësi dhe vështirësi të tejkalohen.

Më lejoni që, duke mos dashur të inkuadrohem në debat polimizues me parashtruesit e kërkesës përkitazi me këto çështje dhe duke pasur respekt të plotë për kohën në dispozicion, të përgjigjem në vlerësimet e parashtruesve të kërkesës në disa çështje konkrete.

Shpresoj se pas paraqitjes të arritjeve kryesore të Ministrisë së Shëndetësisë, veçanërisht në rrafshin reformues, është bërë e qartë se Qeveria e Kosovës e ka mbështetur në plotësi reformën në sektorin e shëndetësisë dhe se konstatimi se Qeveria nuk e ka pasur për qëllim ndryshimin e gjendjes në shëndetësi dhe se nuk bën përpjekje serioze për ta përmirësuar sistemin shëndetësor, nuk qëndron. Me këtë rast, dua të theksoj angazhimin tim të vazhdueshëm timin, edhe në nivel, edhe këto ditë, kur jemi duke e përpiluar kornizën afatmesme të shpenzimeve, që financimi i shëndetësisë të shtohet dhe që shëndetësia ta marrë me të vërtetë pozitën e prioritetit në politikat qeveritare.

Konsideroj se është i padrejtë vlerësimi se Ministria e Shëndetësisë nuk është përballur drejtpërdrejt me problemet e shëndetësisë dhe se merret vetëm me letra. 550 mjetë në specializim, 239 mjekë e stomatologë të punësuar, 153 infermierë, preokupimet edhe me probleme ditore të Qendrës Klinike Universitare, e dëshmojnë të kundërtën.

Përkitazi me reformën e sistemit shëndetësor dhe përmbushjen e zotimeve të mia përkitazi me zbatimin e saj nëpërmjet krijimit të një kornize të qartë ligjore, disa fjalë i thashë më parë.

Sa u përket raporteve të Ministrisë së Shëndetësisë me Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës të Shërbimit Civil të Kosovës, dua të theksoj se jemi një prej ministrive që në mënyrë të përpiktë i ka zbatuar vendimet e këtij këshilli. Mirëpo, kur ka qenë në pyetje menaxhmenti i klinikave të Qendrës Klinike Universitare të Kosovës, kemi pasur vështirësi në interpretimin e dispozitave ligjore në aspektin e statusit juridik të drejtorëve të klinikave, si shërbyes civilë, ose si nëpunës publikë.

Unë kam dëshirë t'ua tërheq vërejtjen edhe parashtruesve të kërkesës se në Kuvendin e Kosovës është miratuar Ligji i shëndetësisë, i cili në nenin 62, pikë 1, përfundimisht e zgjidh këtë problem, duke i dhënë të drejtë Ministrisë së Shëndetësisë që asnjë punëtorë në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës dhe spitalet rajonale nuk i përket shërbimit civil të Administratës Shtetërore.

Kur është në pyetje çështja shumë herë e shtruar nga deputetja Kadrijaj përkitazi me kryeinspektorin e Inspektoratit Shëndetësor, dua të theksoj se Ministria e Shëndetësisë nuk ka marrë asnjë vendim të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës të Shërbimit Civil të

Kosovës. Atë që e ka marrë është një opinion juridik, të cilin nuk e njeh Ligji për shërbimin civil.

Ministria e Shëndetësisë do ta zbatojë çdo vendim ose rekomandim të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës të Shërbimit Civil, e jo opinione juridike të individëve të këtij këshilli, qoftë ajo edhe kryetar i këshillit.

Kur janë në pyetje aferat, siç u theksuan nga zonja Kadriaj, dua të ju informoj si në vijim:

Sa i përket rastit të produktit “Palonosentron”, mu për shkak të shkeljeve të procedurave ligjore, unë si ministër nuk e kam nënshkruar këtë kontratë dhe nuk e kam lejuar dëmtimin e Buxhetit të Kosovës.

Procedura e përpilimit të kësaj kontrate dhe si kemi ardhur deri në atë pikë është subjekt i shqyrtimit të Auditorit të Përgjithshëm të Kosovës, i cili dje ma ka afuar opinionin e tij dhe unë do të veproj në bazë të rekomandimeve të këtij organi të pavarur të Kuvendit të Kosovës.

Sa u përket insulinave me banderolë të dyfishta, Ministria e Shëndetësisë ka ndërmarrë masa të menjëhershme, duke e tërhequr produktin nga qarkullimi. Sqarimi ka ardhur nga kompania prodhuese se është bërë fjalë për gabim në rastin e distribuimit nga depoja e atyre qendrore në Hungari, dhe se kjo nuk do të përsëritet.

Në funksion të parandalimit të situatave të ngjashme, Ministria e Shëndetësisë, në bashkëpunim me Doganat e Kosovës, ka vendosur që të fuqizohet kontrolli që kryhet nga Dogana konform licencës që lëshon Agjencia Kosovare për Produkte Medicinale, me praninë e vazhdueshme të Inspektoratit Farmaceutik në pikat e autorizuara doganore për importin e produkteve medicinale dhe ky kontroll do të fillojë më 6 maj të këtij viti.

Për këtë qëllim, Ministria e Shëndetësisë e ka aprovuar rritjen e numrit të inspektorëve farmaceutikë.

Sa i përket kontrollit në hyrjen e depos së Ministrisë së Shëndetësisë, janë përforcuar masat e kontrollit me kërkesën për parashtrimin e lejes së importit edhe me rastin e deponimit të produkteve.

Kjo që ka ndodhur është përgjegjësi e operatorit ekonomik, i cili është ndëshkuar për këtë papërgjegjësi, si dhe pritët të ketë edhe ndëshkime të tjera përcjellëse administrative.

Sa i përket kualitetit të insulinës, kompania prodhuese, që është një nga kompanitë më me renome botërore, e ka garantuar me shkrim cilësinë e produktit dhe në ndërkohë Agjencia Kosovar për Produkte Medicinale është duke e vërtetuar këtë për të gjitha seritë e dyshuara.

Sa i përket shitjes së insulinave në barnatore, që raportojnë mediet, që janë nga lista esenciale, po sqaroj se produktet që janë në listë esenciale e që janë të regjistruara mund

të shiten edhe në barnatore, por ato me këtë rast nuk guxojnë ta kenë banderolën e kuqe, e cila determinon shfrytëzimin e tyre në institucione publike shëndetësore, por duhet të kenë banderolë të kaltër.

Sa u përket penjve kirurgjikalë, sipas gjetjeve zyrtare, bëhet fjalë për penj që nuk janë prokuruar nga Ministria e Shëndetësisë, pra që kanë ardhur me procedura të tjera, ose si donacione, ose janë blerë drejtpërdrejt nga qytetarët.

Ndërkaq, sa i përket furnizimit me anestetikë, e shfrytëzoj rastin që të ju informoj se për këto produkte numri i prodhuesve është tejet i kufizuar. Ndërsa kërkohet një raportim ndërkombëtar, para se të vijë në shtetin ku ato porositen, gjë që ndërlikohet me vonesa burokratike.

Është evidente se ka pasur mangësi në procesin e planifikimit të anestetikëve. Prandaj, Ministria e Shëndetësisë ka ndërmarrë masa duke siguruar planifikime 3 deri 6-mujore dhe në këtë aspekt jemi duke i ndryshuar rrënjësisht politikat e planifikimit dhe të furnizimit me barna dhe pajisje mjekësore.

Sa i përket rregullimit të furnizimit, dua të ju informoj se kam kërkuar ndërprerjen e kontratave me operatorë të papërgjegjshëm ekonomikë, të cilët nuk janë në gjendje që t'i përmbushin ato, dhe ndërprerja e kontratave ka filluar dhe është në vijim e sipër.

Sa i përket çështjes së specializantëve, u përmendën arritjet e Ministrisë në këtë drejtim. Dua të theksoj se gjatë tërë mandatit jam marrë me problemet e trashëguara nga e kaluara, prej llojeve më të ndryshme, dhe kjo e specializimeve është njëra prej tyre.

Ka ngelur ende i pa zgjidhur problemi i 280 specializantëve, të cilët janë me kontrata të nënshkruara nga ata se do të jenë me vetëfinancim dhe jemi duke punuar që edhe këta specializantë të provojmë t'i vëmë në listën e pagave dhe të kompensimit financiar.

Unë pajtohem me shumë vlerësime të parashtruesve të kërkesës, të cilat mbështeten në vlerësimet e raportit të KDI-së...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Ministër, edhe një minutë!

MINISTRI FERID AGANI: Pajtohem me vlerësimet që kanë të bëjnë me procedurat e prokurimit.

Dhe, ajo që kemi konstatuar gjatë vitit 2012, në masë të madhe duke iu falënderuar edhe zhvillimeve që i përmenda në fillim të vitit të kaluar, dhe nevojës që në pozitat e drejtorëve të departamenteve të prokurimit dhe farmacisë të ndërrohen edhe nga 2-3 zyrtarë, ka ardhur deri te dështimet në procedura të planifikimit dhe furnizimit.

Si rezultat, i kemi pasur edhe mungesat në tremujorin e parë të këtij viti me barna e material harxhues, por situata është në përmirësim e sipër dhe këto ditë është duke u punuar lista e strukturuar, lista esenciale, e cila do të përmbajë tri grupe të barnave për herë të parë. Do të thotë, do t'i përmbajë barnat e listës vitale, të listës esenciale dhe të listës joesenciale. Ky grup i barnave nga lista esenciale, që do të jetë me rëndësi vitale, do të jetë i prokuruar në mënyrë të rregullt dhe do të kemi furnizim 100% në çdo moment në periudhën e ardhshme kohore...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Faleminderit, ministër! Kryetari i Komisionit, nuk është këtu. Vazhdojmë me përfaqësuesit e grupeve parlamentare. Në emër të Partisë Demokratike, deputetja Flora Brovina e ka fjalën.

FLORA BROVINA: Faleminderit!

Përshëndetje kryetar,

Përshëndetje ministra,

Kolegë dhe kolege,

Së pari e falënderoj grupin që thirri interpelancë, sepse na e dha mundësinë që të bisedojmë për shëndetësinë.

Shëndetësia në Kosovë ka kohë që vuan nga një sëmundje kronike, së cilës nuk po i kushtohet vëmendje e duhur. Ne mjekët e dimë se në raste të tilla është i vështirë shërimi, pra në rastet kronike të sëmundjes.

Zgjedhja e doktor Ferid Aganit ministër i Shëndetësisë para dy vjetësh zgjoi shpresat për rilindje të sektorit të Ekzekutivit dhe një sektor shumë i rëndësishëm për mirëqenien e popullatës. Ai doli para nesh me vizion dhe me ambicie se do të bëjë ndryshime, do të bëjë reforma në këtë sektor të shkatërruar gjatë regjimit të kaluar, por edhe të paregjeneruar fare në qeveritë, që pasuan njëra pas tjetrës, pas përfundimit të luftës.

Pra, pajtohem se e drejta e deputetit është të thirret në interpelancë edhe ministri i Shëndetësisë. Por, kërkesa për interpelancë e ka një arsytim të pamjaftueshëm dhe të paargumentuar mirë, krahasuar me titullin “Problemet në shëndetësi” dhe gjuajtja e fajit te Qeveria. Pastaj, shihet një tendencë, thua se Qeveria nuk paska bërë asgjë në këtë sektor dhe mohohet hyrja e reformave në shëndetësi, që nuk është e vërtetë, sepse reformat në shëndetësi tanimë kanë filluar.

Si anëtare e Komisionit për Shëndetësi, e di gatishmërinë e ministrit që t'i përgjigjet çdoherë komisionit dhe temat për të cilat është thirrur interpelanca janë diskutuar disa herë në Komisionin për Shëndetësi. Dhe, ai është thirrur nga vetë anëtarët e komisionit dhe është përgjigjur në këto pyetje, për të cilat sot po diskutojmë, ose për të cilat është thirrur interpelanca.

Në lidhje me konkurset për drejtorë të klinikave dhe shërbimeve në QKUK, e dimë se drejtorët e caktuar përkohësisht ndihen më pak përgjegjës, gjë që pasqyrohet me një

menaxhim më të dobët. Por, kjo ndodh edhe për shkak se ata nuk zgjedhën edhe për shkak të mosaprovimi të Ligjit të shëndetësisë, ku parashihet që punëtorët shëndetësorë më nuk do të jenë shërbyes civilë, dhe për të mos u zgjedhur e për të mos u ndërruar pastaj menjëherë, u prit hyrja në fuqi e Ligji për shëndetësisë, e kjo është thënë disa herë.

Mungesa e hyrjes në fuqi të Ligjit të shëndetësisë i ka stagnuar ose ngadalësuar reformat dhe kjo po sjell pengesa edhe në aprovimin e ligjeve tjera përcjellëse, e që momentalisht ndodhen në Kuvendin e Kosovës në shqyrtim. Do t'i numëroj disa prej tyre, që janë në fazën e kryerjes së punës në komision.

- Ligji për odat e profesioneve shëndetësore,
- Ligji për transplantimin e organeve
- Ligji për transplantimin e qelizave,
- Ligji për produktet dhe pajisjet medicinale e tjera.

Konkludojmë se pas hyrjes në fuqi të Ligjit të shëndetësisë, në Parlament së shpejti do të vijë edhe Ligji për sigurimet shëndetësore, që është kërkuar edhe nga kërkuesit e interpelancës. Ky ligj është shumë i rëndësishëm për fuqizimin e Ligjit të shëndetësisë, në përgjithësi.

Ministria e Shëndetësisë tani më e ka marrë pëlqimin e Fondit Monetar Ndërkombëtar dhe të Bankës Botërore për rrugëtimin e Ligjit për sigurimet shëndetësore.

Ne mund të themi se shëndetësisë i mungon shumëçka dhe e dimë këtë, e mbi të gjitha i mungon kualiteti i shërbimeve. Ka mungesa të etikës shëndetësore, të higjienës në institucionet shëndetësore, nuk respektohen të drejtat e pacientëve, ka mosrespektim të orarit të punës, mungesë të barnave dhe një menaxhim jo i mirë e jo i sanksionushëm deri më tani, e shkaqet duhet të kërkuar sigurisht dhe ato qëndrojnë jashtë temës, për të cilën po flasim.

Probleme gjithashtu ka dhe ato pranohen edhe nga vetë ministria, u tha edhe këtu tani pak më parë. Te lista esenciale të barnave, te mungesa e barnave. Ministria angazhohet, por problemet janë edhe të natyrave të llojllojshme, edhe të natyrës së prokurimit, edhe të interesimit të personelit që merret me këtë, edhe mosplanifikimit të duhur të kërkesës së barnave nga vetë institucionet që i kërkojnë ato.

Natyrisht, këtu duhet intervenuar dhe duhet të merren masa adekuate edhe nga Inspektorati Shëndetësor dhe organet përkatëse dhe të dënohen moszbatuesit e kryerjes së detyrave që u përkasin.

Por, në shëndetësi, natyrisht, ka edhe rezultate. Pse të mos përmenden edhe ato dhe gjithnjë kur flasim për shëndetësinë ne jemi mësuar të flasim për gotën gjysmë të zbrazët. Dhe, me këtë e sjellim një pesimizëm dhe mosbesim tek institucionet shëndetësore të vendit tonë.

Disa nga sukseset u përmendën, por unë do të shtoj një varg strategjish që u ndërtuan në Ministrinë e Shëndetësisë për një kohë të shkurtër, e këto janë, siç do t'i përmend:

- Strategjia për cilësinë e shërbimeve dhe të drejtave të pacientëve,
- Në proces është revidimi i strategjisë së shëndetësisë sektoriale,
- Është miratuar strategjia e shëndetit të nënës, fëmijëve, adoleshentëve dhe shëndetit riprodiktiv,
- Është në fazën e dytë dhe besoj në përfundim zhvillimi i strategjisë së sistemit të informimit në shëndetësi, e të tjera.

Janë organizuar shërbime të reja, si:

1. Shërbimi i radioterapisë,
2. Onkologjia funksionale,
3. Janë siguruar të dhëna për kancerin, dhe lista nga e cila për shembull vetëm në vitin 2012 kemi 2 311 raste të reja,
4. Kardiokirurgjia,
5. Është hapur reparti i ri i Emergjencës Pediatrike,
6. Është hapur Spitali i Mushkërive në Pejë,
7. Është siguruar terapia e rangut të dytë për tuberkulozin, e të tjera.

Gjatë vitit të kaluar u përmend specializimi në një numër shumë të shtuar, pastaj edhe punësimi i mjekëve, duke filluar nga praktika e përgjithshme. Janë ndihmuar mjekët në specializim nga regjioni i Preshevës, Medvegjës dhe Bujanocit dhe një nga Mali i Zi.

Janë dërguar 47 mjekë në kryerjen e trajnimeve shtesë profesionale në Turqi, Gjermani dhe Angli.

Janë përgatitur listat e çmimoreve të shërbimeve shëndetësore, që ka qenë një punë jo edhe e lehtë, e kjo po ndodh për herë të parë.

Dhe, ç'është më kryesorja, Ministria e Shëndetësisë ka ndërtuar marrëdhënie të shëndosha dhe funksionale ndërmjet Fondit Monetar Ndërkombëtar, Bankës Botërore dhe donatorëve, dhe kjo edhe jep shpresa për avancimin dhe realizimin e programit të reformave që pritet të bëhen. Gjithashtu, edhe Fondi i Shëndetësisë nga Qeveria duhet të shtohet dhe për këtë duhet të punojmë edhe ne si deputetë.

Një ndër rezultatet është sigurisht edhe vaksinimi i suksesshëm i fëmijëve vaksina, mund të thuhet ndër më të suksesshmit në regjion, dhe është evidentuar se problemi ekziston vetëm te fëmijët e komunitetit rom, ashkalinj dhe egjiptianë, për çka duhet punuar shumë në emancipimin shëndetësor të prindërve të tyre.

Pa dashur të qëndroj në anën e Qeverisë dhe të pacientëve, më duhet të flas edhe për problemet e shumta, të cilat sadopak i përmenda në këtë, dhe t'i bashkohem interpelancës, duke theksuar edhe probleme tjera.

E theksoj se Ligji i shëndetësisë është çelës i reformës shëndetësore. Zgjedhja e drejtorëve të institucioneve dhe sidomos sekretarit të përhershëm të Ministrisë është një çështje kyçe. Zhdukja e konfliktit të interesit, që është i pranishëm. Pastaj, të vazhdojë me

higjienën, me etikën shëndetësore, mbrojtja e standardeve në shëndetësi, shtimi i autoritetit, disiplinës dhe përgjegjësisë së Inspektoratit Shëndetësor, si instrument shumë i rëndësishëm për arritje, shtimi i buxhetit ushqim më cilësor dhe kushte më të mira për pacientët.

Rekomandimet për dërgimin për Ligjin për sigurimet shëndetësore tani më i tha edhe ministri. Ai ligj është në procedurë dhe pritet që shumë shpejt të vijë.

Reformat në shëndetësi dhe kudo qofshin nuk mund të bëhen nëse ato nuk kanë përkrahje politike. Dhe, pikërisht reforma në shëndetësi kërkon përkrahjen tonë, të të gjithëve. Faleminderit!

(Drejtimin e mbledhjes e merr nënkryetari i Kuvendit, zoti Xhavit Haliti.)

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike, zonja Hajzeraj-Beqaj e ka fjalën.

RITA HAJZERAJ-BEQAJ: Faleminderit, zoti kryesues!

I nderuar ministër,

Të nderuar deputetë,

Sa u përket çështjeve dhe mangësive e anomalive në sektorin e shëndetësisë, Grupi Parlamentar i LDK-së mendon se të gjitha ato probleme që kanë ekzistuar deri më sot, ekzistojnë përsëri, por vazhdimisht po shkojnë duke u thelluar, dhe ky është shqetësim për Lidhjen Demokratike të Kosovës.

Sa i përket buxhetit, i cili ndahet për Ministrinë e Shëndetësisë, që është 128,4 milionë, është diku rreth 8,1 e buxhetit në total, prej 1,5 miliard, atëherë konsiderojmë se ky buxhet është jashtëzakonisht i vogël dhe nuk i plotëson as për së afërmi kërkesat e qytetarëve të Kosovës, sa i përket aspektit shëndetësor. Dhe, kjo tregon më së mirë se kryeministri Thaçi, i cili jep vazhdimisht deklarata se sektori i shëndetësisë do të jetë prioritet nga të gjitha prioritetet tjera, tregon që nuk ka qenë asnjëherë prioritet dhe nuk do të jetë prioritet përderisa ekziston ky buxhet, që e kemi tani.

Lidhja Demokratike e Kosovës mendon se problemi kryesor në këtë kohë në institucionet shëndetësore publike është mungesa e barnave, të cilat shumica e pacientëve duhet t'i blejnë vetë.

QKUK-ja si institucioni i vetëm që ofron shërbime shëndetësore të nivelit terciar në Kosovë, sot ballafaqohet me probleme serioze në të gjitha aspektet e funksionimit, duke filluar nga furnizimi me barna dhe material elementar shpenzues shëndetësor, parakushte këto të domosdoshme për punë normale të një institucioni shëndetësor. Pra, mungojnë ilaçet dhe materiali shpenzues mjekësor elementar për funksionimin e reparteve më vitale, siç janë qendrat emergjente, sallat e operacionit, kujdesi intensiv, sallat e lindjes, e tjera.

Pacientët e hospitalizuar janë të detyruar ta blejnë shumicën e ilaçeve, duke përfshirë këtu edhe substancat narkotike.

Miratimi i Ligjit për shëndetësinë në Kuvendin e Republikës së Kosovës, pa Ligjin për sigurime shëndetësore dhe pa sistemin informativ shëndetësor, e bën këtë ligj të pazbatueshëm në praktikë. Dhe, zoti ministër, që ky ligj të funksionojë, duhet të vijë sa më shpejtë edhe Ligji për sigurime shëndetësore, sepse ashtu keni premtuar qysh para dy vjetësh.

Drejtorët e klinikave të QKUK-së, dhe kjo vetëm këto, por edhe në regjione, pra në nivelin tjetër të shëndetësisë, kemi vetëm ushtrues detyre, të cilët janë në kundërshtim me ligjin dhe kjo është shkelje e ligjit vazhdimisht, që i po bëhet kësaj kategorie, apo drejtuesve të drejtorëve të QKUK-së, apo klinikave tjera.

Po ashtu, problem tjetër është numri i madh i specialistëve, të cilët janë të papunë. Specialistët çdo ditë tanë i kryejnë specializimet, vijnë në dyert e spitalit dhe nuk gjejnë punë. Edhe ky është një shqetësim jashtëzakonisht i madh. Specialistët tanë çdo ditë duhet të aplikojnë që të shkojnë në vende tjera të regjionit, apo vende tjera të botës, që të gjejnë punë, sepse mjerimi për ta veç është parë edhe sipas statistikave.

Nëse sot e shohim një shumë të madhe, e cila derdhet në spitalet e regjioneve, atëherë kemi rreth 60 milionë euro, që qytetarët e Kosovës i derdhen në spitalet e regjioneve për shërbime jashtë vendit, që i bie se të gjitha pajisjet të cilat ekzistojnë në QKUK, shumica e tyre nuk funksionojnë, apo nuk funksionalizohen. Arsyeja për këtë nuk e dimë, sepse shpeshherë mungon edhe materiali, për të cilin duhet vënë në funksion, dhe herët tjera pajisja prishet, kurse materiali ekziston. Pra, asnjëherë nuk është mundësia që këto pajisje të funksionalizohen. Dhe, qytetarët detyrohen që të shkojnë nëpër spitale private, e po ashtu të dalin edhe jashtë shtetit.

Nëse sot e bëjmë një sondazh shumë të thjeshtë me qytetarët e Kosovës, do ta shohim që asnjë qytetar i Kosovës nuk do të thotë që gjendja në shëndetësi është e mirë.

Një pacient apo një qytetar, i cili sëmurët, së pari duhet ta gjejë një lidhje familjare apo nepotizëm, siç e quajmë ne, që të drejtohet në Qendrën Klinike Universitare, pastaj të fillojë trajtimin i tij për shërim. Nëse nuk e ka një lidhje familjare në këto institucione, ai nuk mund të drejtohet, sepse shumica e qytetarëve tanë, ne e dimë se tani 19% e qytetarëve janë në një varfëri ekstreme, pra është rritur varfëria ekstreme, e cila ka qenë në nivel më të ulët, ndërsa në këtë vit është shumë më e lartë, e kjo e prek sidomos këtë kategori të qytetarëve, të cilët shkojnë në QKUK, nuk kanë me vete para, nuk mund ta blejnë as barin esencial - infuzionin dhe duhet të kthehen, apo të mbeten korridoreve të QKUK-së. E, kjo e tregon më së miri gjendjen e shëndetësisë sot.

Pra, për pacientët tanë është shumë e thjeshtë që të gjendet zgjidhja. Pacientët tanë, ata të cilët janë të punësuar, janë të gatshëm ta paguajnë një shumë permanente që kur të ofrohen në qendrat klinike universitare ta kenë një trajtim të mirë, të mos e thirrën dikë të

bëjnë nepotizëm, ta thirrin një lidhje familjare që ata të fillojnë të trajtohen në spitale tona.

Dhe, nën tre, ata duhen që paratë të cilat i ndan shteti nga taksat e tyre, ato barna t'i gjejnë në ato spitale, e jo të kthehen duarbosh, shpeshherë edhe ta humbin jetën për shkak të këtyre anomalive. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Nga Grupi Parlamentar “Vetëvendosje”, zoti Aliu e ka fjalën.

LIBURN ALIU: Gjatë punës së Kuvendit në këtë legjislacion, energji të madhe dhe kohë ka marrë një temë që ka tërhequr vëmendjen dhe përkushtimin e deputetëve, por edhe të qytetarëve, e që është tema e reformës në shëndetësi. Pati interesim pasi pati edhe shpresë se ajo do të realizohet. Ministri Agani e ndërtoi shpresën për realizimin e reformës në shëndetësi që nga ardhja e tij. U shpresua, ndonëse përvoja nga e kaluara me funksionimin e shëndetësisë bënte të mos besohej shumë dhe jo ndoshta vetëm për fajin e ministrit, por për sistemin në tërësi.

Lëvizja “Vetëvendosje” pati paralajmëruar se reforma në shëndetësi është e shumë e vështirë pa ndodhur një reformë në tërë sistemin qeverisës në Kosovë. Ta reformosh shëndetësinë në dobi të qytetarit në ambientin e korrupsionit dhe logjikës së profitit, mendja racionale e nxjerr si të pamundur.

Ministri, sidoqoftë, besonte se do ta realizonte reformën dhe për këtë shpresonte edhe në mbështetjen e Qeverisë. Qeveria i dha atij shpresën për mbështetje, por jo më shumë. Dhe, ky asaj ia dha mbështetjen në të gjitha projektet e saj.

Ministri dhe subjekti i tij ia dha mbështetjen kudo që kryeministri e kërkonte. E, e kërkonte sa herë që kishte nevojë, dhe ajo i jepej. Dhe, ne duam të besojmë, por jo edhe të arsyetojmë se kjo u bë për hir të mbështetjes së premtuar në lidhje me reformën në shëndetësi.

Komiteti për Shëndetësi i Lëvizjes “Vetëvendosje” e ka trajtuar idenë e reformës që e kishte ministri, e po ashtu e ka dhënë edhe ide mbi ndryshimet e nevojshmet e nevojshme të sistemit, bazuar me planin qeverisës që e ka Lëvizja “Vetëvendosje”. Kemi bërë përpjekje ta përmirësojmë dhe në këtë aspekt kemi dhënë kontribut të vazhdueshëm në Komision, ku ministri ka qenë pjesëmarrës vazhdimisht në çdo mbledhje, e ku ka pasur debat kritik. Megjithatë, ligji edhe i tillë si kaloi mbeti larg reformës dhe pas shfuqizimit të nenit 41 nuk ka të bëjë më me asnjë lloj reforme.

Me programin qeverisës të Lëvizjes “Vetëvendosje”, reforma i ka katër shtylla, e secila nga to e domosdoshme për suksesin. Natyrisht, sfondi i reformës në tërë sistemin është ajo qenësorja - kryesorja, ajo që pa të cilën është e pamundur reforma, por edhe brenda reformës janë katër shtylla të domosdoshme për suksesin e saj.

E para, nuk mund të ketë reformë pa përfshirje të tërësishme dhe të drejtpërdrejtë të Ministrisë në këtë proces. Autoriteti i ministrit në reformë është i domosdoshëm, ashtu si edhe përgjegjësia e tij. Ministri e mendon se duke e bartur përgjegjësinë nëpër borde, në një sistem të ndarë, do të ketë reformë. E ka gabim.

E dyta, që të ketë funksionim të drejtë të sistemit të shëndetësisë, ai duhet të jetë unik, e jo kështu me shëndetësi primare të ndarë. Kjo pengesë natyrisht vjen nga Pakoja e Ahtisarit dhe tani me ligjin e ri, e ashtu si dhe me logjikën e marrëveshjes së fundit, kjo vlen vetëm për entitetin multietnik, ndërsa për pjesën serbe - jo, pasi ata mund ta ndërtojnë në mënyrë unike sistemin unik për vete, ndërsa te ne nuk mund ta bëjnë një gjë të tillë, pa lejen e tyre.

E treta, nuk mund të imagjinohet reforma në shëndetësi pa sistemin e sigurimeve shëndetësore, i cili e mbulon edhe shërimin të privatët në përqindje të lartë. Sistemi i sigurimeve shëndetësore, përpos që e mundëson reformën, është edhe garanci për suksesin e saj, pasi është në vetvete një sistem më i suksesshëm i kontrollit.

Dhe e katërta, nuk mund të ketë ndryshim cilësor e asnjë lloj reforme pa ndarjen e punës në atë publike dhe private.

Shfrytëzimi i pozitës në shëndetësinë publike për realizim të profitit me atë private ka qenë dhe mbetet sëmundja kryesore e sistemit shëndetësor. Kjo logjikë ka shkatërruar çfarëdo konsoliumi profesional në shëndetësi, ka krijuar ndarje dhe konkurrencë në bazë profiti ndërmjet kolegëve.

Dhe, kjo ishte pika e vetme e reformës së ministrit që pritej të realizohej dhe ne në këtë pikë edhe ne kemi mbështetur. Kjo pikë u hodh nga Gjykata Kushtetuese, me nismën e deputetit Muja.

Koncepti i profitit doli mbi atë të shërbimit kundrejt qytetarit. U mbrojtën biznesmenët shëndetësorë kundrejt pacientëve dhe mjekëve tjerë.

Zoti ministër, një element të vetëm pozitiv të reformës, pa të cilin nuk mund të imagjinohet ajo, jua rrënoi vetë pushteti. E tërë përkrahja që ia keni bërë kësaj qeverie deri tani, u hodh poshtë.

Nuk mendoj se e keni vendin aty në këtë Qeveri dhe njëkohësisht të thirrëni në subjektin që quhet Parti e Drejtësisë. Kjo Qeveri është diametralisht e kundërt me konceptin e drejtësisë dhe çdo ditë qëndrimi aty e shpërftyron këdo që thirret në të.

Nëse keni qenë oportunist kundrejt padrejtësisë së Qeverisë për hir të reformës në shëndetësi, edhe pse nuk pajtohemi se nuk e konsiderojmë reformë të plotë, tani nuk po e kuptoj përse rrini aty ku jeni. Për të mbështetur marrëveshjet e Thaçit dhe për skandalet e privatizimit. Kjo nuk ka të bëjë me drejtësinë. Andaj ju bëjmë thirrje të jepni dorëheqje, sepse kjo është në të mirën tuaj.

Sa u përket rekomandimeve, ne do t'i votojmë, por mendojmë se janë të pamjaftueshme për ndryshime.

KRYESUESI: Faleminderit! Replikë, zoti Muja e ka fjalën.

SHAIP MUJA: Rrallë dilet për të bërë replikë kështu në foltore, por desha t'ia shikoj fytyrën, se unë u skuqesha çfarë fliste Liburni për nenin 41. Dhe ministrin e keni vënë ju në lajthitje. Një pjesë nuk ia keni haberin çka është sistemi shëndetësor.

Prandaj, interpretimi që e ka bërë Gjykata Kushtetuese, mos u mundo ta kapitalizosh për nivel politik, sepse kjo nuk ka kurrfarë vlere. Dhe, vajtimin që ua bën ti punonjësve shëndetësorë dhe që e bënë për t'i denigruar punonjësit shëndetësorë, ti nuk e di sakrificën e shkollimit të një doktori dhe cilësinë e tij çka mund të kontribuojë për qytetarët që ti i vajton çdo ditë.

Prandaj, hiqi këto spekulime politike. Unë nuk jam pishman që e kam dërguar atë, sepse i kam mbrojtur punonjësit shëndetësorë. Ministri nuk është përfaqësues i krejt punonjësve shëndetësorë, por jeni ju, të cilët as nuk e keni lexuar ligjin dhe viheni në lajthitje.

E ftoni ministrin për sigurime shëndetësore, kur nuk e dini as çka janë sigurimet shëndetësore. As metodologjinë e implementimit të sigurimeve shëndetësore nuk e dini, përveç se të dilni në televizion këtu dhe të dukeni sikur nxjerr lot krokodili.

Qëndrimi i Partisë së Drejtësisë në koalicion, që të mundohesh ta politizosh, tregon që nuk ke vlerësim profesional, por ke interes të politizimit të çështjes. Problemet janë evidente në shëndetësi, jo vetëm në Kosovë, por në krejt botën, përfshirë krizën ekonomike e cila ka ardhur. Prandaj, mësoni të bëni propozime, të cilat mund ta nxjerrin nga kriza, e jo vetëm konkludime për të keqen. Kjo shëndetësi ka të arritura, nuk ka të paarritura; kjo Qeveri ka investuar nga 2010-ta deri tash 50 milionë euro, më shumë se çdo qeveri...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Faleminderit! Kundër-replikë, zoti Aliu.

LIBURN ALIU: E kuptoj shumë sikletin tuaj, zoti Muja. Jo vetëm tuajin, por komplet të Qeverisë. Ju jeni në siklet. Natyrisht jeni në siklet, sepse jeni përherë e më shumë në kundërshtim me interesin e qytetarëve. Kur flitni për punonjësit shëndetësorë, mos i përdorni fjalët 'punonjës shëndetësorë'. Përdorni fjalët 'biznesmenët shëndetësorë'. Ata që ju mbronin janë vetëm biznesmenët shëndetësorë, jo punonjës shëndetësorë. Pra, jo punonjësit shëndetësorë që sakrifikohen çdo ditë për qytetarët dhe për pacientët, jo për pacientët që do të duhej të ndihmoheshin nga sistemi shëndetësor. Ju mund të flisni për biznesmenët shëndetësorë.

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të AAK-së, zoti Ardian Gjini e ka fjalën.

ARDIAN GJINI: Faleminderit, zoti nënkryetar i Kuvendit,

Të nderuar deputetë të Kuvendit të Kosovës,

Është një tregim i vërtetë që ka qarkulluar nëpër Kosovë një kohë të gjatë, e ky tregim nuk ka lindur gjatë kohës sa zoti Agani ka qenë ministër, është e vërtetë. Tregimi thotë kështu: Qeveria e Kosovës ka kërkuar donacion prej një donatori ndërkombëtar, 40 mijë euro për ta ndërtuar kulmin e një spitali në Kosovë, i cili ka qenë duke pikuar. Ajo organizatë ndërkombëtare, ai shtet i ka dhënë 40 mijë euro për ta rinovuar kulmin e një spitali, e një javë më vonë një ministër ka blerë veturë 50 mijë euro. Kjo është goxha fyese për shtetin tonë, të kërkohet donacion për ta ndrequr kulmin e spitalit, e të blihet veturë javën tjetër që kushton pak më shumë se kulmi i spitalit. Kjo ka ndodhur në Kosovë. Kjo është ngjarje e vërtetë. Arsyeja pse nuk i përmenda qytetin dhe ministrin ka të bëjë me atë se unë nuk po dua ta shndërroj debatin këtu në diçka tjetër.

Tani një fjalë anglisht thotë, po e përkthej në shqip, ‘ministri e ka zemrën në vend të duhur’, do të thotë “his heart is in the right place”. Domethënë, është e vërtetë që e ka zemrën në vend të duhur, po duket kjo. Domethënë që është i mirë, është njeri i mirë, dëshiron të bëjë diçka. Po, a është e mjaftueshme ta menaxhojë sistemin e shëndetësisë në Kosovë ta ketë zemrën në vend të duhur. Unë po ju them që nuk është. Është e pamjaftueshme. Mund të jetë kusht i nevojshëm, por totalisht i pa mjaftueshëm.

Ministri na i përmendi sfidat e trashëguara. Shikoni, nuk është çudi, nuk është as befasi, edhe kryeministri Thaçi, gati 6 vjet pasi ka ardhur në pushtet, i përmend sfidat e trashëguara. Mund të them që për çdo njeri që pak kupton nga qeverisja dhe nga sistemi normal kjo nuk do koment. Nuk do koment të jetë në pushtet për kaç kohë dhe të thirret në sfidat e trashëguara dhe të thotë nuk po kemi çfarë të bëjmë.

Mirë, një vend me 2 milionë banorë, për dy vjet, të paktën disa prej sfidave të trashëguara është dashur të rregullohen. Është hera e tretë që unë në këtë foltore të Kuvendit u them se në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës pikojnë tualetet. A keni shkuar dikush në tualet në Qendrën Klinike Universitare? Vetëm kaç po ju pyes. Asgjë më tepër hiç. Nuk e di, dikush ndoshta ka qenë, dikush jo. Keni qenë ndoshta ta shihni dikë që është i sëmurë aty, veç po ju them që në atë qendër nuk keni si të hyni në tualet. Pacientët nuk kanë si të hyjnë në tualet. Po t’i shihni se me çka mbulohen ata natën, po t’i shihni çfarë jastëkësh kanë! Ju veç mund të mendoni se jeni, jo në ndonjë shtet të botës së re, por ndoshta duhet gjetur edhe të botës së katërt.

Tani për dy vjet, a nuk pasur mundësi bile kjo punë të kryhet? Lini ato të mëdhatë, ato letra, ato farë sisteme... Edhe ato duhet të kryhen bile, bile për afat gjatë janë esenciale, por një spital! Një shtet, me 2 milionë banorë, 5 vjet shtet i pavarur, një spital, vetëm një spital me tualete të pastra! Asgjë më tepër nuk po kërkon ky vend.

Ministri e tha edhe një fjalë tjetër. Tha ‘ndarja buxhetore jo e duhur, ose jo adekuate’. Iu referua pak kolegu Aliu. Shihni, është kryetari i një partie që është në koalicion dhe dy vjet pasi ka hyrë në koalicion ankohen se Qeveria nuk po i jep buxhet për t’i rregulluar prioritetet e veta që i ka. Me të vërtetë është absurd, ose nuk ka fuqi t’i imponojë idetë e veta në mbledhjet e Qeverisë, ose ka një problem këtu, se nuk mund të thotë kryetari i një

partie që është në koalicion, edhe në pushtet, që nuk po i jep buxhet Qeveria e tij dhe çfarë buxhet po kërkon.

Prapë po kthehem te veturat. Nëse njërit prej ministrave i prishet një veturë, po ju garantoj që do të gjenden mjetet prej Ministrisë së Financave, me intervenim të shpejtë, që të nesërmen në mëngjes të prokurohen dhe të blihet, sado të kushtojë. E nuk po mund t'i gjejnë do mjete për t'i ndrequr tualetet në Qendrën Klinike Universitare, në spitalin kryesor të shtetit.

Për të mos i zgjatur tepër këto gjëra, po flas pak në përgjithësi. Ministri i përmendi të arriturat, i përmendi disa të arritura dhe definitivisht se ka lëvizje, devinitivisht se ka ngjarje, por ato që i përmendi ministri po ju garantoj që kanë mundur të ndodhin edhe po të mos kishte fare ministër, po të mos kishte fare Ministri, veç një agjenci ekzekutive krejt të vogël, e cila merret me tema të shëndetësisë. Të njëjtat zhvillime ndodhin. Mos harroni se po të ishte thirrur ministri i atëhershëm i Shëndetësisë i viteve të '90-ta, kur s'kemi pasur fare shtet e buxhet, dhe t'i thuhej 'numëroji të arriturat', dhe ai do t'i numëronte disa të arritura, si sa specialistë kanë shkuar jashtë vendit, sa bursa i ka dhënë atëherë buxheti i Kosovës, domethënë i 3%, sa klinika private janë hapur, sa klinika i kem hapur ne me atë farë buxheti që e ndanim nga 3%. Po, edhe atëherë ka mundur të përmend të arritura. Për çfarë të arriturash po flasim ne në shëndetësi?

E arritur në shëndetësinë normale mund të jetë nëse ministri na thotë sot se një pacient, i cili dërgohet ose shkon vetë, që është absurd se nuk ka spital në Prishtinë, ende nuk ka spital në Prishtinë, dhe Qeveria i ka fajet, nuk i ka fajet Komuna, a e gjen ai pacient më mirë sot se para dy vjetësh? Kjo është e arritur dhe me qëllim po përmendi Qendrën Klinike Universitare për shkak se është spitali kryesor i shtetit të pavarur. Aty duhen të shërohen prej Presidentes, ambasadorët, dhe cilido qytetar i Kosovës. A shkojnë të shërohen aty? A shkon dikush që e ka një status në shoqëri të shërohet aty? Po çfarë! Nuk donë as të afrohen. Përtojnë të shkojnë edhe t'i shohin kolegët e vet aty, për shkak se aty është katastrofë, aty ka qenë nëpër oborr, aty ka mbeturina në oborr, aty pikojnë tualetet. Edhe një herë po ju them, se po më duket se është aq banale mos t'i bjerë në vesh dikujt, që është e pamundshme. E të na flitet për sisteme të mëdha shëndetësore, kur nuk mund të bëhet një spital normal në shtet, është krejt e kotë.

Unë mendoj se këto tema nuk duan koment. Shpresoj se për pjesën e mandatit sa i ka mbetur, ministri do ta ndajë një veturë të një ministri për t'i ndreq bile tualetet dhe t'i ndërrojë jastëkët në Qendrën Klinike Universitare. Nëse nuk e bën, ndoshta dikur del dikush e bën, ama të vijë të na tregojë për të arritura është goxha problem. Faleminderit!

KRYESUESI: Replikë, zoti ministër.

MINISTRI FERID AGANI: Faleminderit, zoti kryesues!

Në esencë jo replikë e drejtpërdrejtë, por një përmbledhje, një reagim në këto diskutime që u bënë deri tash, meqenëse folën disa prej grupeve parlamentare.

Unë dua të theksoj se kam besim të thellë në këtë reformë, të cilën e kemi përgatitur. Ata që mendojnë që shëndetësia kosovare, ose që kanë menduar që shëndetësia kosovare mund të rregullohet duke i rregulluar tualetet në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës, mendoj që e kanë një vizion shumë të ngushtë të shëndetësisë. Duke mos e zvogëluar rëndësinë edhe peshën e problemit që e shtroi deputeti Gjini, megjithatë reforma e sistemit shëndetësor nënkupton përgatitje esenciale.

Në qershor të vitit 2011 nuk ka pasur kurrfarë interesimi, as nga Banka Botërore, as nga FMN-ja, as nga Komisioni Evropian për sektorin e shëndetësisë në Kosovë. As nuk është folur për reformë.

Ministria paraprake ka punuar dy vjet në reformë, të nxjerrë ligje të shëndetësisë, Ligjin e sigurimeve shëndetësore e tjera. Asnjë rezultat nuk ka ekzistuar. Sot jemi në pikën kur e kemi një mbështetje të fuqishme dhe të përditshme të Bankës Botërore me ekspertët më eminentë. Unë erdha prej takimit sot në ministri me ekspertin e Bankës Botërore për sektorin farmaceutik, që ka ardhur enkas, sot dhe nesër, të jetë me ne për të gjetur zgjidhjet për problemet që u përmend sot. Kam bindje të thellë se kjo reformë do të ketë sukses.

Unë thashë se është miratuar Ligji i shëndetësisë në këtë Kuvend më 28 qershor 2012, por ai ende nuk ka hyrë në fuqi. Si mund të ndryshohet sistemi shëndetësor që ka gjeneruar dhe po i gjeneron këto dobësi, pa hyrë në fuqi ligji i cili duhet t'i promovojë këto ndryshime, t'i mundësojë këto ndryshime? Prandaj, unë ju lutem për një debat serioz në këtë temë, të mos tentojmë të bëjmë përfitime politike në këtë çështje, sepse shëndetësia...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Vazhdo edhe pak.

MINISTRI FERID AGANI: ...nuk rregullohet brenda një viti, madje kursesi pa mekanizma të duhur ligjorë. Pse ka ngelur Ligji i shëndetësisë në Kuvend të Kosovës i pamiratuar prej 28 qershor 2012 deri më tani, është çështje që është jashtë kompetencës së Ministrisë së Shëndetësisë. Prandaj, kjo është çështje e cila e reflekton seriozitetin e problemit, kompleksitetin e çështjeve dhe e vërteton atë fakt se reformat më të vështira në një ekonomi të vendit janë në sektorin e shëndetësisë. Kjo është e njohur. Në reformat e sistemit shëndetësor kanë rënë edhe kryeministra të mëdhenj, e jo më ministrat.

Prandaj, unë po e them edhe një herë dhe nuk kam dëshirë që të ndërlihet pozita ime si kryetar i partisë brenda Qeverisë. Në qoftë se jam i pakënaqur me diçka, jam me dinamikën e çështjes. Në përmbajtje, natyrisht e kam ndier të cunguar Ligjin e shëndetësisë me heqjen e tre paragrafëve të nenit 41, pa asnjë diskutim. Mirëpo, do ta punojmë atë që ka mbetur. Kanë mbetur tre paragrafë tjerë, të cilët qartë e sanksionojnë qëllimin e atij paragrafi, e ndalojnë referimin e papërgjegjshëm nga sektori publik e privat, e sanksionojnë këtë me marrjen e licencës për 6 muaj, e ndalon çfarëdo

kompensimi financiar të mjekëve për referime nga sektori publik në privat. Prandaj, i kemi instrumentet në dorë dhe do ta realizojmë edhe esencën për të cilën po flasim.

Prandaj, të ju them edhe një herë që unë mendoj se e arritura më e madhe e kësaj ministrie nuk është ajo që e përmenda në numra, edhe pse secila prej tyre është një e arritur e veçantë. E arritura më e madhe është se reforma e sistemit shëndetësor të vendit është e përgatitur në mënyrë shumë studioze, është e bazuar, është e mbështetur në fakte shkencore, e ka ekspertizën ndërkombëtare dhe mbështetjen vendore edhe të atyre, të cilët e kanë penguar direkt dhe indirekt deri më tani, dhe unë jam i bindur se në momentin e hyrjes në fuqi të Ligjit të shëndetësisë dhe me miratimin e Ligjit të sigurimeve shëndetësore, që do të vijë shpejt pas fillimit të implementimit të Ligjit të shëndetësisë, do ta kemi një situatë tjetër. Dhe, kjo është reforma, duke mos anashkaluar ato që u thanë dhe të gjitha ato vështirësitë, të cilat u përmendën. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Replikë, zoti Gjini.

ARDIAN GJINI: Faleminderit, zoti kryetar!

Mendoj se përpara e kemi ministrin e Shëndetësisë, e jo ministrin e reformës shëndetësore. Ministri i Shëndetësisë, i cili i ka kushedi sa departamente, divizione, kushedi sa nën-institucione edhe të gjitha ato janë për t'u marrë me shumë punë për të njëjtën kohë, jo vetëm me reformë. Nuk mund të na thënë ju që jeni ministër i reformës zgjedhore. Je ministër i Shëndetësisë. Edhe tualetet në QKUK, edhe jastëkët, janë punë e juaja. Absolutisht po.

Një aforizëm i Sami Frashërit, që është i huajtur, në fund të fundit, nuk është krejt i tij, por ai e ka shkruar: Nuk priten punë të mëdha prej atyre që i injorojnë të voglat, zoti ministër. Faleminderit!

KRYESUESI: Në rregull! Zoti ministër, e keni fjalën. Në qoftë se për çdo fjalë bëjmë replika dhe kundër-replikë, është problem me kohën.

MINISTRI FERID AGANI: Definitivisht nuk anashkalohen çështjet e vogla. Po shihet që nuk jeni i informuar dhe normalisht që nuk jeni i informuar me dinamikën e punës dhe çka punohet në ministri, edhe me çka merret ministri, deri edhe me sistemet e ventilimit në sallat e operacionit, edhe në Kardiokirurgji, edhe me rregullimin e tyre brenda javës, për të arritur funksionalizimin. Por, kur unë e kam marrë këtë detyrë, e kam marrë në mënyrë që ta projektoj një vizion të mbështetur në fakte, në përvoja, një vizion serioz, i cili i ka munguar kësaj shoqërie, i ka munguar këtij Kuvendi me vite të tëra.

12 vjet nuk është arritur që të vijë në këtë pikë Ligji i shëndetësisë, që u miratua në vitin 2004. Ka qenë i shkruar nga unë në Ministrinë e Shëndetësisë. Kam qenë kryetar i Komisionit. Edhe sot jam ai i cili e ka shkruar ligjin e dytë, e kjo nuk është e rastit.

Unë po ju them se keni problem të madh edhe në parashtrësë. Keni problem konceptual. Ja çfarë shkruan në parashtrësën që ju e keni nënshkruar. Ju e keni nënshkrua këtë parashtrësë, e thoni këtë: "Gjendja në shëndetësi është pasojë e keqmenaxhimit, e

joprofesionalizmit të zinxhirit menaxhues të institucioneve shëndetësore, dhënies së kompetencave të dyfishta dhe moskontrollimit të efektivitetit të tyre. Kjo e shfaq një pasqyrë reale të kësaj ministrie”.

Katër paragrafë më poshtë, thoni: “Institucioneve shëndetësore u është marrë autonomia e veprimt dhe çdo hap i institucioneve shëndetësore është i kontrolluar nga kjo ministri”. Kjo është ‘kontradicio adjecto’. Me këtë koncept politik, kur nënshkruani kështu, mos u habitni se pikojnë tualetet, sepse përgjegjësia nuk mbetet as andej as kënde, dhe kjo ka qenë praktikë e deritanishme në këtë sistem shëndetësor dhe në këtë shoqëri. Në të ardhmen nuk do të ketë. Do të ketë përgjegjësi të ndarë qartë të institucioneve shtetërore që bëjnë politika, rregullojnë, monitorojnë, kontrollojnë, edhe atyre që duhet t’i mirëmbajnë tualetet, e në qoftë se nuk i mirëmbajnë japin përgjegjësi para shtetit. Dhe, nuk ka rrugë tjetër.

Kemi ardhur në një fazë tjetër të zhvillimit. Nuk jemi në fazën emergjente që ministri t’i rregullojë tualetet. Ministri do të bëjë politika. Do ta monitorojë zbatimin e tyre dhe do t’i ndëshkojë ata të cilët nuk i zbatojnë ato, që nuk e zbatojnë ligjin. Kjo është detyra e ministrit. Ministri nuk ka detyrë tjetër.

KRYESUESI: Faleminderit! Minutat e grupit nëse do t’i marrësh, diskuto sa të duash. Zoti Gjini e dëshiron fjalën prapë. Vazhdoni!

ARDIAN GJINI: Faleminderit, zoti nënkryetar!

Po i tregoj ministrit se nuk kam nevojë hiç të shkoj në Ministrinë e Shëndetësisë. Nuk kam nevojë hiç ta di çfarë bën Ministria e Shëndetësisë. Mjafton të shihen spitalet, mjafton të shihen ambulancat, mjafton të dihet vdekshmëria e foshnjave dhe e nënave, mjafton të shihet se çfarë barnash merren. Mjaftojnë këto. Për çfarë kam për të shkuar në ministri unë? Për çfarë ka për të shkuar një qytetar në ministri, kur nuk merr kurrfarë shërbimi në spital? Se di çfarë është kjo temë kështu!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti ministër! minutat i kanë të grupeve parlamentare dhe jemi duke llogaritur.

MINISTRI FERID AGANI: Zoti Gjini, kur është në pyetje e vdekshmëria e foshnjave, po ju tregoj çfarë realiteti kemi pasur. Kosova ka jetuar, në të gjitha ministrinë deri më sot, me indikatorin e vdekshmërisë prenatale, se në Kosovë është 18,9 promil. Është dashur të involvohet vetë ministri vetë personalisht edhe ta kuptojë që ky raportim është bërë gabimisht. Dhe, nuk e kemi 18,9, por e kemi 12 promil. Pra, nuk jemi shteti me vdekshmërinë më të madhe të foshnjave në Evropë.

Pra, po e shihni me çka duhet të merremi, dhe unë dëshiroj prapë të them që nuk është mirë të politizohet ky debat. Ju e dini mirë dhe besoj se pajtoheni me këtë. Një reformë, e cila projektohet, përgatitet, duhet të fillojë të zbatohet për të pasur rezultate. Është absurde që një reformë e projektuar me një ligj, i cili ende nuk ka hyrë në fuqi, të pritët të japë rezultate në anën tjetër. Nuk është mirë të dënohet me vdekje diçka që ende nuk ka lindur. E ju jeni kah e bëni këtë.

Ju po e përshkruani një gjendje që është gjeneruar nga ky sistem shëndetësor. Ky sistem shëndetësor është sistem i pasluftës, ky sistem emergjent. Prandaj, shkop magjik nuk ka. Unë kisha pasur dëshirë ta kem, por nuk e kam. Nuk ka shkop magjik që për një vit a për dy vjet mund ta zgjidhë problemin. Unë kisha pasur dëshirë ta kem. Ma tregoni një shtet në botë që ka arritur ta bëjë këtë, që është një përvojë diku, dhe unë po pajtohem me faktet dhe argumentet tuaja. Por, nuk ka, fatkeqësisht jo.

KRYETARI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar Koalicioni Kosova e Re, kryetarja zonja Selmani.

MYZEJENE SELMANI: Faleminderit, i nderuar nënkryetar i Kuvendit!

Përshëndetje për dy ministrat,

Dua të shpreh qëndrimin e Grupit Parlamentar të Koalicionit për Kosovën e Re në lidhje me interpelancën, në të cilën është ftuar ministri i Shëndetësisë, zoti Ferid Agani.

Duke marrë parasysh se Koalicioni për Kosovë të Re i jep përkrahje ministrit në reformat në sistemin shëndetësor dhe pas implementimit të Ligjit të shëndetësisë besojmë dhe shpresojmë shumë shpejt që në këtë Kuvend do të vijë Ligji për sigurimet shëndetësore.

U pa që ministri e solli Ligjin e ri për shëndetësi në Kuvendin e Kosovës, por çështja e implementimit të tij do të marrë kohë. Në çështjen e implementimit të tij do të jemi përkrahës edhe Kuvendi dhe të gjithë, për arsye se është nevojë personale, edhe e deputetit, edhe e ministrit, edhe e Kryeministrit, edhe e Presidentes që në rast të një sëmundjeje duhet t'i nënshtrohet sistemit shëndetësor, sepse nuk kanë kah të ikën.

Ministër, do të japim përkrahje deri në momentin të fundit për çfarë ka nevojë për reformën në shëndetësi. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka zonja Bakalli.

AURORA BAKALLI: Faleminderit, kryesues!

I nderuar ministër Agani,

Të nderuar deputetë,

Gjendja në shëndetësi në Kosovë, posaçërisht në sektorin publik është shumë e rëndë dhe në fakt, ky konstatim nuk është ndonjë zbulim i madh. Këtë do ta thotë çdo qytetar i Kosovës po qe se e pyetni.

Edhe gjatë kohës që e drejtoni ju këtë ministri, zoti Agani, edhe përkundër premtimeve të mëdha që keni dhënë, ky sektor vazhdon të mos ketë përmirësim, përkundrazi. Ju zoti ministër këtë ngecje po ia atribuoni vonësës së Ligjit për shëndetësi, por për shumë gjëra, po e përsëris, për shumë gjëra kjo nuk është justifikim.

Shqetësimet e mia dhe të Lëvizjes për Bashkim për shëndetësinë i kam shfaqur shumë herë këtu, ndërsa sot dua të bëj më shumë pyetje, për të cilat shpresoj të marr përgjigje nga ju.

Pyetjet e mia për ju në këtë interpelancë janë:

1. Pse vazhdon të ketë mungesë të madhe të barnave, materialit shpenzues, reagjensëve laboratorikë në sektorin publik shëndetësor? Po ju rikujtoj se shumë shpesh mungojnë edhe gjërat elementare, si shiringat dhe gjilpërat, të cilat vërtet nuk janë të kushtueshme, por të jeni të bindur se ndikojnë shumë në mbarëvajtjen e punës në spitalet tona. Në kirurgji mungojnë madje edhe penjtë operativ, mos të flasim për gjëra tjera.

Çka është e keqja e gjithë kësaj? E keqja e kësaj është se stafi mjekësor dhe të sëmurët kanë filluar të konsiderojnë këtë gjendje krejtësisht të alteruar si normalitet.

2. Pse po lejohet që Qendra Klinike Universitare e Kosovës, qendër e vetme që ofron shërbime terciare shëndetësore në vend, të luajë rolin e një qendre parësore, ku specialistët kanë marrë rolin thjesht të një mjeku të praktikës së përgjithshme, që ka për detyrë të vulosë dhe firmosë udhëzimet për t'i dërguar pacientët në spitalet private të vendit, të privilegjuarat, natyrisht? Në vend se të pajiset QKUK, të edukohet stafi vendor, këta janë kthyer në servis të spitaleve private, shumë më të vogla se sa ai në të cilin janë duke punuar.

Dhe, çka është e keqja e kësaj, është degradimi i stafit vendor me pasoja shumëfish më të mëdha në të ardhmen, në aspektin kuadror.

3. Pse ka shumë pacientë që presin mbi dy vjet në radhë për shërim jashtë vendit, ndërkohë që është hapur një deriçkë që lejon mundësinë e intervenimeve urgjente në spitalet private me financim nga Ministria juaj?
4. Pse nuk po furnizohet me material shpenzues QKUK, ani pse do të kushtonte dukshëm më lirë se sa shërimi jashtë vendit apo institucionit, për aq më tepër duke poseduar me stafin që do të mund t'i kryente një pjesë të mirë të këtyre shërbimeve?

Këto janë disa nga vërejtjet dhe pyetjet që pata mundësi t'i parashtroj brenda kohës së paraparë dhe jam thellë e bindur se për këto çështje nuk ka nevojë për ligj të ri të shëndetësisë.

Ndërsa, sa i përket diskutimit tuaj, ndër të arriturat përmendët edhe fillimin e punës së Kardiokirurgjisë, por zoti ministër, kjo kardiokirurgji që keni inauguruar, ka shumë më shumë rolin simbolik dhe për marketing politik, se sa për t'i zgjidhur problemet, pasi që aty trajtohet një pacient në javë apo në dy javë, përderisa me dhjetëra të tillë paguani ju që të trajtohen në spitalet private kardio-kirurgjike në vend. A nuk do të kushtonte më lirë dhe a nuk do të ishte në të mirën e të gjithëve, sikurse të funksionalizohej si duhet kardio-kirurgjia publike, e jo në këtë mënyrë siç është bërë, krejtësisht simbolike dhe për marketing politik, në këtë radhë tuajin e jo siç na akuzoni gjithnjë neve për ankesa që i kemi se i bëjmë për poenë politikë?

Përmendët edhe një numër imponant ndarjesh të specializimeve, punësime të mjekëve, stafit mjekësor, madje i përmendët edhe punësimet në sektorin privat, por zoti ministër, që të jeni bindës në këtë pikë është dashur të na tregoni se sa ka pasur specializime në mandatet para jush, sa ka pasur të punësuar në mandatet para jush, sepse vetë unë kam marrë specializim në mandatin para jush, jam punësuar në një mandat të ministrit tjetër. Që të shohim se vërtet ka pasur një trend pozitiv dhe një rritje, duhet të na prezantoni shifrat edhe të mandateve para jush. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti ministër e keni fjalën.

MINISTRI FERID AGANI: Zonja Bakalli,

Si zakonisht, te pyetjet e shumëfishta niset me atë të fundit. Aktualisht në specializim me kontrata në Ministrinë e Shëndetësisë janë 738 specializantë, do të thotë, para dhënies së këtyre 550 specializimeve, për dy vjet kanë qenë gjithsej 188. Besoj që i keni të qartë tash përmasat dhe dimensionin e ndryshimit.

Unë nuk po hyj të flas këtu për ndryshimin e strukturës së komiteteve specialistike, krijimin e konceptit të kujdesit të integruar shëndetësor e tjerë, e tjerë, sepse nuk janë detaje që duhet t'ju lodh tash me to. Ju e dini mirë çfarë problemi keni pasur kur është në pyetje baras vlerësimi i përvojës suaj profesionale dhe s'keni pasur të drejtë as të punoni si kardiologe, deri në momentin kur nuk iu ka baras vlerësuar një përvojë e punës në Klinikën e Kardiologjisë të Qendrës Klinike Universitare të Kosovës dhe keni qenë në situatë që të jeni edhe jashtë ligjit, duke ushtruar punën si kardiologe, edhe pse keni pasur të drejtë plotësisht. Dhe, nuk po e përmendni fare që kjo ka qenë e arritur e kësaj Ministrie, për një problem që është udhëhequr 5 vjet më herët.

Unë i kam gjetur kërkesat e kolegëve tuaj që punoni me ta lidhur me këtë çështje. Nuk është mirë që të merreni vetëm me aspektet negative të çështjeve. Të thuash për një shërbim kardio-kirurgjik, që nuk ka arritur kurrë të funksionalizohet në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës, asnjëherë, të thuash se është marketing politik, është me të vërtetë joserioze, është nënçmim së pari i atyre kardio-kirurgëve, që kanë aplikuar për punë aty. Tre kardio-kirurgë do t'i kemi me orar të plotë të punës, për ata 15 anestezistë, infermierë, të cilët janë të punësuar me orar të plotë të punës në atë shërbim, që do t'ju shërbejë juve si shërbim mbështetës për shërbimet e kardiologjisë invazive e jo të bëni sikurse keni bërë deri më tash, koronarografi e pa mbështetje kardiokirurgjike duke vënë në rrezik drejtpërdrejt jetën e qytetarit.

Prandaj këto janë gjëra konkrete, në qoftë se duam të hyjmë në detaje, ne hyjmë në detaje dhe e kuptojmë se ku keni jetuar dhe punuar deri para dy vjetëve dhe në çfarë fushe po hyni tash?

Keni premtuar, zoti ministër, se do ta ndryshoni shëndetësinë kosovare dhe po justifikoheni që s'u miratua Ligji i shëndetësisë, prandaj nuk po mund ta ndryshoni, po normal që justifikohem. Si ta ndryshosh sistemin? Si ta bëj unë Qendrën Klinike Universitare bartëse të aktiviteteve?

Sot drejtori i Qendrës Klinike Universitare të Kosovës i përgjigjet sekretarit të përgjithshëm të Ministrisë. Me ligjin e ri drejtori i Qendrës Klinike Universitare të Kosovës do t'i ketë së bashku me drejtorët e spitaleve rajonale, të gjitha kompetencat për organizimin e shërbimeve klinike. Do të ketë të drejtë, madje të hyjë edhe në marrëdhënie kontraktuale me fondet e sigurimeve shëndetësore private në vend dhe jashtë vendit, do të ketë të drejtë ta thërrasë drejtorin e një agjencie të sigurimeve shëndetësore në vend, thotë: “Pse po i paguani ju 1 milion e gjysmë euro në një spital në Maqedoni, kur ne mundemi për këto para, t' ju ofrojmë shërbimet e Qendrës Klinike Universitare të Kosovës” edhe i rregullon me ato para tualetet menjëherë edhe i rregullon çarçafët, e rregullon ushqimin edhe krejt. Nuk ka nevojë për ta lutur, para prej Ministrisë së Shëndetësi e unë ta lus në Qeveri për para, i gjeneron vetë. Pra, një model bashkëkohor i sistemit shëndetësor, të cilin sot Britania e Madhe e ka. Unë isha para një muaji e gjysmë në Britani të Madhe, në Britani të Madhe e kanë transformuar sistemin e tyre publik, National Health Service e kanë bërë NHS-foundation – fondacion. I njëjti model sikurse në Kosovë, vetëm se atje kontraktohet kujdesi parësor, ne do t'ia japim të gjitha kompetencat Qendrës Klinike Universitare, që nuk është spital, Qendra Klinike Universitare është 15 spitale në një vend.

Prandaj vetëm sistemi, ndryshimi i sistemit e mundëson ndryshimin, të gjitha të tjerat janë manipulime, improvizime dhe interpretime të ndryshme.

Pse nuk ka barna? Pyetje me vend.

Unë them, jo për shkak të mungesës së parave, barna nuk ka pasur për shkak të dobësive ekstreme në planifikim, furnizim dhe prokurim.

Kur thash se sistemi anakronik me kohë është korrupsuar, në radhë të parë mendova në sektorin e farmacisë, sektorin farmaceutik dhe ky është realitet. Jemi duke e ndryshuar në mënyrë përmbytëse dhe jeni dëshmitarë edhe vetë, se janë kah vijnë kërkesa për barna për të cilat me të vërtetë kanë nevojë qytetarët e jo operatorë të ndryshëm ekonomikë, siç ka qenë deri më tash.

Pra, është diçka që do të shihet dhe rezultati do të shihet shumë shpejtë.

Kur është në pyetje shërimi jashtë vendit, e përmendët punën e shërimit jashtë vendit. Unë dje kam pasur takim të radhës me drejtorin e Klinikës suaj dhe kam insistuar, tenderi për materialin harxhues, për Koronarografi dhe Kardiologji Invazive do të mbyllet me datën 29. Ta shohim menjëherë pas hyrjes së fuqi se si do të punojë Klinika e Kardiologjisë. Edhe kam kërkuar që të punohet në tri ndërrime, me qenë në shërbim të qytetarit pandërprerë dhe normal, që do t'i paguajmë shërimin qytetarit i cili ka ishemi akute koronare që ka jetën në rrezik. Dhe, kjo është prioritet, jeta e njeriut është prioritet. Dhashë Zoti, të kemi mjete të mjaftueshme buxhetore e ta trajtojmë edhe isheminë kronike, por fillimisht ta shpëtojmë jetën, besoj që ju pajtoheni me këtë.

Deri më sot, nuk ka mundur të shkojë qytetari të marrë shërim në spitalin privat, nuk ka mundur të vendosë stentë, ai që s'ka pasur para, i varfëri nuk ka mundur, sepse kanë qenë

procedurat administrative të tilla, që është dashur për të pritur. Tash, në rast të nevojës edhe ai që s'ka nevojë edhe ai që s'ka mundësi financiare, në rast të nevojës akute do të ketë mundësi ta marrë shërbimin te privati, derisa nuk ta aktivizojmë publikun. Janë komisionet e Klinikës suaj që po i dërgojnë pacientët jashtë Klinikës. Të mos hyjmë në detaje tash, dhe ta sqarojmë gjithë atë sistem të korrupsionit. Të mos flasim për provizionet, të cilat paguhen, të mos hyjmë në fshehtësira publike, të cilat janë të qarta.

Prandaj, unë ju kisha lutur që të jemi seriozë në bisedë dhe që të kuptojmë, se një pjesë e madhe e problemeve, me të cilat sot ballafaqohet shëndetësia kosovare, qëndron jo vetëm në Ministrinë e Shëndetësisë, por qëndron edhe në anën tjetër në vetë institucionet shëndetësore, të cilat si pjesë të një sistemi, që thash, anakronik dhe në kohë të korruptuar, de-fakto janë bërë pjesë e një sistemi jofunksional, që nuk është në shërbim të qytetarëve, por në shërbim të individëve brenda sistemit dhe atyre operatorëve ekonomikë tjerë të cilët janë jashtë sistemit, por që shumë bukur e shfrytëzojnë paaftësinë institucionale, nga njëra anë, se mos e harroni ju lutem, ju duhet ta keni parasysh, unë jam ministër i një ministrie ku e kam sekretarin e përgjithshëm në pozitën e ushtruesit të detyrës. Ju mos i harroni arrestimet e fillimit të vitit të kaluar. Nuk është lehtë të punosh në një Ministri, e cila është në nivel të ushtruesve të drejtorëve të departamenteve dhe nuk mund të shpallë konkurse, sepse ligji ta ndalon. Nuk guxon të kesh rihapje të konkursit, derisa të përfundojë procedura administrative ndaj zyrtarëve, të cilët janë subjekt i hetimeve dhe procedurave gjyqësore thotë, nuk ka mundësi të hapet konkursi. Do të thotë, është situatë e tillë dhe ne duhet të punojmë, të jetojmë, të funksionojmë brenda realitetit, të cilin e kemi dhe po provojmë ta nxjerrim maksimumin prej një situatë, me të cilën po punojmë tash, as më shumë e as më pak.

KRYESUESI: Faleminderit! Replikë, zonja Bakalli.

AURORA BAKALLI: Faleminderit!

Këtu u thanë shumë gjëra, unë nuk do të di a do të mund t'i replikoj gjithë këto, por do të tentoj disa prej tyre.

Ju thatë zotëri ministër ndër të tjera, “ pse të mos vendosen stentat për pacientët me sëmundje akute koronare” Gjithsesi, se duhet të vendosen, por duhet të vendosen në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës e jo të shkojnë para të shumta për spitalet private.

Ne rregull, le të punojnë edhe privatet edhe publiket, le t'i kenë këto mundësi, sepse stafi ekziston por nuk ka material shpenzues. Pastaj, pacienti le të përzgjedhë ku e ka më të mirë. Lejojeni konkurrencën e tregut, që nuk po lejohet. Publiku është bërë qendër primare komplet. Të gjithë janë duke punuar në favor të spitaleve private.

Ju thatë, se ka provizione. Nëse ka provizione, zoti ministër, ju jeni në krye të këtij institucioni shëndetësor, ju i keni inspektorët të cilët duhet që t'i ndalojnë këto gjëra.

Për Kardiokirurgjinë thatë se punojnë me orar të plotë të punës. Çfarë orari i plotë i punës, nëse punohet një herë ose një herë në javë apo në dy javë? Çfarë orari të plotë të

punës, çka po punuakan këta njerëz gjatë ditëve të tjera? Pse nuk janë përditë aty? Të njëjtit njerëz përditë punojnë në qendrat private.

Pastaj, thatë se gjendja është duke u përmirësuar për ata që punojnë. Unë jam përditë aty. Zoti ministër, të jeni i bindur, nuk ka përmirësim. Me gjithë dëshirën tuaj, por edhe timen, sistemi shëndetësor aktualisht nuk ka përmirësim. Sa më përket mua, unë nuk kam pasur kurrfarë kontestimi për vendin ku punoj, baras vlerësimi ka qenë diçka e domosdoshme për mbarëvajtjen e punës, sepse kjo nuk është për mua personalisht, por për të gjithë të kategorisë sime, për arsye të tranzicioneve dhe transformimeve, që janë bërë në sistemin shëndetësor. Ju nuk mund t'i hidhni poshtë me dhjetëra vjet studime, për shkak se ndërrohet sistemi...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Faleminderit! Veç një sqarim ta bëj.

(Sërish ndërprerje e incizimit)

E keni fjalën, zoti ministër.

MINISTRI FERID AGANI: Faleminderit, shumë!

Unë mendoj, se interpelanca e ka këtë kuptim, që t'i debatojmë çështjet dhe t'i sqarojë në mënyrë të hapur, të argumentuar. Po mundohem vetëm shkurt.

Doktoresha Bakalli,

Kur e kam marrë mandatin si ministër, lëndën e parë që e kam gjetur në tavolinë ka qenë, se çka të bëj me stentat e blera me vlerë prej 270 mijë euro e të cilëve iu ka skaduar afati.

Komisioni vlerësues ka qenë nga kolegët tuaj, që i ka vlerësuar ato stenta dhe asnjëherë s'janë përdorë. Kjo lëndë ka qenë subjekt i hetimeve më tutje dhe me siguri vazhdon të jetë. Për ta kuptuar pak problemin, se nuk ka filluar kardiologjia invazive me këtë ministri, ka filluar shumë më herët, ka ekzistuar ai aparat atje dhe s'ka punuar kurrë. Asnjëherë nuk ka mbërri ta kryej funksionin qysh duhet, por do ta kryejë, do të bindeni, do të shihni në qershor të këtij viti do ta shihni si do të punojë kardiologjia invazive në QKUK edhe shërbimi kardio-kirurgjik, të cilin jeni aq agresive ndaj këtij shërbimi, se ai ka nevojë për trajnime, ai ka nevojë për konsolidim të punës, ata janë njerëz të cilët nuk e kanë përvojën e duhur, veçanërisht kuadri i mesëm dhe ne nuk mund të varemi prej sektorit privat për të punuar kardio-kirurgjia publike. Prandaj, janë disa procese normale që shkojnë.

Kur janë në pyetje provizionet, asnjë bazë ligjore nuk ka ekzistuar deri më sot, në të cilën keni mundur të ndiqni mjekun për marrjen e kompensimit financiar për referim të pacientit nga sektori publik privat. Tash e keni. Me nenin 41, që po thuhet se është anuluar e nuk është anuluar, ai është aty, në nenin 41 paragrafi 1, shumë qartë shkruan se çka ndodh në qoftë se referohet nga sistemi publik privat pa asnjë indikacion mjekësor dhe e dyta, se çka ndodh në qoftë se merret kompensimi financiar për atë.

Prandaj, le të hyjë ligji në fuqi dhe mandej e shohim shumë shpejtë, se si do ta rregullojmë këtë çështje, unë besoj, në mënyrë shumë efikase dhe efektive.

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka zoti Buzhala.

BERAT BUZHALA: I nderuar kryesues,
Ministra,
Kolegë deputetë,

Unë e kam veç një frikë që një ditë do të thuhet që u përmbyll reforma edhe gjendja në sektorin e shëndetësisë do të jetë kjo. Atëherë, teknikisht ne kemi reformën, mirëpo gjendja do të jetë po kaq e mjerueshme sikur kjo që është sot.

Për mua është e pamundur të flitet për nene, për paragrafë, për aline, ndoshta mund të jenë shumë të rëndësishme, mirëpo kjo nuk po e përmirëson gjendjen në QKUK, e cila është, u tha këtu, u shndërrua në shërbim primar. Pra, është shndërruar në ambulantë. QKUK-ja është shndërruar në ambulantë, ku të gjithë, për secilin problem dërgohen atje.

Kisha dashur ta nis prej një përvoje personale, te kualiteti i shërbimeve në QKUK. Para një viti e gjysmë e kam pasur çikën të sëmurë dhe Ardian Gjini e përmendi që nuk i besojnë, është e vërtetë që ka rënë kredibiliteti. Ardian, pata vendosur ta dërgoja në operacion në QKUK. Edhe u bë dy herë operacion në QKUK edhe herën e tretë pati të vdesë, pothuajse. Edhe u detyrova, e kam rrëmbyer çikën time, e kam çuar në Shkup edhe pas tri ditësh ma kanë liruar nga spitali, pas një rioperacioni, që është bërë atje.

Pra, unë luajta pothuajse, bixhoz me projektin tim më të dashur, çikën time. Njëherë tjetër e pata nënën të sëmurë, neuralgji trigiminale. Shefi i asaj Klinike është i akuzuar për, e ka librin e vet plagjiaturë. A mund dikush për ta dërguar në dorë të dikujt dikën që akuzohet për plagjiaturë? Pra, një gjendje jashtëzakonisht e dhembshme, normalisht, që nuk e kam dërguar, e kam dërguar diku tjetër, jashtë vendit.

Herën e fundit e pata babën të sëmurë, Bakalli e përmendi gjendjen atje edhe nuk pati stenta në QKUK, u desh ta dërgoj në klinika private, sepse munguan stentat.

Problemi, më serioz sipas meje është, ne prej pasluftës sektorin e shëndetësisë, jo vetëm PDK tash me AKR-në, kur ka qenë koalicioni LDK-AAK, Ministrinë e Shëndetësisë ia kanë dhënë Sadik Idrizit. Pra, e kanë hequr përgjegjësinë prej vetes, sepse ka qenë një sektor jashtëzakonisht i ndjeshëm, ia ka mbajtur dikush - tjetër. Kur ishte koalicioni LDK-PDK, PDK-ja si partner serioz prapë e hoqi prej vetes, ia dha Alush Gashit e mandej ia dha Bujar Bukoshit, mirëpo nuk ishte PDK-ja ajo që deshi ta marrë përgjegjësinë, njëjtë tash, zotit Agani.

Unë konsideroj që me ligj madje, tingëllon pak qesharake, që shëndetësinë duhet për t' ia lënë partisë më të madhe. Pra, sikur infrastruktura që merren poenë për shkak të punëve, duhet të merren edhe kënde, edhe në Ministrinë e Shëndetësisë.

Pra, problemi është se krahura është përkrahur. QKUK-ja është shndërruar në një vrimë të madhe të zezë, ku në njëfarë forme investohen milionë çdo vit, qoftë prej donatorëve, qoftë prej Qeverisë e në anën tjetër, i njëjti institucion shërben si dera e fundit, ku troket secili qytetar. Ne mund të flasim për ligje, për barna esenciale e joesenciale, për prokurime e për çështje teknike, mund të flasim me muaj, por gjithë kjo nuk vlen as pesë para, kur çdo mbrëmje autobusët nisen prej Prishtinës dhe shkojnë në Serbi për shërim.

(Ndërhyrje e ministrit Ferid Agani: Absolutisht e pavërtetë!)

Absolutisht e vërtetë, edhe shqyr që po na shohin shikuesit, edhe ata kanë për të na gjykuar më së miri, a po e them unë të vërtetën, a po e thoni ju?

Ka shqiptarë që shkojnë shërohen në Beograd, sot e kësaj dite. Mos të flasim për Maqedoninë. Po mendoj, ajo është shërbimi primar tash është shndërruar Maqedonia. Pra, Beogradi po përkrahet, prej zorit .. kjo është groteske, po mendoj për të shkuar për t' u shëruar në Beograd. Pra, nuk është çështje e Pakos së Ahtisarit, nuk është çështje e marrëveshjes me Serbinë, është çështje për jetë a vdekje. Unë nuk e gjykoj kurrkënd në këtë drejtim... Çka të bëjmë? Të heshtim, ta lëmë të vdesë, apo ta dërgojmë diku tjetër ku ka shërim?

Pra, problemi është, edhe ne këtu po flasim për tri nene, katër nene, pesë nene, problemi është te menaxhimi, punësimet. Unë mendoj që punësimet politike dhe partiake do të duhej, është kriminale që atje të dërgohen njerëzit partiak, po mendoj në QKUK , apo mjekët. Mjekët janë shndërruar në emisarë politikë. Në vitet 80-ta dhe 70-ta ka qenë njëfarë kredibiliteti i mjekëve, pra, në të pame, kur është bërë e pamja, në momentin kur dikush ka vdekur, vazhdimisht është përdorë, së paku për doktor nuk ka shkuar poshtë, sepse kanë qenë disa mjekë që kanë pasur vulën e kredibilitetit dhe kur atij i ke vdekur në dorë, po mendoj ajo ka qenë edhe shërim për familjen, se nuk ka pasur shërim. Tashmë, nuk po ndodh kjo, tash po thuhet, ka shkuar, ka vdekur për doktor.

Pra, problemi është te partizanët që kanë shkuar atje, qoftë, nuk e di në çfarë forme, edhe nuk kanë, para së gjithash nuk e kanë as cilësinë, nuk e kanë as edukimin adekuat. Tash, ne mundemi, ministër unë po them se ti je përgjegjësi për këtë punë, është shkollimi, si pikë e parë. Ne po prodhojmë mjekë, çka po di unë, universitete private të mjekësisë ka, nuk ka kurrkund në botë, po mendoj, nuk po dua ta gjeneralizoj, një numër i madh i vendeve të botës nuk e lejojnë Fakultetin e Mjekësisë të jetë privat, duhet të jetë i shtetit.

Këtu kiosket janë bërë në fakultete të mjekësisë, njerëzit po e kryejnë atje dhe të nesërmen e sheh aty. Qysh mundet të jetë një mjek i mirë, kur s' di të shkruaj shqip, po mendoj nëse e ka edukimin këtu? Është a pamundur analfabeti të jetë mjek i mirë. Këtu kemi njerëz analfabetë, që ty të merr në dorë edhe në operacion. Pra, ne mundemi të heshtim dhe të flasim qetë për prokurime, për çka po di unë çka, por gjendja është e mjerueshme.

Unë e kam thënë një ditë më herët, po e përsëris prapë, po mendoj me gjithë respektin për holokaustin e ato, mirëpo, edhe atje ka pasur mjekë, edhe në Aushvic ka pasur mjekë, ka

qenë doktor Mengele ashtu qysh ka qenë, por ka pasur disa mjekë, edhe ne kemi mjekë, edhe në luftë ka pas mjekë, doktorë të luftës... por ne jemi 15, 13 – 14 vjet pas luftës. Njerëzit të vdesin prej zorrës qorre, njerëzit të vdesin prej infeksioneve më të thjeshta, po kjo është e tmerrshme.

Ne mund të flasim për reforma, mirëpo unë mendoj që QKUK-së dhe departamenteve iu kanë munguar menaxherët. Ne dërgojmë menaxherë mjekë në QKUK. Po çka ka lidhje menaxherllëku me mjekësinë. Ti e çon menaxherin që s'ka lidhje a është mjek a s'është mjek, ti e çon menaxherin që e ka thirrjen profesionale. QKUK-n më mirë e menaxhon dikush që është një ekonomist i mirë, se sa një mjek i mirë. Mjekun e mirë ti çoje në sallë të operacionit, jo ta udhëheq një dinozaur si QKUK-ja me mijëra punëtorë.

Po, unë mendoj që i kemi kapur sendet për se mbrapshti, pa emocione, në flasim qetë me një ftohtësi kriminale për çështjen e mjekësisë. Unë nuk shoh që duhet të flasim qetë për mjekësi, po mendoj, duhet për ta shkundur këtë sistem. Ky sistem është para kolapsit total, me kalimin e viteve, ligjet po përmirësohen, kualiteti po bie. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti ministër, e keni fjalën.

MINISTRI FERID AGANI: Unë kam pasur rast të flas me pacientë, një pacient ka thënë- kënd e kemi edhe në Kuvend, thotë disa analfabetë, thotë kush po na përfaqëson?

Nuk është mirë kështu! Kolegët, mjekët të cilët ofrojnë shërbime në baza ditore, të quhen analfabetë, njerëz që s'dinë dhe për t'i përgjithësuar, nuk është në rregull kjo, absolutisht.

Unë po ju tregoj vetëm disa numra, e mandej këqyrni kush janë këta njerëz, a janë të Serbisë, a janë të Kosovës?

226 mijë e 995 vizita specialistike në Qendrën Klinike Universitare, 652 vizita specialistike në ditë, shënimet e vitit 2012.

13 mijë e 886 operacione me anestezi të përgjithshëm ose 38 operacione në ditë.

Nuk ma merr mendja që këta janë njerëz analfabetë. Atë rast që e paskit dërguar e keni dërguar gabim, se ajo sëmundje nuk trajtohet prej neurokirurgut. Ajo trajtohet prej neurologut.

Dhe, është krejt normal që e keni këtë diskutim kur fillimin e diskutimit e nisni me përshkrimin e frikës, se edhe në fund të kësaj reforme do ta kemi gjendjen e njëjtë. Kjo është paragjykim. Paragjykimi është agresiviteti më i madh, që mund ta ketë ndaj një çështjeje.

Në qoftë se ju jeni agresivë ndaj suksesit të shëndetësisë kosovare në të ardhmen, një reformë të cilën e mbështet Banka Botërore, Fondi Monetar Ndërkombëtar, pra ekspertët botërorë të shëndetësisë dhe të financave, ta mbështesin një reformë, kjo reformë ngjall interesim të Universitetit të Dortmundit, në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, në mes të

majit do të na vijë delegacioni i Universitetit të Dortmundit për të na vizituar, për të nënshkruar marrëveshje të bashkëpunimit me Ministrinë e Shëndetësisë, me Fakultetin e Mjekësisë të Universitetit të Prishtinës. Për hir të kësaj reforme, për hir të vlerësimit që ia bëjnë kësaj reforme, për hir të kolegëve me të cilët ata bashkëpunojnë që 12 vjet, është programi i shkëmbimit ndërmjet Fakultetit të Mjekësisë dhe Fakultetit të Mjekësisë në Universitetin e Dortmundit. Ata i vlerësojnë këta kolegë dhe nuk i quajnë analfabetë. Është e turpshme zoti deputet, e turpshme, me të vërtetë e turpshme! Nuk mund të flisni kështu, nuk është në rregull kjo.

Nga kjo shtëpi, kjo është shtëpi përfaqësuese. Ka probleme, ka shumë vështirësi, ka shumë mangësi, por mos harroni se këtë sistem shëndetësor, këta mjekë në sistemin privat nuk i ka shtyrë vullneti i tyre dhe dëshira e tyre, por i ka qitur Serbia. Ajo Serbi që po thoni tash po shkojnë po i marrin shërbimet, edhe do të shkojnë. Po, shkon njeriu merr shërbime aty ku ka mjekë të mirë. Edhe në Beograd shkon merr shërbime, edhe në Sarajevë, edhe në Zagreb, shkon merr shërbime, po nuk është e vërtetë që me autobusë shkojnë. Aty ju reagoja. Mos ashtu!

Mos e ulni autoritetin e institucioneve publike shëndetësore. Ju po promovoni mosbesim në njerëz që po punojnë çdo ditë, 24 orë në ditë, 7 ditë në javë, ofrojnë shërbime për këta njerëz të sëmurë. Ndoshta, ju i keni mundësitë të shkoni të shëroheni ku të doni. Mos ashtu, se njerëzit ju dëgjojnë dhe nuk është e vërtetë, absolutisht me përgjegjësi të plotë them se nuk është e vërtetë që cilësia e shërbimeve mjekësore në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës është në atë gjendje që ju e përshkruani.

Ka mungesa, ka hapësirë, ju do të shihni kjo reformë se çka do të bëjë, brenda 6 muajve, hiç më larg, flasim në janar të vitit të ardhshëm dhe e shohim a është kjo Qendër Klinike e njëjtë ajo që ka qenë edhe para 6 muajve apo jo, kur të ketë hapësirë të veprimit, kur të ketë autonomi menaxheriale, kur drejtori i Qendrës Klinike Universitare të Kosovës nuk dridhet se çka i thotë Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës i Shërbimit Civil.

Edhe 100 instrumente politike majtas e djathtas munden për ta kontrolluar Klinikën, po kur mbizotëron kriteri profesional në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës. Me Ligjin e shëndetësisë ne ia kemi dhënë pavarësinë shëndetësisë kosovare prej politikës, përfaqësues të së cilës jeni edhe ju, edhe unë dhe të gjithë ne që jemi këtu. Ata do të udhëheqin me veten.

Ta shohim ne se si do të jetë situata kur të fillojë të zbatohet Ligji i shëndetësisë. Dhe, jam i bindur që frika juaj do të eliminohet shumë shpejt, shpresoj që nuk janë shumë të rrënjosura, megjithëse paragjykimet i keni shumë serioze, me të vërtetë.

KRYESUESI: Faleminderit! Replikë, zoti Buzhala.

BERAT BUZHALA: Tash s'po di a të replikoj më së pari për rastin e neurologut edhe neurokirurgut, po mendoj unë i kam letrat që një neurokirurg austriak e ka operuar, kështu që mirë. Te analfabetizmi, unë nuk thashë, ministër, pse po më kap për gjuhe? Mos m'i qit fjalët tua në gojën teme, se unë nuk thashë që krejt sistemi shëndetësor është

analfabet. Po, analfabetët kanë depërtuar fuqishëm aty, po mendoj një numër i madh i njerëzve, se jo i gjithëve.

Fakti, që janë kryer sa mijë operime, nuk do të thotë se ato janë operime të suksesshme, pra ato, mirëpo, hajde ta bëjmë një zotim publik. Serbia e ka një ambulancë në Graçanicë, shteti i Serbisë e financon edhe po shkojmë e po shohim sa njerëz shkojnë në atë ambulancë, sepse vijnë kirurgë prej spitalit shtetëror të Serbisë, vijnë mjekë urologë edhe prej krejt spektrit. Një numër jashtëzakonisht i madh shkojnë atje dhe operohen në Graçanicë, jo në Beograd, me autobusë, unë nuk thash që mbushen si karvanë 7 autobusë, po shkojnë një numër i konsiderueshëm i njerëzve në shërim atje, që do të duhej të ishte dera e fundit, unë mendoj.

Pra, mos ma qit në rrafshin moral, që jo ti po e ofendon krejt mjekësinë, unë s'po e ofendoj krejt mjekësinë, unë madje fola me piedestalin më të lartë për mjekët kosovarë që kanë pas vulë të kredibilitetit. Unë ende mendoj që në QKUK ka mjekë të jashtëzakonshëm, mirëpo partizanët partiakë edhe militantë edhe emisarët politikë ua kanë zënë frymën atyre njerëzve.

Atje, pra këta emisarë politikë domosdoshmërisht janë analfabetë, sepse një njeri, një mjek, i cili merr urdhra politikë... ai nuk mund të jetë intelektual i vërtetë dhe një mjek i mirë.

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka zoti Demolli.

HAKI DEMOLLI: Faleminderit, i nderuar kryesues!

Të nderuar ministra,

Të nderuar deputetë,

Fillimisht dua të theksoj se e përkrah iniciativën e deputetëve për interpelancë me ministrin e shëndetësisë dhe krijimin e mundësisë për të debatuar mbi problemet dhe gjendjen shumë të rëndë, në të cilën ndodhet njëri prej sistemeve më jofunksional të vendit tonë.

Për ilustrimin e gjendjes së rëndë të sistemit shëndetësor do të theksoj fjalët e një mjeku kujdestar të një institucioni tonë shëndetësor, që m'i tha disa net më parë gjatë ekzaminimit mjekësor të një familjari tim. Citoj: "Ne pacientëve tanë nuk u japim ampula të penicilinës, për shkak se nuk disponojmë, madje as me ampula të anti-shokut, çmimi i të cilave është më i vogël sesa 5 euro."

Vërtet, spitalet tona janë të furnizuara dobët apo madje edhe u mungojnë barnat nga lista esenciale e të cilat edhe më tutje i blejnë vetë pacientët apo familjarët e tyre. Pastaj, kushtet elementare si ato higjienike, ngrohja, ushqimi, hospitalizimi e deri te cilësia e shërbimeve shëndetësore janë shumë larg prej atyre që i gëzojnë pacientët e vendeve të regjionit dhe atyre të vendeve evropiane.

Prandaj, shtrohet pyetja se kush është përgjegjësi dhe fajtori kryesor për një gjendje kaq të rëndë të sistemit, që duhet të përkujdeset për shëndetin e fëmijëve, të rinjve dhe pleqve

të vendit tonë? Pa fije dyshimi përgjegjësia kryesore për këtë gjendje të shëndetësisë sonë është te Qeveria e Kosovës, e cila sistemin shëndetësor dhe shëndetin e qytetarëve tonë nuk e ka vënë në radhën e çështjeve prioritare të saj, ndonëse ky është një sektor shumë i rëndësishëm, sidomos për një popullatë jo të shëndetshme, siç është popullata jonë. Kjo Qeveri në vend se të mendojë vetëm për autostrada, asfalte dhe përfitime të mëdha nga tenderët e tyre, vlerësoj se është dashur të mendojë edhe për përmirësimin dhe kurimin e shëndetit të qytetarit tonë, sepse një radhitje e këtillë e prioriteteve qeveritare tregon për filozofinë keqmenaxhuese të kësaj qeverie, e cila më shumë mendon se si të përfitojë për vete dhe të rehatojë drejtuesit e pasur të automjeteve e më pak për shëndetin dhe jetën e pacientëve të varfër, të cilët nuk kanë para madje as për të blerë barnat esenciale dhe gjësende tjera elementare për jetesë.

Një trajtim i tillë jo me prioritet ka bërë që vendi ynë të ketë buxhetin më të ulët për shëndetësi në regjion dhe të jetë vendi i vetëm në regjion, që nuk ka sistem të mirëfilltë shëndetësor. Sa për ilustrim, gjatë vitit 2011 për shëndetësi janë ndarë vetëm 80 milionë euro, kurse për vitin 2012 janë ndarë 88 milionë, që vërtet është shumë e vogël parash për ta mbajtur dhe rimëkëmbur një sistem kaq të rëndësishëm për popullatën tonë.

Por, shëndetësia kosovare përveç financimit jo të mjaftueshëm nga Qeveria, ballafaqohet edhe me një varg problemesh të tjera, të cilat e dëmtojnë seriozisht funksionalitetin dhe efikasitetin e saj në ofrimin e shërbimeve cilësore për pacientët tonë.

Kështu, si problem i theksuar është shpërndarja joadekuate e mjeteve të planifikuara, sepse vlerësohet se mbi 90% të harxhimeve publike për shëndetësi i përkushtohen kujdesit shëndetësor sekondar, duke ndarë mjete të pakta për kujdesin shëndetësor primar.

Problem tjetër i shëndetësisë sonë është edhe ndërhyrja e drejtpërdrejtë e politikës në emërimin e drejtorëve në institucionet tona shëndetësore dhe në repartet e ndryshme të qendrës spitalore. Besohet, se drejtorët e këtyre institucioneve nuk janë përzgjedhur për shkak të programeve të begatshme të ofruara, por kryesisht për shkak të preferencave politike të partive në pushtet, apo për shkak të dëgjueshmërisë dhe përshtatshmërisë së tyre politike, që do të thotë se shëndeti dhe trupi i kosovarit diktohet nga politikanët dhe politikatat ditore.

Ndikimi i këtillë i politikës gjithsesi reflektohet edhe në planifikimin dhe shpërndarjen joadekuate të personalit mjekësor nëpër reparte të ndryshme, gjë që herë-herë shkakton mbipunësim disproporcional në disa sektorë dhe mungesa të personelit në sektorë tjerë, që ndikon edhe në krijimin e shpenzimeve të panevojshme buxhetore.

Më tutje, si të gjithë sektorët tjerë të shtetit tonë edhe sektori i shëndetësisë është i goditur seriozisht nga dukuria e korrupsionit, e cila drejtpërdrejt ndikon në zvogëlimin e funksionalitetit, rënien e efikasitetit, rrënimin e imazhit, si dhe krijimin e mosbesimit të qytetarit tonë ndaj këtij sistemi. Madje, pjesëmarrja e lartë e sektorit shëndetësor në korrupsionin e përgjithshëm, në sektorin publik të Kosovës ka qenë edhe njëri prej konkluzioneve të një debati të organizuar nga Agjencia kundër Korrupsionit, e që është

përkrahur nga UNDP. Për fat të keq forma të ndryshme të korrupsionit nuk janë paraqitur vetëm gjatë tenderimit të barnave dhe materialit sanitar, por edhe gjatë ekzaminimeve mjekësore të pacientëve, realizimit të incizimeve të ndryshme trupore, e sidomos gjatë intervenimeve kirurgjike.

Gjithsesi, një tjetër problem tejet serioz për pacientët kosovarë dhe shëndetësinë në përgjithësi, paraqet edhe mungesa apo mos hartimi dhe mos aprovimi i Ligjit për sigurimet shëndetësore, me të cilin do të përcaktoheshin politikat e përgjithshme për fondet shëndetësore, përmes të cilit do të zgjidheshin shumë probleme të pacientëve kosovarë dhe në masë të caktuar do të reduktohej edhe korrupsioni në shëndetësinë tonë.

Për fat të keq, të gjitha këto dhe problemet tjera me të cilat po ballafaqohet shëndetësia kosovare për pasojë kanë jo vetëm maltretimet psikofizike të pacientëve tonë, rrënimin serioz të shëndetit të tyre, por jo rrallë edhe shuarjen e jetës së tyre. Kështu vlerësohet, se vdekshmëria e foshnjave në Kosovë edhe pse kohëve të fundit ka një rënie në raport me vitet e mëhershme, ende mbetet shumë e lartë, madje është më e larta në Evropë, sepse në Kosovë aktualisht në 1 mijë lindje vdesin 17 foshnja si pasojë e infeksioneve të ndryshme dhe problemeve të tjera.

Kështu thonë raportet, andaj për të shëruar sistemin e sëmurë shëndetësor kosovar, kërkoj nga Ministria e Shëndetësisë dhe nga Qeveria e Kosovës, e cila gjatë fushatës zgjedhore i ka premtuar elektoratit kosovar, se shëndetin e tyre dhe shëndetësinë e Kosovës do ta ketë prioritet gjatë mandatit të saj, që t'i lë anash premtimet e kota dhe të fillojë zbatimin e reformës dhe hartimin e politikave bashkëkohore shëndetësore duke implikuar në një aksion global të gjithë faktorët socio-ekonomikë, që e përcaktojnë gjendjen shëndetësore dhe sëmundjet e popullatës kosovare, si dhe trajtimin dhe kurimin e tyre ashtu siç bëhet në vendet e regjionit dhe vendet tjera të zhvilluara të Evropës Perëndimore. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka zonja Albulena Haxhiu.

ALBULENA HAXHIU: Faleminderit, kryesues!

Situata aktuale në shëndetësi është alarmante. Bile, as kjo fjalë nuk mund ta përshkruajë si duhet këtë situatë. Mjafton vetëm një herë të ballafaqohesh, ta pyesësh dikë apo vetëm t'i shohësh për së afërmi institucionet publike shëndetësore, e sidomos QKUK-në dhe të bindesh.

Mosmirëmbajtja adekuate, keqmenaxhime, emërtime dhe punësime në baza nepotiste, afera të shpeshta korruptive, mungesa të barnave dhe materialeve shpenzuese më bazike, janë vetëm disa nga përditshmëritë në këtë sistem.

Kjo përveç që ka sjell në një rënie drastike të besueshmërisë në shëndetësinë publike, po rezulton edhe në pasoja të tmerrshme për qytetarët tanë, si në aspektin shëndetësor, por edhe në atë material, për arsye se shumica e tyre domosdoshmërisht orientohen në sektorin publik ose për shërim jashtë vendit. Kjo po çon në një rrënim të këtij sektori.

Për hir të së vërtetës, ky rrënim ka filluar që nga qeverisjet e para të pasluftës, ka vazhduar në mënyrë sistematike dhe po vazhdon me një intensitet të shpejtuar. Duket

sikur është mision rrënimi i sektorit publik të shëndetësisë, se sa rimëkëmbja e tij. Duke pasur parasysh se çfarë po ndodh edhe në fushat tjera gjatë kësaj qeverisjeje, nuk është larg mendsh që kjo të jetë e vërteta.

Fatkeqësisht, edhe pse më shumë se dy vjet nga marrja e Ministrisë së Shëndetësisë nga ministri aktual, kjo gjendje vetëm sa ka shkuar duke u përkeqësuar, i kemi dëgjuar tashmë të gjitha arsyetimet e ministrit, pra duke filluar nga ato se duhet kohë për përmirësime, jemi duke punuar, ose së shpejti do të bëhet Ligji për shëndetësi dhe sigurime shëndetësore, si bazament i reformave dhe përmirësimit, pastaj vonesat për miratimin e ligjeve e deri në ato arsyeime aspak etike dhe aspak të sinqerta se ai ka gjetur një sistem me shumë probleme të akumuluar dhe se sistemi shëndetësor është tërësisht i korruptuar, ku personeli bart pjesën më të madhe të fajit për këtë gjendje.

Si përfundim, parë nga prizmi i ministrit, faji mund të jetë pra i të gjithëve, përveçse i atij dhe i kësaj qeverie.

Zoti ministër,

Kanë kaluar më shumë se dy vjet si ministër i Shëndetësisë dhe fshehja pas arsytimit të tilla, më nuk pi as ujë. Kjo qasje nuk është as e sinqertë nga ana juaj dhe e Qeverisë, pjesë e së cilës jeni, por as nuk kontribuon në zgjidhjen e këtyre problemeve në shëndetësi.

Ju mund të thoni edhe se jeni munduar, se keni punuar dhe po punoni, por puna juaj, zoti ministër, deri më tani nuk ka treguar asnjë përmirësim në terren, përkundrazi.

Në anën tjetër, zoti ministër, pacientët tanë nuk mund të bëjnë sehir se kur do të bëhen këto përmirësime, sepse problemet e tyre shëndetësore nuk presin gjatë dhe çdo ditë, pra ka raste që po e tregojnë dhe po e dëshmojnë këtë.

Si përfundim, mos aftësia e përmirësimit të gjendjes aktuale nuk është mos aftësi që do të mund të arsyetohej në një mënyrë apo tjetrën, por është një përgjegjësi direkt ndaj qytetarëve. Kjo është një e drejtë fundamentale dhe nuk ka arsyetim në botë, që e arsyeton pra mohimin e kësaj të drejte. Faleminderit !

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti ministër e keni fjalën.

MINISTRI FERID AGANI: Faleminderit, zoti kryesues!

Prapë, jo në kuptim të replikës së drejtpërdrejtë me deputetë, por një grup i deputetëve që diskutuan, unë me të vërtetë ju kisha lutur që të keni parasysh atë që po e them, si fakte. Në qoftë se, nuk janë fakte, s'janë argumente, atëherë të polemizojmë me këto argumente. Thoni kjo nuk është e vërtetë dhe mandej unë e pranoj.

Në qoftë se, unë them se ky sistem shëndetësor gjeneron këtë situatë, në qoftë se unë them se ky sistem është i mbështetur në 27 funksione ekzekutive të sekretarit të përgjithshëm të Ministrisë së Shëndetësisë, që sot është ushtrues detyre, në qoftë se unë them që sistemi shëndetësor s'ka kurrfarë autonomie të veprimt, në qoftë se unë them se

ky sistem është anakronik dhe është i korruptuar me kohë dhe mund të ndryshohet vetëm me ndryshimin e legjislacionit, vetëm me ligj të ri, me një sistem të ri mund të ndryshohet. Vjen një moment kur duhet një sistem për ta ndërruar me sistemin tjetër. Dhe, këtu së paku me grupin e juaj parlamentar, besoj që keni pika të takimit, sepse është domosdoshmëri për ta ndryshuar, nuk ka tranzicion brenda këtij sistemi aktual.

Ky sistem gjeneron vetëm papërgjegjësi, mungesë të llogaridhënies, politizim maksimal dhe asgjë tjetër. Unë e them, se Ligji i shëndetësisë që do ta ndryshojë këtë sistem është miratuar në Kuvend të Kosovës më 28 qershor 2012. Unë kam mandat dy vjet e dy muaj, do të thotë 26 muaj mandat. Prej këtyre 26 muajve të mandatit, 10 muaj unë jam duke pritur Ligjin e shëndetësisë të hyjë në fuqi. Pa hyrë ky ligj nuk ka ndryshime. Mund të flitni çka të doni, mund ta bini kë të doni, prej ku të doni, prej cilësdo parti, edhe prej suajës, nuk ka ndryshim pa ndryshimin e këtij sistemi shëndetësor. Ky është realiteti.

Përndryshe, nuk është gjendja ashtu qysh po e shihni. Nuk është ideale dhe larg prej ideale, por po ju them se unë kam ditë për ditë punë me njerëz të cilët kanë benifite prej punës së Ministrisë prej ndryshimeve, që i kemi bërë brenda legjislacionit ekzistues. Nuk kemi ndej ne, nuk kemi pritur. Kur them unë i kemi nisur për herë të parë kontraktimin e institucioneve private shëndetësore në vend, pse nuk po e keni këtë parasysht? Ky është fakt. Këto para që po shkojnë në sektorin privat të shëndetësisë në Kosovë, përpara kanë shkuar në shtetet jashtë Kosovës. Deri në vitin 2011 kanë shkuar jashtë Kosovës, krejt ai buxhet që ka qenë, 2 milionë a 3 milionë euro sa ka qenë, krejt kanë shkuar jashtë Kosovës. Kurrkush s'e përmend atë fakt se ato i keni brenda, pjesën më të madhe të tyre e kemi në Kosovë.

Janë bërë disa ndryshime për të mirë. Nuk duhet me qenë nihilist dhe tash vetëm për hir të qëllimeve politike, profiteve politike me marrë edhe tash me bë vetëm zi situatën. Nuk mundet kjo, ky realitet nuk do të jetë kurrë vetëm i bardhë dhe vetëm i zi. Shikoni shtetet në Evropë, aferat më të mëdha i kemi në sistem shëndetësor, shëndetësia është shumë komplekse. Ky nuk është arsye. Unë vetëm po e përshkruaj një gjendje, të cilën po provojmë ta ndryshojmë me kapacitetet që i kemi, me njohuritë që i kemi.

Për mua është një arritje e madhe, në qoftë se kemi arritur ta bëjmë një aleancë me shumë ndërkombëtare se sa vendore. Unë e kam të qartë pse jo vendore, sepse ky sistem kur thash i korruptuar me kohë, ky është në shërbim të grupeve të interesit. Dhe, grupet e interesit kanë ndërlidhje të fuqishme me segmente të ndryshme të politikë bërjes dhe vendimmarrjes dhe normal, mandej veç e shihni, si të bëni të ndryshoni diçka, veç e sheh veten në gazetë, ose e sheh veten në televizion. S'ka problem, unë kur e kam marrë këtë detyrë unë e di sepse e kam marrë, do të provoj të jap maksimumin që e di, mendoj se jemi në rrugë të mirë. Më e keqja është po që se e ndërpreme e të mbesim as ku jemi as ku synojmë të jemi, kjo do ishte katastrofale. Në mënyrën më të sigurtë po ju them, se kjo nuk guxon të ndodh. Dhe me siguri nuk do të ndodhë, pasi që Ligji i shëndetësisë është miratuar dhe do të hyjë shpejtë në fuqi. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka zonja Teuta Haxhiu.

TEUTA HAXHIU: Faleminderit nënkryetar i Kuvendit!

Të nderuar deputetë,

Të nderuar ministra,

Sikurse në shumë fusha tjera edhe në shëndetësinë kosovare gjendja faktikisht, vazhdon të jetë e rëndë, tmerrësisht e rëndë.

Për të mos i përsëritur shumë gjëra, që i thanë shumica nga deputetët, më lejoni që në këtë kuptim të ngris një shqetësim jashtëzakonisht të madh për vërtetësinë e keqmenaxhimit në këtë ministri dhe trajtimin selektiv, që ua bën ajo qytetarëve të vendit.

Si është e mundur që një mësimdhënësi të nderuar, zotit Agim Beqiraj, bashkëvendës imi, njëkohësisht luftëtar i lirisë që nga dita e parë e deri në përfundim të luftës çlirimtare, i cili deri në Kosharen legjendare la pjesë të trupit të tij, për lirinë e Kosovës, e që sot vuan nga kanceri, të injorohet e të mos përkrahet nga kjo Ministri dhe për më keq i pamundësohet e drejta elementare për trajtim dhe shërim.

Madje, me kërkesën për mbështetje vitin që lamë pas, ai i është drejtuar Ministrisë dy herë dhe nga kjo Ministri, në të dy rastet është refuzuar. Ndonëse nga stafi mjekësor i QKUK-së mori udhëzimin urgjent për trajtim jashtë vendit, për faktin se operimi duhej kryer jashtë vendit, zyrtarët e Ministrisë nuk e panë të udhës që të përkrahin këtë njeri, i cili më besoni, gjatë gjithë veprimtarisë së tij iu përkushtua me devotshmërinë më të lartë lirisë së vendit. Me gjithë peshën e zhgënjimit u detyrua që i përbuzur të kërkojë shërim jashtë vendit.

Edhe sot e kësaj dite Agimi po mbijeton falë vendosmërisë së tij të pashoqe, duke e sfiduar këtë sëmundje të rëndë, falë ndihmës së familjes dhe miqve të tij. Por, ama, a mund të lejojmë ne që njerëz të tillë meritore t'i hedhim në këtë mënyrë, pa as më të voglën mëshirë, duke harruar se ndihma për të dhe të tjerë si ai janë detyrim shoqëror e institucional.

Ministri dhe Ministria që ai drejton duhet të jenë të vetëdijshëm për këtë. Çka në të vërtetë duhet të bëjë njeriu, duke derdhur edhe gjakun e njomë për lirinë, që ne e gëzojmë sot, lirinë që e gëzon edhe vetë ministri? A nuk është ky një turp, që duhet të na vrasë ndërgjegjen të gjithëve, e veçmas zyrtarëve shëndetësorë, për këtë injorim të skajshëm për gjakun e derdhur të një luftëtari të lirisë së Kosovës?

Duke qenë e vetëdijshme edhe e ndërgjegjshme për mungesën reale të Ministrisë së Shëndetësisë, se buxheti nuk është i duhur, jam shumë e sigurt se Agimi nuk është i vetmi luftëtar, që si shpërblim për sakrificën ndaj atdheut, nga institucionet për të cilat luftoi me tërë qenien e tij, pra si shpërblim të marrë këtë injorim, që sigurisht as që do ta kishte paramenduar ndonjëherë.

Të nderuar deputetë, në fund dua të pyes se deri kur do të lejojë kjo Ministri, që të përkrahë njerëz të afërt me pushtetin e të mbyll sytë verbalisht ndaj atyre që dhanë çdo gjë nga vetja për lirinë dhe ndërtimin e shtetit të Kosovës?

Agimi nuk mori asgjë nga kjo Ministri, ama asgjë nuk i mori Kosovës, përkundrazi shumë herë i dha më shumë me gjakun e tij e njomi pra, tokën e Kosovës nëpër fusha e nëpër fronte të Luftës Çlirimtare. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka zonja Bajrami.

HYKMETE BAJRAMI: Faleminderit, kryesues!

Të nderuar deputetë,

Unë nuk praktikoj shumë të ndërhyj në çështje dhe të trajtoj çështje për të cilat konsideroj se ka të tjerë prezent që i trajtojnë më me profesionalizëm.

Unë vetëm desha të ndërlidhem me rekomandimin 3, që del nga propozuesi i seancës, i cili thotë që të respektohet Ligji për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësisë, sidomos procedurat e tenderimit.

Pyetja ime është kjo: A duhet Kuvendi t'i rekomandojë Qeverisë dhe Ministrisë përkatëse në këtë rast, që ta zbatojë ligjin, a nuk është ligji i obligueshëm për të gjithë?

Unë besoj se me këtë rekomandim, ne si Kuvend shprehemi se sa të pafuqishëm jemi karshi problemeve madhore dhe sa e mjerë është gjendja e zbatimit të ligjit në republikën tonë fragile.

Gjendja e prokurimit publik nuk është e keqe vetëm në sektorin e shëndetësisë, gjendja e prokurimit publik është e keqe në të gjithë sektorët. Tenderomania, siç po preferohet të quhet prej disave, po varros të ardhmen tonë dhe po e shkatërron imazhin e shtetit tonë ri. Ligji për prokurim publik fatmirësisht është në agjendën legjislative të Kuvendit dhe do të vijë në këtë vit.

Unë nga këtu u bëj thirrje të gjithë deputetëve, që të punojmë shumë për amendamentimin e këtij ligji dhe të eliminojmë të gjitha hapësirat, që lejojnë keqpërdorim.

Unë personalisht nuk mendoj që ligji aktual është ligj i keq, mirëpo shqetësuese është zbatimi i tij. Operatorët ekonomik, përkatësisht kompanitë farmaceutike janë shumë të shqetësuar dhe kanë shumë ankesa rreth prokurimit. Qendra Klinike Universitare hap tenderë për furnizim me barna me kritere që u përshtaten kompanive të caktuara ose më konkretisht, vetëm njërës prej atyre, e kjo do të jetë ajo që ka dhënë përqindjen e caktuar të hollave paraprakisht. Në këtë aspekt, as organi shqyrtues i prokurimit nuk po e kryen punën e vet si duhet, sepse nga operatorët ekonomikë konsiderohet po aq i korruptuar sa edhe departamentet për prokurim në organet e shëndetësisë.

S'ka dyshim, se me një formë të këtillë të prokurimit po rezulton në spitale, që nuk kanë as mjetet elementare për trajtim të pacientëve. Të varfrit, siç u tha edhe më herët janë vetëm ata që iu drejtohen spitaleve publike, përfundojnë duke blerë gjithçka, duke filluar nga shiringat, fashat e gjithçka tjetër. Ajo çka ofrohet në këto qendra të shëndetit publik

është vetëm puna e dorës dhe në raste të shumta edhe ajo mungon, sepse mjekët janë duke punuar dhe duke u angazhuar në spitalet e tyre private.

I nderuar ministër, nëse merret parasysh gjendja në sektorin e shëndetësisë dhe puna e juaj gjatë këtij mandati, atëherë ajo që mund të vërehet është se ju asnjëherë nuk e keni pasur përkrahjen e Qeverisë dhe të deputetëve të pozitës. Unë besoj, që nga kjo ju keni marrë mësim dhe shpresoj shumë se ky do të jetë edhe një mësim për të tjerët, që eventualisht iu bashkëngjiten koalicionëve të tilla.

Kur flitet për progresin apo eventualisht regresin në një sektor të caktuar, ne gjithmonë ndahemi në ty taborë, në ata që e shohim gotën gjysmë të zbrazët; dhe në ata që e shohin gotën gjysmë të mbushur. Mirëpo, kur flitet për prokurimin publik, unë mendoj që ne duhet të shohim se kush po pi nga kjo gotë, qoftë ajo gjysmë e zbrazët apo qoftë ajo gjysmë e mbushur, sepse mendoj që këtu është një pjesë e madhe e problemit, sepse buxheti edhe pse i vogël i Ministrisë së Shëndetësisë, po tretet.

Nëse ndahen të holla në buxhetin e Kosovës për 100 jastëk që i përmendi Ardiani, ato treten në procedurat e prokurimit dhe nga ato të holla mund të blihen vetëm 10 jastëk në fund, apo për rehabilitime të tjera. Dhe, besoj se kjo është një gjendje që kërkon trajtim serioz dhe nuk di se me çfarë reformash ne mund ta evitojmë këtë. Faleminderit !

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Krasniqi e ka fjalën.

HALIT KRASNIQI: Faleminderit, kryesues!

I nderuari ministër i Shëndetësisë,

Ministër i Infrastrukturës,

Të nderuar deputetë të Parlamentit të Kosovës,

Me kënaqësi kohën time do ta ndaja me deputetët mjekë, të cilët me kompetencë e trajtojnë këtë temë, por është e pamundur që të ndahen minutat e deputetëve dhe të huazohen në bazë të dëshirave që kemi. Por, po të ishte e mundur, unë me kënaqësi do ta ndaja në të gjithë krahët, edhe të deputetëve mjekë të PDK-së.

Do të shfrytëzoj rastin, me këto perceptime që kam unë për shëndetësinë dhe fushën e saj, që të nënvizoj nga gjashtë problematika, të cilat i kam identifikuar unë me këtë qasje që do t'i bëj tani... Edhe në pyetjen parlamentare kur i kam parashtruar ministrit, nuk e kam fshehur respektin dhe konsideratat, as edhe besimin, shpresën dhe kënaqësinë, që kam përjetuar kur është emëruar ministër i Shëndetësisë në Qeverinë e Republikës së Kosovës.

Gjithashtu, këto konsiderata i ruaj edhe sot me gjithë vërejtjet që mund t'i kem në fushën e shëndetësisë, sepse nuk mund t'ia adresoj ekskluzivisht vetëm ministrit ato lëshime.

Unë do të filloj nga çështja e parë që kam identifikuar dhe që dëshiroj që ndikimi i ministrit të mos mungojë dhe unë besoj se edhe ai është i ndërgjegjshëm për këtë dhe sigurisht që ka bërë dhe do të ketë kujdes, përkushtim dhe interesim të përhershëm.

Mundësia e sigurimeve shëndetësore, që nuk është ekskluzivisht në fushën e Ministrisë së Shëndetësisë, por është brenda Qeverisë kjo mundësi dhe në debatin e brendshëm qeveritar do të shtrijë ndikimin me autoritetin që ka.

2. Dukuria e prishjeve të aparateve moderne, që shpeshherë kam të dhëna, këto aparate nuk i kanë as klinikat e regjionit, madje, madje, edhe klinikat e shteteve përkatëse nga prodhohen dhe ku prodhohen këto aparate. Natyrisht, se në prishjen e këtyre aparateve nuk ka vetëm probleme teknike, por është faktori njeri, i cili është i angazhuar që t'i prishë në QKUK këto aparate dhe natyrisht, nevojtarët, pacientët, të sëmurit, familjarët e tyre, të drejtohen në adresa private, ku do të bëjnë shërbime kundrejt shpërblimeve përkatëse, jo vetëm për qendrat ku mjekohen dhe ku kryhen këto shërbime, por edhe për ata që kanë ndikuar në prishjen e aparateve në QKUK.

Kjo mund të jetë edhe paragjykim, mund të jetë edhe teori spekulative, por të len për të dyshuar që vërtetë ka diçka të tillë.

3. Mjekimet jashtë vendit - unë nuk mund ta trajtoj me kompetencë këtë çështje, por mendoj se kontribuoj me një ide, të cilën ministri me përgatitjen e tij, me përkushtimin e tij dhe me interesimin e tij, do ta shtojë brenda Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe do të gjejë vullnet, pastaj në Kabinetin Qeveritar që të merret parasysh kjo.

Mendoj, që gjithë ajo shumë që i dedikohet mjekimeve jashtë vendit do të kishte qenë mirë, që të administrohet në një këndvështrim tjetër, mendoj që një armatë mjekësh me reputacion në klinikat jashtë vendit, ku deri tash për kaq vite kanë kryer shërbime për pacientët nga Kosova, të bëjnë kontratë me Ministrinë e Shëndetësisë dhe të caktohet një orar, një agjendë, për operacione dhe trajtim të pacientëve në QKUK dhe kështu edhe të zvogëlohen shpenzimet, por edhe me këtë shumë, që tani ndahet për mjekime jashtë vendit, t' u mundësohet një numri më të madh të pacientëve edhe atyre që nuk mund të vijnë në shprehje për t'u renditur për mjekim jashtë vendit, por edhe atyre që nuk mund të pajisen me dokumentacion të nevojshëm, për t'u mjekuar në klinika jashtë vendit.

5. Citostatikët, që për mua është një shprehje abstrakte, është sikur të flasësh për Galaksinë, bile madje kam pak të dhëna për Galaksinë, kam pak studime, por për citostatikët fare s' di hiç. Mirëpo, ngaqë shumë familjarë të mi janë përballur me nevojën e këtyre citostatikëve, më ka hyrë edhe në vokabularin tim kjo shprehje tash dhe jam familjarizuar me këtë shprehje dhe e përdori pa ndrojtje dhe pa u skuqur para mjekëve, që ndoshta do të më ishte dridhur zëri ndonjëherë tjetër po ta kisha përdorur.

Kisha apeluar te ministri i Shëndetësisë, që t'i kushtojë një rëndësi shumë të madhe edhe afateve të përdorimit të tyre që vijnë, por edhe shpërndarjes së tyre që bëhet. Unë nuk mund të zgjerohem më tepër këtu, sepse mjafton nënvizimi i kësaj problematike dhe i kësaj nevoje që duhet ta ketë vëmendjen ministri.

6. Specializimi i shqiptarëve jashtë Kosovës - e kisha bërë një propozim, që numri i specialistëve jashtë Kosovës për shqiptarët në Luginë të Preshevës, nga Plava Gucia dhe Ulqini të rritet mundësisht sa më shumë që është e mundur.
7. Dukuria e programit të doktoraturës, që vite më parë opinioni ynë është informuar nga një grup specialistësh, nga një grup studentësh postdiplomikë, të cilët i ka përfaqësuar një mjek karizmatik dhe një mbiemër shumë sintaktiv, zoti Shqiptar Demaçi.

Në atë grup më ka rastisur të dëgjoj një mjeke, e cila thoshte: “Kam kryer programin e magistraturës me të gjitha dhjetëshe, kam pasur edhe të gjitha dhjetëshe gjatë studimeve në Fakultet të Mjekësisë dhe tani për arsye dhe për pengesa administrative, nuk mund të futem në programin e doktoraturës. Ishte e dhembshme edhe si femër, ishte e dhembshme edhe si intelekt, ishte e dhembshme, sepse konsideroj që është resurs i Kosovës dhe do të duhej të trajtohej, do të duhej të trajtohej me shumë respekt dhe me shumë konsideratë ky prodhim i veçantë, ky kapacitet për respekt.

Tani, në këtë kohë aksidentalisht, ishte një ministër me emër dhe mbiemër të përveçëm, por ishte në krye të këtij grupi të studentëve një djalë i një emri shumë të madh dhe shumë të nderuar, që jo vetëm Ministria e Shëndetësisë, jo vetëm Qeveria e Kosovës, por kudo që ai të aplikonte për doktoraturë, në institucionet respektive edhe jashtë Kosovës do të duhej të kishin konsideratë për CV-në e tij.

Kështu që, telegrafikisht paraqita këto gjashtë shqetësime, të cilat mund të mos jenë ato më akutet, mund të mos jenë ato më të qëlluarat, por me këtë preokupim timin dhe me këtë qasje vizuale, që unë kam për problemet në shëndetësi, u mundova që të jap kontributin tim, në këtë minutazh që na lejohej neve. Faleminderit për vëmendje!

KRYESUESI: Faleminderit! E ka fjalën zoti Lutfi Haziri.

LUTFI HAZIRI: Faleminderit, nënkryetar dhe kryesues!

Ministër Agani, në këtë rast më mirë të them i nderuari doktor Agani,

Po flasim për shëndetësinë dhe thirrja më e mirë është mjek. Ka keqkuptime te ne në këtë drejtim.

Atëherë, më lejoni që të filloj me një thënie të popullit, që thotë: “mos të bëftë Zoti për doktorë”, si në Kosovë, si në Zvicër, si në Amerikë, por nëse të bën, pastaj thotë: “mos të lashtë Zoti pa doktorë”.

Unë u inspirova nga një shkrim i një mjeku të ri, që e ka bërë para disa ditësh në portale, besoj e keni lexuar, i cili merret me këtë temë.

Do të duhej që edhe unë njëri nga ju, t’i falënderojmë të gjithë mjekët, punonjësit shëndetësorë, që kohët më të rënda kanë shërbyer pa pagesë, janë organizuar në mënyrë alternative, kanë hapur ambulanca, ordianca dhe salla kudo nëpër Kosovë, nëpër shtëpia, nëpër podrume, nëpër male dhe asnjëherë nuk kanë pyetur për rreziqe, nuk kanë

pyetur për diplomën, për pagesën, për kushtet, por kanë shërbyer dhe rastet e tilla janë të freskëta. Dhe, sigurisht që ministri i parë e ka bërë shembullin më të mirë. Edhe pse ka qenë i Qeverisë në ekzil, s'ka pranuar të dalë në ekzil. Ai është sot mjek në Prishtinë, është i njëjti mjek, i njëjti mision vlen për të dhe Musa Limani është shembull i mirë i kësaj pune.

Po e identifikoj me emrin e tij krejt mjekët tjerë, deri te doktor Imreti, që e ka bërë këtë shkrim dhe ministri që është në detyrë sot, edhe pse në rrethana krejt tjera, të mos harrojmë që një ordinancë gjinekologjike ose një ordinancë kirurgjike në ato rrethana për ta organizuar dhe për të dalë të suksesshme nuk ka qenë lehtë.

Atëherë, ku jemi sot?

(Ndërhyrje: Adem Limani!)

Jo, Adem Limani, kuptohet! Atëherë, ku jemi sot? Kur jam marrë pak me kërkesën e Agim Çekut, kryeministër i Qeverisë së Kosovës, me problemin e shëndetësisë, njëra prej nënkryetareve të partisë sime tash, zonja Teutë ka thënë “super-Luta”, po ngarkohet me detyra përditë dhe s'besoj që mundet t'i përballojë dhe e ka qëlluar, sepse sistemi i shëndetësisë edhe atë ditë edhe sot vepron, sistemi i shëndetësisë ministër, se deputetët janë inspiruar tash për ta lakuar këtë, sistemi i shëndetësisë sot dhe asaj dite udhëhiqet me rregullën e xhunglës.

Alma, në Shqipëri dhe në Kosovë sistemi i shëndetësisë udhëhiqet me rregullat e xhunglës. Për të mos pas keqkuptim, praktikisht udhëheq i forti. I forti dikton rregulla në shërbim, të fortit diktojnë rregulla në shërbim. Jo domosdoshmërisht është ministri, sepse unë pajtohem me Ardianin, kur njeriu e ka zemrën në vendin e duhur, problem është për t' u involvuar në shumëçka, e unë besoj që i forti nuk e ka zemrën në vendin e duhur dhe dikton për shkak të resurseve edhe ashtu të vogla, këtë sistem të madh, sistemi më i madh besoj mbas arsimit në Kosovë, është shëndetësia dhe i dikton rregullat dhe kushtet e veta, për shumë motive.

Prishja e kësaj rregulle në sistemin e shëndetësisë është atëherë kur vendoset ligji, sundimi i ligjit, aplikimi i ligjit dhe aplikimi i shërbimeve më të mira, më të drejta, atëherë kur mjekët flasin e nuk flasin të fortit, atëherë kur mjekët menaxhojnë e nuk menaxhojnë të fortit, sepse ajo që na ka lënë UNMIK-u të keqe është jo vetëm në sektor të shëndetësisë, por sidomos në sektorë të mëdhenj, për të administruar me sektorë jo për të menaxhuar, jo për të udhëhequr. Logjika e administrimit, mënyra më e egër vërehet në shëndetësi dhe në kulturë, edhe kultura, si sektor tjetër që është i rëndësishëm. Njerëzit shkojnë atje, ministrat shkojnë atje, drejtorët shkojnë atje për të administruar e jo për të menaxhuar me resurset dhe njerëzit që janë atje.

Shkojnë administrojnë. Administrim është kur kontrollohet fondi, kur ndërrohen prioritetet, kur rrëzohen ligjet, kur sfidohet sistemi dhe natyrisht në administrim rëndësinë e kanë autoritetet, pavarësisht a janë legjitime a s'janë, por, unë besoj edhe më

tutje, se sektorët e mëdhenj duhet t'i udhëheqin menaxherët e mirë dhe shërbimet t'i organizojnë mjekët e mirë.

Atëherë, unë meqë u përmendën shembuj të këqij këtu e që ka përditë, më lejoni të përmend një shembull të mirë. Pesë mjekë të Kosovës në fund të vitit 2007 e kanë menaxhuar një operacion shumë të rëndë, i cili në Universitetin e Zvicrës, në Cyrih, që është Universiteti për nga ranglista i dhjeti në botë për shërbime, kanë hyrë si sukses i parë pas vitit 1981 për menaxhim dhe për sukses në operacion shumë të rëndë.

Por, ajo që e kanë evidentuar në fund të suksesit thotë: gjendja pasoperacionale ka shkaktuar infeksione vdekjeprurëse traumatike për pacientin, për shkak të kushteve në institucion. Ka rastisur, që këta mjekë njëri ta ketë mbiemrin Krasniqi, njëri ta ketë Jaha, njëri ta ketë Osmani, janë edhe tre të tjerë, që s'po ua përmend me qëllim, sepse bëj shembull të keq, po i përmendi sepse prej 6 mjekëve këta janë tre që kanë udhëhequr, tre të tjerë kanë asistuar dhe janë rezultat i një suksesi të mirë.

Edhe këtu ka rastisur, që të jetë babai im, i cili në Kosovë nuk ka jetuar kurrë më shumë se një muaj në vit, dhe i cili e ka sistemin shëndetësor në mënyrën më të mirë në botë të organizuar, sepse Zvicra njihet për sistem shëndetësor më të mirë, më perfekt, por sëmundja e ka zënë në Gjilan, nuk e ka zënë në Zvicër. Fondi shëndetësor i tij është në Zvicër, nuk është në Kosovë dhe është dashur mjekët e Kosovës të merren me atë problem. Mjekët e Kosovës janë marrë me atë problem, e kanë menaxhuar dhe janë evidencuar si sukses i mirë.

Po e përmendi, aftësia e mjekëve, potenciali i mjekëve tonë është i barasvlershëm me çdo mjek, kudo në botë që ekziston, unë e besoj. Në kushte janë pabarabartë edhe në ambient të punës edhe në kushte të punës edhe në gjithçka që i duhet një mjeku ta ketë pas para se të kryej veprime të tilla.

Ju lutem ministër, krahas reformave që janë sfiduar në arsim, e unë mund t'ua konfirmoj edhe njëherë, që amendamentet që shkaktojnë reforma në Kosovë janë rrëzuar prej Gjykatës Kushtetuese, largojeni së paku logjikën e administrimit prej institucioneve shëndetësore, largojeni logjikën e arrestimeve të mjekëve për forma të caktuara korruptive, jo korruptive çka do që ndodh, largojeni kërcënimin prej mjekëve, se ata që po administrojnë po i rrezikojnë seriozisht pacientët, duke atakuar mjekun, punëtorin shëndetësor, motrën medicinale dhe krejt atë ekip të madh të njerëzve.

Dhe në fund, largoje atë biznes të vogël, që për shkak të shitjes së kafes, së byrekut dhe një copë bukë dhe një copë mish atje, po e marrin në qafë krejt atë përkujdesje shëndetësore dhe milionë euro që harxhohen atje.

Në fund unë jam njëri prej atyre që besoj shumë, që nëse kryeministri si të kthehet sot prej Brukselit me plan të miratuar të implementimit do të vendosë që 10% të buxhetit të harxhuar për asfalt në vitin 2013, ka me bë prerje për vitin 2014, do t'ia dërgojë shëndetësisë, si hap i parë. Këtë po e përmendi me qëllim, sepse krejt e dimë sa është buxheti sivjet i asfaltit, sa u harxhua. 10% le ta ndajë, le ta vendosë që vitin e ardhshëm

shëndetësia i merr si mjete financiare të domosdoshme dhe shkallëzimi për çdo vit në rritje, sepse sektori i shëndetësisë duhet, përveç fondit shëndetësor të sigurimeve shëndetësore, duhet të ketë edhe fond të qëndrueshëm dhe organizim të qëndrueshëm të këtij shërbimi, që e ruan shëndetin e këtij populli, sepse shëndeti është jashtëzakonisht i kërcënuar apo është në duar të mjekëve turq, që kanë hapur ordinanca në çdo vend. Tash, prej Prishtinës kanë filluar të kërkojnë filiale, t' i bëjnë nëpër qendra të mëdha, sepse aq shumë kanë punë. Përveç historisë, tash edhe shëndetësia gradualisht do të rrëshqas në duar të mjekëve dhe autoriteteve turke, që është tejet mik i Kosovës, se s'kam problem me atë, por kam problem, kam problem pse të ndodhë, kur kemi mundësi ta bëjmë.

Në vitin 2007, njëri prej rekomandimeve kryesore - politikat qeveritare, që i është dorëzuar kabinetit Thaçi, një ka qenë që buxheti i Ministrisë së Shëndetësisë duhet të ketë prioritet numër një, duhet të sigurojë funksionalitet të plotë të shëndetësisë, të të tri shkallët e saja dhe duhet të ketë rritje graduale, rritje të përvitshme, derisa nuk e plotëson kuotën e kënaqshme, që ky sistem të jetë i qëndrueshëm dhe në shërbim të popullit.

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Lama e ka fjalën.

ALMA LAMA: Faleminderit zoti kryesues!

Meqë kolegu ynë Komisioni e përmendi Shqipërinë, a ta bëjmë një debat për mjekësinë e Shqipërisë, zoti Haziri?

KRYESUESI: Atëherë zonja Mustafa! Replikë? Mirë! Zoti Haziri, replikë.

LUTFI HAZIRI: Faleminderit!

Unë me qëllim e përmenda, sepse nuk i ndaj fort. Nuk i ndaj as të mirat, as problemet me shtetin shqiptar, që themi ne - shteti amë, shumica prej nesh, por pyetni pacientët e Kosovës që shkojnë në qendra spitalore atje, çfarë kushtesh duhet t' i plotësojnë ata për t' u trajtuar, përveç nëse nuk i kanë prapë të fortit pas vetes që t' u ndihmojnë. Është e njëjta rregull, është e njëjta logjikë, e njëjta kulturë pune, e njëjta mënyrë trajtimi. Pak dallojnë, veç që ata i kanë mundësitë pak më të mëdha se ne, që i kemi mundësitë më të vogla.

KRYESUESI: Kundër-replikë. Alma, po më duket se jeni kot duke folur edhe ti, edhe ai, për këtë çështje.

ALMA LAMA: Pajtohem plotësisht, por nuk e kuptova pse emri im u përmend aty, në foltore.

KRYESUESI: Zonja Salihe Mustafa e ka fjalën.

SALIHE MUSTAFA: Faleminderit, kryesues!

In nderuari ministër,

Të nderuar kolegë deputetë,

Sot po diskutojmë për një sektor të rëndësishëm dhe shumë të ndjeshëm, të cilin po e përcjellin rezultate të prekshme dhe vështirësi të shumta. Për t' i tejkaluar këto vështirësi,

duhet angazhimi i të gjithëve, në mënyrë që punëtorët shëndetësorë dhe qytetarët të japin dhe të marrin shërbime cilësore. Kur them të gjithëve, dihet se përgjegjësia më e madhe i takon Ministrisë së Shëndetësisë, por edhe Kuvendi e ka obligimin e vet duke miratuar ligje që do ta ndihmonin këtë sektor, por edhe duke e bërë monitorimin e zbatimit të tyre.

Problemet e akumuluar me vite në shëndetësi nuk është e lehtë të zgjidhen. Nuk ka dyshim se ka përpjekje nga institucionet, si dhe përkushtim nga profesionistët shëndetësorë. Tani më është aprovuar Ligji i ri i shëndetësisë. Edhe pse me vonesë, ne po presim fillimin e menjëhershëm të implementimit të tij nga Ministria e Shëndetësisë. Nëpërmjet këtij ligji pretendohet punësimi i mjekëve të rinj dhe i specialistëve, duke krijuar mundësinë që gjithë bagazhin e tyre profesional ta japin në klinikat kosovare, e jo të mendojnë për sistemimin e tyre nëpër klinikat jashtë vendit.

Mirëpo, për të qenë Ligji i shëndetësisë më lehtë i zbatueshëm dhe më funksional do të duhej të ishte i miratuar edhe Ligji i sigurimeve shëndetësore, së bashku me të. Andaj, kërkohet nga Ministria e Shëndetësisë që sa më shpejt të fillojë me zbatimin e Ligjit të shëndetësisë, në mënyrë që të krijohet mundësia edhe për miratimin e Ligjit të sigurimeve shëndetësore. Me kompletimin e infrastrukturës ligjore, profesionistëve shëndetësorë, me përkushtimin që kanë do t'u jepet mundësia më e madhe t'u ofrojnë shërbime edhe me cilësore qytetarëve tanë.

Vlen të ceket se për shkak të moseriozitetit të një numri të vogël të mantelbardhëve, etiketohen të gjithë, duke harruar të përmenden sukseset në punët dhe të arriturat e shumicës. Raportet e institucioneve shëndetësore flasin për punë të mëdha dhe të suksesshme që po bëhen dhe ka rezultate në disa shërbime që janë ekuivalente me ato të vendeve të zhvilluara. Nuk ka dyshim që duhet shumë për të bërë për ta përmirësuar gjendjen në shëndetësi, por nuk pajtohem që të shihet gjithçka zi.

Është me rëndësi të theksohet se gjendja në nivelin parësor shëndetësor është shumë më e mirë në krahasim me nivelin dytësor dhe tretësor. Sipas Organizatës Botërore të Shëndetësisë, me vaksinimin e rregullt të fëmijëve në Kosovë nuk ka raste të paralizës së fëmijëve, e kjo është arritur duke pasur parasysh preventivën në shëndetësinë kosovare, e kjo është e arritur me pak para, domethënë për disa gjëra nuk nevojitet shumë buxhet, por një menaxhim i mirë. Gjithashtu është arritur shumë në promovimin dhe edukimin shëndetësor. Duke e pasur parasysh këtë, duhet që kujdesi parësor shëndetësor të fuqizohet edhe më shumë. Me fuqizimin e kujdesit parësor shëndetësor, edhe në kujdesin shëndetësor dytësor dhe tretësor do të ketë numër më të vogël të pacientëve dhe me këtë do të krijohet mundësia që profesionistët shëndetësorë të këtyre niveleve të ofrojnë shërbime më cilësore shëndetësore.

Një problem në vete paraqet furnizimi me barna nga lista esenciale në të tri nivelet e shëndetësisë. Furnizimi me barna nga lista esenciale nuk është aspak i kënaqshëm, por siç na ka premtuar ministri, edhe kjo do të stabilizohet dhe kërkojmë që kjo të ndodhë sa më shpejt, sepse derisa ne po debatojmë, një numër i madh i pacientëve dhe i punëtorëve shëndetësorë po ballafaqohen me këtë problem.

Edhe një çështje e rëndësishme që duhet kushtuar vëmendje është funksionimi më i mirë i Inspektoratit Shëndetësor, kur dihet roli i tij. Edhe pse e dimë që është një numër i vogël i inspektorëve, megjithatë me një menaxhim më të mirë duhet t'u krijohen kushte dhe mundësi më të mira për punë për të qenë më efikas.

Të nderuar kolegë,

Ne po presim shumë më shumë se tani, ngase kemi potencial që shëndetësinë ta kemi ndryshe. Andaj, besoj se kjo gjendje mund të përmirësohet me një angazhim dhe punë më të madhe, me një menaxhim edhe më të mirë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Asllanaj e ka fjalën.

SALI ASLLANAJ: Faleminderit, kryesues!

Përsëritje për ministrin,

Po më duket që ta kritikosh ministrin sot është shumë e lehtë dhe shumë e thjeshtë kjo punë. Edhe prej këndit opozitar, është ndoshta tepër komode kjo punë. Nuk kisha dashur ta shfrytëzoj pozicionin opozitar të partisë sime dhe tash të gjuaj krejt gurët e mundshëm për ministrin, por kisha dashur ta përsërites ministrin për reformat që i ka filluar. Këto reforma objektivisht janë të domosdoshme dhe kërkohet një konsensus pak më i gjerë, në mënyrë që të arrihet sukses i plotë. Varianti më i keq i mundshëm, pajtohem me ministrin, është nëse ato ngecin diku në mes rrugës. Prandaj, zoti ministër, unë kisha dëshiruar që, jo vetëm edhe 6 muaj të presim, por do të presim edhe më gjatë, në mënyrë që shëndetësia vërtet të vihet në këmbë të shëndosha.

A do të jetë në këmbë të shëndosha, unë e di që nuk varet krejt prej ministrit aktual që është, ndoshta duhet edhe një mandat tjetër, në mënyrë që t'i çojë deri në fund reformat, por gjithsesi janë shpresëdhënëse që do të ndodhin.

Unë i kam vërejtjet e mia, që i tha edhe Hykmetja më herët. Është vërtet absurde që te ne ndodh që opozita t'i përkrahë projektligjet e Qeverisë, kurse partia në pushtet i kundërshton.

Nuk di se a do të mjafton kjo, ministër? Sa u përket disave, që e di se merren me çështje të shëndetësisë brenda LDK-së, do ta kesh përkrahjen maksimale, në mënyrë që të ketë sukses. Nuk ka çështje më të ndritur, më të nderhme, se të kemi sukses në lëmin e shëndetësisë. A do ta ketë Qeveria në vitin e ardhshëm një prioritet, e Luta premtoi se do të ketë ndoshta rritje të buxhetit, dyshoj, por shpresa është që nëse e procedoni sa më shpejt Ligjin mbi fondin për sigurimin shëndetësor, edhe të përmbillet një kapitull i një reforme shëndetësore. Unë e di që keni probleme edhe me Ligjin për odat e profesionistëve shëndetësorë, por gjithsesi do të provojmë që me të gjitha forcat t'i tejkalojmë dhe në këtë mënyrë të ecim përpara. Nëse viti i ardhshëm është një shenjë e një kthese pozitive, ndoshta do të jem i pari prej opozitës që do t'i duartrokas një suksesi të tillë, zoti ministër!

Për gjëra të tjera, për gjendjen aktuale, më lejoni të shpreh mendimin me krejt bashkëbiseduesit e mi, që objektivisht shëndetësinë e përshkruajnë në gjendje të rëndë

shëndetësore. A i mjafton vetëm neuropsikiatri? Unë mendoj që duhet edhe kirurgu. Faleminderit!

KRYESUESI: Zoti Ymeri e ka fjalën

VISAR YMERI: Faleminderit, kryesues!

Deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës,

E dëgjuam nga ministri të thotë se është herët të paragjykojmë pra se çfarë do të prodhojë Ligji i ri për shëndetësi dhe reformat, të cilat paskan nisur, e të cilat i kemi parë që nuk janë në vijë as me interesin e Kosovës, por veçanërisht nuk janë në vijë me ato që i ka paraqitur Ministria, ose më saktësisht ministri në idetë e tij fillestare nëpërmjet ligjit dhe pastaj edhe përmes premtimit të ligjeve mbështetëse, pra komplementare për këtë reformë, që po quhet në sektorin e shëndetësisë.

Natyrisht që duhet t'i ikim kësaj klisheje që mendoj që ndërtohet shpeshherë kur bisedojmë për gjëra të tilla, jo vetëm në shëndetësi, por në secilin sektor të shoqërisë, kur fjala reformë si formë nënkuptohet domosdoshmërisht pozitive. Pra, thuhet do të bëjmë reforma, e kjo automatikisht e nënkupton se do të jenë pozitive. Reformimi nuk është përherë pozitiv, pra reformimi mund edhe të shkatërrojë. Reformimi edhe të shkatërrojë, dhe ka shumë reformime që janë quajtur reforma, të cilat i kanë shkatërruar sektorët, gjë që rrezikon ta shkatërrojë edhe sektorin tonë shëndetësisë, edhe ashtu të degraduar deri në njëfarë mase, që e përmendën shumë deputetë.

Pra, jo secila reformë është e mirë dhe tash duhet ta diskutojmë se çfarë reforme po bëjmë. Këtë reformë strukturale, të cilën po e prezanton dhe po e përfaqëson ministri, a do të jetë kjo e mirë, jo vetëm për sistemin e shëndetësisë së Kosovës, por a do të jetë më e mirë para së gjithave dhe mbi të gjitha për interesin e qytetarëve të Kosovës, për shkak se shëndetësia nuk mund të jetë asnjëherë interes privat. Shëndetësia është përherë interes publik. Është publik në secilin dimension të saj dhe meqenëse është publik, ajo domosdoshmërisht duhet të jetë universal, pra që në të të kenë qasje universale të gjithë individët e shoqërisë, pavarësisht se prej cilës shtresë të shoqërisë vijnë, apo pavarësisht të ardhurave mujore e vjetore që ata mund t'i kenë.

Pra, nëse ligji deri tash paska qenë pengesë, atëherë trajtimi i mirëfilltë i efekteve që do t'i ketë ligji në të ardhmen, është çështje shumë e rëndësishme që duhet të diskutohet në këtë interpelancë për sektorin e shëndetësisë, për shkak se po që se bazohemi në analizimin e ligjit, atëherë nuk mund të thuhet se po paragjykojmë se çka do të jetë e ardhmja në shëndetësi, por saktësisht po e përcaktojmë se cila do të jetë ajo, duke u bazuar në parimet ligjore, të cilat janë miratuar këtu në Kuvend.

Një çështje e dytë që dua ta ngre ose lidh po ashtu me ligjin, edhe pse në këtë çështje, pra të tendencës privatizuese të sektorit të shëndetësisë, ligji është përmirësuar pas amendamentimit në Kuvend deri diku, por jo në masën çfarë i duhet Kosovës. Pra, e kam fjalën për partneritetin publiko-privat, një koncept ky që me ministrin tentohet të futet edhe në sektorin e shëndetësisë. ministri e përmendi me shumë të drejtë që sektori i shëndetësisë nëpër vende të ndryshme të botës ka paraqitur probleme të ndryshme, edhe

të korrupsionit, pavarësisht se në cilin vend, për shkak të politikave të caktuara, dhe unë mendoj që problemi kryesor është te politikat të cilat zbatohen në një sektor të caktuar. Pastaj vjen edhe menaxhimi natyrisht dhe pastaj në fund vjen, të them ashtu, edhe papërgjegjësia, apo dashakeqësia individuale e punonjësve të përfshirë në atë sistem, por, para së gjithash dhe mbi të gjitha, përgjegjëse është politika për një sektor të interesit publik, çfarë është shëndetësia.

Partneriteti publiko-privat, çfarë ka bërë ai nëpër botë, është që ka rezultuar në bartjen graduale, nganjëherë të heshtur, e nganjëherë të zëshme, të të mirave publike, të krijuara nga pasuria publike te kapitali privat. Pra, këtë shërbim e ka kryer partneriteti publiko-privat, veçanërisht në sektorët e shëndetësisë, e këtu dua të them veçanërisht në sektorin e farmaceutikës, pra në sektorin e prodhimit të barnave, ku shumica e asaj që quhet hulumtim dhe zhvillim i shkencës dhe teknologjisë, që është financiar nga paratë publike, pastaj u është bartur korporatave private, të cilat kanë realizuar profite të mëdha nëpërmjet këtij partneriteti publiko-privat. Pra, këtë rezultat e ka dhënë partneriteti publiko-privat. E tash i njëjti koncept po tentohet të na instalohet këtu në Kosovë, nëpër spitalet tona.

Javën e kaluar, ose ditëve të fundit, para dy javëve, në opinion është plasuar lajmi që Ministria e Shëndetësisë synon ta fusë partneritetin publiko-privat në disa klinika të QKUK-së. Pra, është bërë fjalë për Klinikën e Biokimisë dhe Radiologjisë.

Duke planifikuar pra që ta privatizoni sektorin publik, ashtu siç bëri, ose siç po bën ministri i Zhvillimit Ekonomik, në këto dy klinika, duhet të përmendet që për sa i përket shëndetësisë, këta dy sektorë, pra i Radiologjisë dhe i Biokimisë, janë ndër sektorët më profitabilë nga të gjitha gjinitë tjera në shëndetësi. Pra, Instituti i Biokimisë është natyrisht zemra e diagnostikës dhe të gjithë e dimë që diagnostika është parakusht themelor për kurimin korrekt të pacientët. Pra, mbi 90% të pacientëve gjithsesi do t'u nevojitet shërbimi analitik i Institutit të Biokimisë.

Industria monetare në Qendrën Klinike Universitare është në shitje e sipër dhe sipas recetës së reformës së reformës suaj, shëndetësia pa dyshim se është duke shkuar një hap para dhe dy prapa, por kjo tendenca e privatizimit do ta prodhojë një sistem tjetër të shëndetësisë, i cili do të jetë sistem i shëndetësisë mbase më cilësor, por do të jetë më cilësor për ata që kanë, pra do të jetë cilësor për një pjesë të ngushtë të popullatës qytetare, ndërkohë që do të jetë inekzistent për pjesën dërmuese të qytetarëve të Kosovës, të cilët, ne të gjithë e dimë, që nuk i kanë mjetet për ta përdorur një sistem të privatizuar të shëndetësisë.

Prandaj, kur themi që po duam ta depolitizojmë sektorin e shëndetësisë, unë mendoj se fjala adekuate është që sektori i shëndetësisë duhet të departizohet, pra që partitë politike, ato në pushtet dhe tjerat, që mund të kenë ndikim, ta heqin ndikimin nga ky partizim i sektorit të shëndetësisë, i cili do t'i hapte rrugët pastaj profesionalizimit të sektorit të shëndetësisë. Mirëpo, sektori i shëndetësisë, meqenëse është politikë publike, nuk mund të depolitizohet për shkak se është çështje politike si po e ndërton sistemin e shëndetësisë. Dhe, natyrisht që është një vendim politik në atë nëse e do një sistem të shëndetësisë

tërësisht të privatizuar, të cilin do të mund ta shfrytëzonin vetëm ata që kanë para, dhe po ashtu vendim politik nëse e do një sistem publik të shëndetësisë, i cili është universal, pra që u lejon qasje të gjithë qytetarëve që kanë nevojë në të.

Edhe një herë po e përsëris, nuk mund të përjashtohet nga sistemi i shëndetësisë asnjë qytetar, meqenëse asnjë qytetari nuk mund t'i mohohet e drejta që ai të ketë shërbime të shëndetësisë, duke e pasur parasysh rëndësinë që shëndetësia e ka për individin dhe për shoqërinë në përgjithësi në të gjithë sektorët që i përmenda më herët.

Pra, kjo tendencë e privatizimit të sektorit të shëndetësisë, konsiderojmë ne, jo që e ndihmon dhe jo që e përmirëson shëndetësinë në Kosovë, por vetëm sa do ta bëjë atë të pamundur për pjesën më të madhe të qytetarëve, e natyrisht që dihet që qytetarët me të ardhura më të ulëta, ose qytetarët që quhen të varfër, ata shumë më shumë kanë nevojë për një sistem efikas të shëndetësisë, meqenëse niveli i shëndetit të ta, për shkak të të ardhurave, zakonisht është më i ulët, për shkak të keq ushqimit, për shkak të mungesave të kushteve të higjienës dhe për shkak të arsyeve të tjera që ndikojnë në shëndetin e qytetarit. Pra, në vend se të...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Kymete Bajraktari e ka fjalën

KYMETE BAJRAKTARI: Faleminderit, kryesues,

Të nderuar kolegë deputetë,

Zoti ministër,

Mjafton t'i vizitosh qendrat shëndetësore, qoftë në Qendrën Klinike Universitare, spitalet rajonale apo qendrat e mjekësisë familjare, e të shohësh se në çfarë gjendje të mjerë janë këto institucione shëndetësore, si për nga organizimi, menaxhimi, infrastruktura e objekteve dhe pajisja me teknologji shëndetësore.

Në hyrje të spitaleve vërehet numër i madh i pacientëve që presin për të marrë shërbime shëndetësore, e edhe më i madh është numri i familjarëve, të cilët në orarin e vizitave, edhe pas këtij orari, janë të detyruar të qëndrojnë korridoreve, sepse në çdo kohë nga mjekët kërkohet diçka për terapi dhe ata detyrohen të dalin e t'i blejnë. Thuhet dhe proklamohet se shërbimet shëndetësore në institucionet publike janë pa pagesë, ose për këto shërbime kërkohet një shumë e vogël e participimit. Por, në fakt, këto shërbime kushtojnë, sepse nëpër spitale nuk ka barna, apo ka shumë pak dhe pacientët detyrohen t'i blejnë me kosto shumë të lartë.

Që nga paslufta, shërbimi shëndetësor, jo që po rregullohet, por çdo ditë e më shumë po bie niveli i shërbimeve, si në aspektin cilësor, ashtu edhe sasior. Për këtë, qytetarët e Kosovës e kanë humbur besimin në shëndetësinë kosovare dhe rrugëzgjidhje kanë gjetur në trajtimin në vendet e rajonit, por edhe më larg.

Ço ditë, nga mediet e shkruara dhe elektronike, dëgjojmë për një skandal të radhës, të ndodhur në këta sektorë. Andaj, dikush për të gjitha, këto duhet të jep përgjegjësi, e kjo

në radhë të parë bie në menaxhmentin e lartë, siç është Ministria e Shëndetësisë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Radhën e ka Blerta Deliu.

BLERTA DELIU: Faleminderit, kryesues!

Përshëndetje për ministrin,

U tha shumë, u diskutua edhe për sfidat dhe për problemet me të cilat përballet shëndetësia në Kosovë, si dhe për reformat e shumta që janë ndërmarrë për ta përmirësuar këtë gjendje. Unë do të ndalem te çështja e insulinës me banderola të Serbisë, e cila ka hyrë ilegalisht në Kosovë, e që ka përfunduar në qendrat publike të mjekësisë familjare. Siç e dimë të gjithë, kjo sasi e insulinës ka qenë e dedikuar për tregun e Serbisë, por ka përfunduar në Kosovë; në Skenderaj, në Gjakovë dhe në komunën e Ferizajt.

Në barnatoren e Qendrës Klinike të Mjekësisë Familjare në Skenderaj janë gjetur gjithsej 126 kuti të kësaj insuline. Këtë e përmendi edhe ministri Agani gjatë fjalës së tij. E përmendi dhe bëri të ditur që Ministria e Shëndetësisë e ka tërhequr nga tregu këtë produkt menjëherë, si dhe është kërkuar të rritet numri i punëtorëve farmaceutikë. Megjithatë, duke e marrë parasysh rrezikshmërinë që mund të bartë insulina në rast se ajo nuk është si duhet, apo nuk transportohet sipas kushteve të para dhe se ky bar duhet të kontrollohet nga shteti, sepse është ilaç shumë specifik dhe si i tillë ka depërtuar në institucionet publike, unë dua ta pyes ministrin a janë masa, do të thotë cilat janë vlerësimet për këtë çështje? A ka projekt specifik për pacientët të cilët kanë marrë insulinë me prejardhje të dyshimtë, sepse, siç edhe jemi të informuar, efektet anësore që mund të prodhojë ky lloj bari janë rezistente dhe mund të shkojnë deri në 10 vjet që pacientët mund t'i pësojnë këto efekte anësore. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Ferati, nuk është. Zoti Shaip Muja e ka fjalën.

SHAIP MUJA: Zoti kryesues!

Edhe pse kam vërejtje për mbajtjen e rendit në radhitjen e bisedimeve, mendoj se nuk është hera e parë dhe kisha pasur qejf që edhe IT-ja të na i prezantojë me radhë kërkesat kur po i paraqesim që të shohim vërtet a po mbahet një radhë apo jo.

Këtu gjatë debatit po shoh shpeshherë adresime nga partitë opozitare lidhur me vendimin e Kushtetutës për një grup deputetëve të kryesuar nga unë, që na kanë kthyer një përgjigje pozitive dhe cilët po përpiqen ta atakojnë edhe Gjykatën Kushtetuese, por për çudi nuk e atakonin Gjykatën Kushtetuese kur e anuloi presidentin Sejdiu, presidentin Pacolli, por po e atakojnë një ligj, i cili është kërkuar nga 6 800 punonjës shëndetësorë, që të rishikohet mbi bazën e kushtetutshmërisë. Kjo mua më ka motivuar që unë të jem përfaqësues i tyre, së bashku me këta deputetë në Gjykatën Kushtetuese dhe e falënderojmë shumë atë për një gjykim të drejtë, të befasuar edhe me qëndrimin e Avokatit të Popullit, i cili ka mbajtur një qëndrim të kundërt me vendimin e Gjykatës Kushtetuese, por megjithatë në këto institucione, siç duket, nuk e di kush a do të bëjë opozitë, a do të bëjë politikë, a do të reklamohet në televizion, apo diçka tjetër.

T'i kthehem çështjes së debatit të sotëm. Ne duhet të jemi koshientë se pas luftës, sistemi shëndetësor primar, sekondar dhe terciar në Republikën e Kosovës ka qenë tërësisht i rrënuar dhe është menaxhuar nga UNMIK-u, për të cilin vërtet me disa bashkëbisedues jam dakord që nuk e ka menaxhuar ose nuk e ka radhitur në atë mënyrë, e cila sot nuk po shkruhet vetëm për Qendrën Klinike Universitare. Sot nuk dëgjova këtu për sistemin primar se si është situata. Nuk e përshkroi askush. Atje fillon problemi i shëndetësisë, nuk fillon në Qendrën Klinike Universitare. Nuk foli askush për spitalet regjionale, çka është duke ndodhur, çfarë menaxhimi është duke u bërë atje. Nuk përshkruhet situata e tillë dhe dilet vetëm në Qendrën Universitare dhe jepet përshtypja që ne nuk e njohim situatën në shëndetësi, por e njohim vetëm deri në Qendrën Klinike Universitare.

Për 10 vjet në këtë Parlament kanë ardhur dy ligje të shëndetësisë, prej të cilëve njëri nuk është vlerësuar plotësisht se çfarë ka ndodhur me tjetrin, është duke ardhur edhe Ligji i barnave, që do të thotë dy herë vjen ai ligj dhe prapë kemi probleme me barna. Janë ndërruar 5 ministra, që i bie përafërsisht nga 2,2 vjet kohëgjatësia dhe ne kërkojmë performansa të cilat ..

(Ndërprerje nga regjia: Një minutë, zoti kryesues!)

...dhe ky debat po merr kah joserioz, duke i prezantuar deputetët eksperiencat e tyre, me të cilat mundohen ta mbulojnë punën titanike që e bëjnë mjekët në sistemin shëndetësor. Prandaj, unë propozoj që ministri, pas 6 muajsh, së bashku në konsultim edhe me parashtruesin e këtij debati, të na raportojë duke i sjellë në Parlament këtu çështje: gjendjen e sistemit të informimit shëndetësor në Republikën e Kosovës, i cili është duke u implementuar tash e 13 vjet dhe është duke u bartur nga Qeveria e Luksemburgut në Qeverinë e Republikës së Kosovës, e që në vitin 2015 thuhet se do të përfundojë me kontratë.

E unë mendoj se do të jetë një problem shumë serioz edhe për reformën, për të cilin ne po flasim. Gjendja e Agjencisë të Financimit, siç është baza ligjore e përgatitur dhe si janë resurset humane, të cilat duhet ta bartin Agjencinë e Financimit. Sa kemi ne kuadro në këtë agjenci të punojnë nga pjesa që quhen ekspertë të mjekësisë financiare? Mandej, gjendja e planifikimit të kuadrove, cila është situata sot e kuadrove? Nga kuadri, 400 mjekë punonjës vitin e kaluar kanë ikur në Evropë. Është duke u plakur kuadri ynë dhe ne e kemi një situatë, e cila do të vijë në shumë sektorë, pa kuadro, pa mbulim të kuadrove.

Cila është gjendja në sistemin aktual primar? A është duke u bërë zonimi? A është duke u bërë menaxhimi nga kryetarët e komunave? Cili është monitorimi që është obligim i Ministrisë së Shëndetësisë dhe cilat janë detyrimet? Mandej tek pjesa e fundit, e cila mendoj se është gjendja në laboratorin e barnave, a është ky laborator relevant, i cili nuk është i akredituar dhe i cili me të vërtetë e ka akumuluar një sistem, i cili ka vërejtje të shumta, por në Ligjin e barnave ne do t'i dakordojmë.

Lus Sekretarinë që këto propozime, të cilat ne i dhamë, së bashku me parashtruesin, t'i dakordojë dhe të jenë pjesë e një raportimi normal për një gjendje faktike çfarë është

duke ndodhur në shëndetësi, e jo të nxirren eksperiencat personale, sepse sukseset që kanë...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Faleminderit! Është mirë që grupet parlamentare t'i harmonizojnë në grupe kërkesat dhe t'i paraqesin si grupe, e jo si individ. Zoti Lladrovci ka shprehur dëshirë ta marrë fjalën.

RAMIZ LLADROVCI: Faleminderit, nënkryetar!

I nderuar ministër,

Të nderuar kolegë deputetë,

Po e shoh se edhe ministri pak është mërzhitur, prandaj unë po e dorëzoj diskutimin me shkrim, kështu që po ia lë minutat e mi ministrit, se më duket i ka harxhuar. Faleminderit!

KRYESUESI: Ministër, e keni fjalën për replikë. Para se të replikoni, desha t'i them Shaipit se IT-ja nuk e bën rendin, por kryesuesi i seancës, prandaj tani ke qenë në radhë për ta marrë fjalën.

MINISTRI FERID AGANI: Vetëm desha një sqarim lidhur me deklaratën që e tha deputeti Muja për nenin 41.

Për hir të opinionit dhe për hir të korrektësisë edhe ndaj këtij Kuvendi, duhet sqaruar shumë qartë se gjërat janë me të vërtetë shumë të qarta në këtë aspekt. Deputeti Muja me një grup të deputetëve i kanë apeluar 4 nene të Ligjit të shëndetësisë, prej këtyre 4 neneve, në 3 nene është refuzuar ankesa, prandaj nuk po shoh çfarë suksesi është arritur këtu. Janë anuluar 3 paragrafë të nenit 41, ndërsa deputeti Muja e di që në Gjykatën Kushtetuese ka kërkuar anulimin e plotë të ligjit dhe, natyrisht, anulimin e plotë të reformës dhe ruajtjen e status quo-s.

De fakto, në pajtim me atë që ka bërë edhe kur e ka nënshkruar këtë parashtresë, e cila de fakto shkon në anulimin e reformës, por për fat të mirë reforma ka filluar dhe ndryshimet do t'i shohim të gjithë së bashku. Ajo që është me rëndësi, është ta kuptojmë që reforma kërkon një bashkëpunim të të gjithë partnerëve, të gjithë faktorëve shoqërorë, veçanërisht brenda sektorit.

Prandaj, nuk është të ketë paragjykime. Të jeni të bindur që edhe partneriteti publiko-privat nuk është kot publiko-privat. Nuk është privato-publik, është publiko-privat.

Sektori privat, me reformën që e kemi dizajnuar, do të jetë në shërbim të sektorit publik. Me çfarë modeli, do ta shohim. Mua, nga njëra anë, pak nga mosinformim i ndërsjellë, nga njëra anë po më lehtëson, të ju them të drejtën, sepse po i kuptoj që paragjykimet janë për shkak të mosinformimit, por në anën tjetër po më brengos, sepse po shihet që nuk kemi pasur mundësi...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Kundër-replikë, një minutë, zoti Muja.

SHAIP MUJA: Unë zoti ministër, po jua sqaroj që në një debat pak më të shtruar, neni 41 ka qenë rrënues i të drejtave të njeriut, paragjykues i mjekëve në mënyrë apriori dhe ka qenë shkatërrues për sistemin publik. Ky sistem me formën që është paraparë me këtë ligj, për atë unë e falënderoj Gjykatën Kushtetuese, ju kisha lutur që asnjëherë më të mos e përmendni. Mund ta bëjmë një debat enkas për këtë. Ju nuk keni të drejtë t'i paragjykoni mjekët se a marrin ndër dorë apo nuk marrin. Është ligji dhe janë format të cilat janë të dënueshme, por jo të njollosen të gjithë dhe në nenet të cilat ju kanë mbetur, aty ka mjaft mundësi që të sillni reforma, por jo në ligj të paraqiten paragjykime për mjekët, të cilët vërtet nuk stimulohen aq shumë sa duhet dhe nuk janë politikat e bazuara kuadrore mbi nevojat e patologjive të shprehura në Republikën e Kosovës.

KRYESUESI: Deputeti Haxhiu, dy minuta, e ka fjalën.

BEKIM HAXHIU: Faleminderit, i nderuari kryesues!

I nderuar ministër,

Do të provoj t'i shfrytëzoj këta dy minuta, edhe pse shumë çështje u thanë. Jo vetëm unë, por thënë të drejtën të gjithë punëtorët shëndetësorë, edhe qytetarët e Republikës së Kosovës kanë pritur shumë më shumë nga ministri aktual, Ferid Agani.

Ajo çka duket hapur është se krejt fokusi i Ministrisë është orientuar në Ligjin për shëndetësi dhe kjo konsiderohet që të jetë edhe baza e reformës në shëndetësi, e me këtë rast janë anashkaluar shumë probleme reale në shëndetësi. Kuvendi i ka dhënë dritën jeshile, dritën e gjelbër në fakt këtij ligji edhe ligji ka mbetur në Gjykatën Kushtetuese apo ka ngecur atje për shkak të nenit 41, i cili në fakt ka qenë edhe propozim i vetë Ministrisë.

Ministria e Shëndetësisë, marrë në tërësi, mund të quhet edhe Ministria e UD-së, apo Ministria e ushtruesve të detyrave, sepse tani më shumë se dy vjet drejtorë të shumtë në QKUK dhe në spitalet rajonale, vazhdojnë të mbesin ushtrues të detyrave. Kur shihet se tani edhe një vit e gjysmë edhe sekretarin permanent Ministria e Shëndetësisë e ka ushtrues të detyre, atëherë mund të thuhet lirisht se Ministria e Shëndetësisë lëngon nga sindroma e UD-së, apo sindroma e ushtruesit të detyrave.

Problem tjetër, të nderuar kolegë deputetë, e tha shumica e kolegëve këtu, që merren me këtë sferë, është mungesa e Ligjit për sigurime shëndetësore. Mungesa e këtij ligji ka bërë që të ngecin zhvillimet në këtë sektorë dhe ky të jetë njëri nga problemet kryesore të ngecjes së zhvillimit të shëndetësisë, ndërsa problemet tjera në këtë segment janë kryesisht probleme menaxhuese, etike, profesionale dhe këto probleme po mendoj se do të duhej të fillonin në aspektin menaxhues nga vetë Ministria e Shëndetësisë, duke pasur parasysh që shumë probleme burojnë nga vetë Ministria dhe pastaj ato mund të transferohen në probleme tjera.

Gjithsesi këtë interpelancë nuk mund ta tejkalojmë pa e theksuar dhe përmendur problemin...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Ferati e ka fjalën.

SADRI FERATI: Faleminderit kryesues!

Të nderuar ministra,

Të nderuar kolegë,

Meqë u tha mjaft, unë do ta reduktoj fjalimin tim në atë pjesën argumentuese, por do të jap disa konstatime që unë mendoj se qëndrojnë në bazë të njohurive të mëhershme, por edhe bazuar në debatin që u tha. Është për keqardhje që shëndetësia nuk është akoma prioritet i qeverisjes. Është folur edhe vite më herët, sikur të gjithë e kanë parë të arsyeshme që krahas arsimit, infrastrukturës dhe disa fushave tjera, sikur janë pjekur kushtet që shëndetësia të vijë dhe të shndërrohet në një prioritet. Çka do të kishim nënkuptuar me këtë? Një mbështetje më e fuqishme për Ministrinë, për kushtet e punës, për personelin mjekësor dhe kushtet në infrastrukturë dhe në pajisje.

Unë nuk kam vërejtje në përkushtimin që e prezantoi ministri më herët, e edhe sot, mirëpo unë besoj që edhe ministri, edhe të gjithë ata të angazhuar në proces, do të mund ta kuptojnë se deri tash kjo është e pamjaftueshme dhe për këtë periudhë kohore nuk janë prodhuar rezultatet, të cilat, edhe ata, edhe ne i dëshirojmë. Ka shumëçka që do të mund të diskutohet dhe të faktohet në shëndetësi dhe në një optimum që do të ishte dashur të jetë krijimi i kushteve, prioritetet, si dhe përkujdesja për pacientin dhe për qytetarin, e kjo është ajo për të demonstruar se cila është fuqia e Kosovës në mbështetje të kësaj fushe.

Përndryshe, nuk shoh ndonjë dallim të madh që të marrim dhe të diskutojmë edhe për shumë fusha tjera në Kosovë, siç është: sundimi i ligjit, zhvillimi ekonomik në rend të parë, por edhe arsimi, ndërmarrjet publike dhe të tjera. Pra, edhe shëndetësia bën pjesë, në njëfarë forme, në mungesë të mbështetjes dhe të një pune sistematike dhe prandaj i kemi këto probleme me një përkushtim dhe paralajmërimi i reformave, i ndryshimeve dhe ligji është vetëm njëri prej hapave, të cilët shëndetësinë e çojnë përpara.

Prandaj, duke i parë të gjitha këto probleme dhe gjithë kjo që u tha, unë mendoj se Kosova, në rend të parë, duhet ta japë një përgjigje. Ka ardhur koha, janë pjekur kushtet që shëndetësia të jetë një prej prioriteve të para të shoqërisë kosovare dhe pastaj të shtrojmë detyra e strategji që të shkohet më tutje. Unë mendoj se, sot për sot, akoma, deri dje një fushatë, dikujt i duhen votat, mund të konstatojmë dhe për këtë e mora fjalën - për të konstatuar edhe një herë - Qeveria e Republikës së Kosovës akoma nuk po dëshmon se shëndetësia duhet të jetë një prej prioriteve në mbështetje. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Nuk ka diskutime tjera. Fjalën e ka zoti Agani, në qoftë se e dëshiron fjalën për përfundim. Ministri Agani e ka fjalën.

MINISTRI FERID AGANI: Faleminderit, zoti kryesues!

Unë e shfrytëzoj rastin të ju falënderoj të gjithë udhëheqësit e grupeve parlamentare, deputetët që morën pjesë në këtë interpelancë, në këtë debat. Mendoj se i kemi ndriçuar

aspektet e ndryshme të sistemit shëndetësor, edhe ato aspektet negative, me të cilat nuk jemi të kënaqur asnjëri prej nesh, por edhe aspektet pozitive të zhvillimeve. Këto procese janë paralele, janë procese të natyrshme të një procesi në tranzicion, të një tranzicioni edhe ekonomik, edhe politik, themi, edhe social të vendit. Është shumë e natyrshme që njëkohësisht të bashkëjetojnë edhe idetë kreative, edhe projeksionet, edhe vizionet, por edhe vështirësitë aktuale me të cilat ballafaqohemi.

Unë jam shumë i përkushtuar që shëndetësinë ta bëjmë prioritet të Qeverisë së Kosovës. Angazhimi im në këtë drejtim nuk ka munguar asnjëherë dhe nuk do të mungoj dhe këtu e pres edhe mbështetjen, edhe të Kuvendit në mënyra të ndryshme, dhe kjo mbështetje nuk ka munguar dhe e falënderoj edhe për këtë.

Një reformë e sistemit shëndetësor, ose më mirë të themi një Ligj i shëndetësisë, i cili e projekton këtë reformë, i cili i projekton odat e profesionistëve shëndetësorë, organet inekzistente, shërbimin spitalor klinik Universitar të Kosovës, institucion inekzistent, shërbimet kombëtare të linjës brenda këtij institucioni shëndetësor, fondin e sigurimeve shëndetësore. Kjo reformë është shumë përmbajtjesore, shumë e thellë, shumëdimensionale dhe ajo e ka kërkuar një punë serioze përgatitore. Për fatin e keq të atyre që kanë dashur ta ruajnë status quo-n dhe ta vazhdojnë këtë gjendje, këtë amulli të shëndetësisë kosovare, reforma ka nisur. Ajo nuk mund të ndalet më, është në binarë të shëndoshë dhe duke pasur parasysh Ligji i sigurimeve shëndetësore do të vijë shumë shpejt, pas zbatimit të Ligjit të shëndetësisë, do të jemi në gjendje edhe ta shohim, ta prekim këtë reformë.

Ju e dini se në këtë Kuvend ka pasur edhe dilema kur ishin pyetja odat e profesionistëve shëndetësor. Çka janë këto? Pra, ka shumë çka të panjohur si duket në këtë reformë. Ky është një indikator për Ministrinë e Shëndetësisë që ne kemi nevojë edhe më tepër t'i sqarojmë këto gjëra në komunikim të drejtpërdrejtë, edhe në një dialog, në mënyrë që ta kuptojmë esencën e ndryshimeve në të cilat po hyjmë.

Të jeni të bindur që objektivi kryesor i reformës do të jetë qasja universale e qytetarëve. Edhe ajo që jemi duke bërë sot me shfrytëzimin e mjeteve për trajtim jashtë institucioneve publike shëndetësore, ku këto mjete janë vënë në dispozicion të njerëzve që janë në gjendje emergjente, që e kanë rrezik jetën, të gjitha shtresave sociale, me prioritet atyre më të ulëta, shkon në këtë drejtim. Prandaj, nuk kam dëshirë që të kemi paragjykime rreth ndryshimeve në të cilat po hyjmë.

Është bërë një punë jashtëzakonisht e madhe, janë identifikuar edhe problemet ekzistuese, jemi duke punuar për t'i tejkaluar edhe këto probleme, mirëpo duhet pasur parasysh që kur vlerësoni, veçanërisht kur ta vlerësoni menaxhmentin e lartë të Ministrisë, t'i keni parasysh rrethanat konkrete, reale, me të cilat Ministria e Shëndetësisë, Kabineti politik ka disponuar sa i përket Administratës Shtetërore në këtë ministri, për arsye që nuk kanë të bëjnë me këtë kabinet fare.

Unë jam shumë i përkushtuar që ta vazhdojmë punën e përbashkët në zbatimin e këtyre ndryshimeve, duke i parandaluar të gjitha ato aspekte negative që u përmendën me qëllim

të mirë, jam i bindur. Dhe, jam shumë i bindur që ky sistem i ri shëndetësor i vendit, të cilin po e ndërtojmë, do të jetë sistem i cili do të jetë në gjendje të gjenerojë të hyra financiare, të cilat do t'i shfrytëzojë për avancimin e resurseve njerëzore dhe teknologjike të vetë sistemit shëndetësor dhe, në këtë mënyrë, Qendra Klinike Universitare të Kosovës, që sot u përmend aq shumë për të keq dhe e harruam fare kujdesin parësor shëndetësor, i cili është duke e bërë një punë të shkëlqyeshme në rrethana jo fort të volitshme. Por, Qendra Klinike Universitare e Kosovës do të shndërrohet brenda këtij sistemi në një partner kredibil edhe për institucionet financiare, të sigurimeve shëndetësore të Perëndimit, ku kemi afro 1 milion kosovar që jetojnë e punojnë dhe janë të siguruar dhe këto mjete financiare nga Perëndimi do të mund të kanalizohen në shërbimet shëndetësore që do të ofrohen nga Qendra Klinike Universitare e Kosovës.

Nga këta 279 mjekë, më së paku të rinj që janë punësuar në vitin e fundit, e shumë të tjerë që do t'i punësojmë, sepse në të ardhmen nuk do të ketë nevojë asnjë institucion shëndetësor në nivel dytësor e tretësor të marrë leje nga Ministria e Shëndetësisë që ta punësojë një mjek ose një infermiere, por do të ketë mundësi që të gjenerojë të hyra financiare dhe ta zhvillojë veten, natyrisht krahas mbështetjes nga Buxheti i Kosovës për pakon themelore të kujdesit shëndetësor.

Këto ndryshime janë tejet të mëdha. Unë jam shumë i kënaqur si ministër që kemi arritur për këto dy vjet ta sjellim shtetin tonë në këtë pikë, në të cilën them se mund të shpresojmë se do ta kemi një lëvizje pozitive. Kjo është një pikë e shpresës. Nuk kryhet puna me miratimin e ligjit, as të Ligjit të sigurimeve shëndetësore, por ky është një proces, në të cilin duhet investuar vazhdimisht dhe atë jo një parti politike, se nuk kemi ne aq shumë ekspertë shëndetësorë. I kemi të shpërndarë nëpër partitë e ndryshme politike. Ka nevojë për bashkëpunim, për koherencë, për punë kolektive dhe shpresoj që momenti i hyrjes në fuqi të Ligjit të shëndetësisë do të paraqesë edhe moment të bashkimit të resurseve profesionale e shkencore në drejtim të implementimit të tij të suksesshëm.

Ministria e Shëndetësisë do të vazhdojë me përkushtim të punojë në këtë drejtim dhe unë jam i hapur dhe me kënaqësi do ta pres çfarëdo kërkesë tjetër për interpelancë, ose për një debat, por jo para fundit të vitit, në mënyrë që t'i shohim ndryshimet, sepse vetëm ndryshimet reale e konkrete në fushë, do të jenë ato që do të flasin vetë, e nuk do ta mundim njëri-tjetrin me fjalë, ose nuk do ta pengojmë debatin, ose ta shtyjmë iniciativën me paragjykime. Më së paku kemi nevojë për këtë në këtë moment.

Edhe një herë ju falënderoj shumë për debat dhe kisha sugjeruar që kur janë në pyetje këto tri rekomandime të dhëna, se rekomandimi i parë dhe i tretë janë rekomandime të cilat nuk kanë, për mendimin tim, ndonjë efekt konkret, i cili do të ndikoj ënë përmirësimin e punës së Ministrisë së Shëndetësisë. Fillimisht, rekomandimi numër 1 është në kundërshtim me Ligjin e shëndetësisë.

Parashtruesit e kërkesës me siguri kanë mbajtur shpresë se do të miratohet tërë ankesa në Gjykatën Kushtetuese dhe do të rrëzohet reforma, por kjo nuk ka ndodhur, prandaj unë e thashë edhe një herë, Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës i Shërbyesve Civilë nuk do ta

mbikëqyrë më zgjedhjen e drejtorëve të klinikave që Qendra Klinike Universitare të Kosovës dhe nuk ka kuptim që një rekomandim i tillë të miratohet.

Te rekomandimi i tretë, Ministria e Shëndetësisë është e përkushtuar për ta zbatuar ligjshmërinë dhe jemi të përkushtuar në vazhdimësi, madje në qoftë se i shikoni vlerësimet e Organit të Shqyrtimit të Prokurimit Publik dhe Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik, e shihni se është njëra prej ministrive më të disiplinuar, prandaj nuk ka ndonjë vlerë të veçantë që një rekomandim i tillë të miratohet.

Kur është në pyetje Ligji i sigurimeve shëndetësore është e drejtë juaja politike për ta bërë këtë kërkesë, por unë po ju them se Ligji i sigurimeve shëndetësore do të procedohet në Qeverinë e Kosovës për miratim pas dakordimit paraprak me Bankën Botërore dhe Fondin Monetar Ndërkombëtar. Ligji është i shkruar në pjesën më të madhe. Ende kanë ngelur disa dispozita që mund të akordohen sa i përket mënyrës së mbledhjes së premiumit të sigurimeve shëndetësore, por kjo është diçka që e kemi përpara. Pra, ligji është i shkruar dhe askush në këtë sallë më shumë se unë, si ministër, nuk ka dëshirë që atë ligj të jua sjellë për miratim, sepse e kuptoni edhe vetë për çfarë arsye. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka zonja Kadrijaj. Ju lutem të mos dilni nga salla dhe t'i thirrni kolegët nëse janë jashtë.

TIME KADRIJAJ: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar deputetë,

Ju falënderoj shumë për kontributin e dhënë në këtë debat sot për shëndetësinë dhe më duket se të gjithë u dakorduat që gjendja në shëndetësi është mjaft e rëndë.

Ministër, po flisni për reforma, dhe ne po i presim këto reforma, sepse të gjithë jemi për një shëndetësi të nivelit të lartë dhe për shërbime cilësore, por çka deri në arritjen e këtyre reformave? A mund të presin pacientët për të marrë shërbime cilësore dhe në objektet e tilla derisa të vijmë reformat? Jo. Për të vënë pak rregull në institucionet shëndetësore, nuk nevojitet vetëm buxhet, por nevojitet edhe një menaxhim i mirë i institucioneve shëndetësore.

Unë mund ta marr një shembull të mirë të menaxhimit të mirë të institucioneve shëndetësore në Qendrën Klinike Universitare, përkatësisht Stomatologjinë, e cila pavarësisht se Ministria e Shëndetësisë nuk e ka sistemin e informimit, ata aq mirë e kishin menaxhuar klinikën e tyre, sa funksiononte edhe sistemi i menaxhimit. Prej bodrumit, nëse e bënë një rëntgen të dhëmbit, me automatizëm shkonte në dhomën e mjekut dhe aty nuk kishte nevojë për të bartur filmat e rëntgenit, për t'i dërguar te mjeku, sepse ato me automatizëm shkonin te ai dhe ti shkoje i merrje ato shërbime cilësore.

Të nderuar deputetë dhe ministër, teksti i mocionit është ky:

- Ne kërkojmë të zbatohen ligjet që janë në fuqi, nuk kërkojmë asgjë jashtë ligjeve, por vetëm zbatimin e tyre;

- Zbatimi i vendimeve të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për konkursin e Qendrës Klinike Universitare dhe për zyrtarë të lartë në Ministrinë e Shëndetësisë, që janë edhe specializantë;

- Sa më shpejt të sillet në Kuvendin e Kosovës Ligji i sigurimeve shëndetësore, për të cilin sot na fole me orë të tëra dhe po e presim, sepse është Ligji i reformave;

- Të respektohet Ligji i menaxhimit të financave publike, sidomos procedurat e tenderimit, sepse nga KDI-ja Ministria e Shëndetësisë është cilësuar, institucioni ku shkelet më së shumti ky ligj për shkak të aferave korruptive;

- Të raportohet në seancat e rregullta gjendja e sistemit të informimit shëndetësor, gjendja e agjencisë së financimit, gjendja e planifikimit të kuadrove, gjendja e një sistemi shëndetësor primar, sekondar, terciar dhe gjendja në Agjencinë e Produkteve Medicinale dhe Barnave. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Sidoqoftë, unë po them, sepse është bërë praktikë edhe në debate, edhe në interpelanca, sa të vijmë me mocione dhe me rekomandime, të cilat nuk kalojnë gati asnjëherë nëpërmjet komisioneve profesionale të Kuvendit. Do të ishte mirë që ndoshta në të ardhmen ta japin mendimin e komisionet përkatëse për përputhshmërinë e rekomandimeve me ligjet tona dhe me Kushtetutën.

Në sallë i kemi 62 deputetë. Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tash!

(Reagime)

Po, zoti Reçica, në emër të grupit. Në emër të grupit bën, në emër të vetin jo.

ELMI REÇICA: Faleminderit, zoti nënkryetar!

Të nderuar ministra,

Të nderuar kolegë deputetë,

Unë kisha kërkuar që të tërhiqen edhe propozuesi dhe të merren vesh me përfaqësuesit e grupeve parlamentare, përndryshe Grupi Parlamentar i PDK-së nuk mund t'i votojë këto rekomandime. Nëse duam vërtet ta ndihmojmë shëndetësinë, kisha kërkuar që ato të tërhiqen dhe pas pauzës të votojmë.

KRYESUESI: Debati ka përfunduar dhe nuk janë tërhequr. Është e drejta për të votuar secili sipas Rregullores. Edhe një herë. Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tash! Faleminderit!

Konstatohet se me 31 vota për, 18 kundër, dy abstenime, Kuvendi e miratoi mocionin e propozuar nga deputetja Time Kadrijaj dhe grupi i deputetëve nënshkrues.

(Reagime)

Ju lus, mos u largoni se jemi në seancë. Nuk e kam përfunduar seancën.

(Reagime)

Zoti ministër, nuk je i detyruar t'i zbatosh rekomandimet që janë në kundërshtim me ligjin. Ato nuk zbatohen. Nuk vlejnë! Zoti ministër, gjithçka që është në kundërshtim me ligjin, asnjë rekomandim nuk duhet të zbatohet. Ky është parim. Asnjë rekomandim që është në kundërshtim me ligjin nuk je i obliguar ta zbatosh. Kjo është përfundimtare gjithmonë për secilin prej nesh.

E kemi pikën e pestë të rendit të ditës, por para se të hyjmë në të, zoti Hamiti dëshiron ta marrë fjalën.

SABARI HAMITI: Faleminderit, zoti kryesues i kësaj seance, Haliti!

Unë u paraqita për rend dite. Unë mendoj që nëse, po them nëse, pika e pestë shtyhet siç kemi kërkuar na LDK-ja, për arsye se konsideron që ligji nuk është kushtetues, atëherë nuk ka arsye ta ndërpresim mbledhjen, meqë kemi forum, sepse i kemi dy lexime të dyta dhe një votim që shkojnë shpejt dhe, nëse ne shkojmë në pushim, kthehemi vonë pastaj. Unë kisha thënë që nëse votohet për shtyrje pika e parë, të kthehet, e pesta ka mundësi...

KRYESUESI: Ju lus, të nderuar deputetë, mos dilni për një minutë, që ta votojmë propozimin. Është një mocion. LDK-ja e ka një mocion që të shtyhet pika e pestë e rendit të ditës, e në qoftë se shtyhet kjo, besoj që për një kohë të shkurtër i miratojmë edhe dy pikat tjera dhe e përfundojmë që të mos mbetemi edhe pasdite në seancë.

Atëherë zoti Hamiti, a jeni dakord që të vendosim ta shtyjmë për mbledhjen e ardhshme, meqenëse as ministrja nuk është këtu? Ashtu, është më mirë ta lëmë për mbledhjen e ardhshme, kur vjen ministrja, meqenëse ajo nuk është që të na e prezantojë ligjin këtu, dhe të mos futemi në votim...

(Reagime)

..., e shtyjmë, vendosim për mbledhjen e ardhshme. Unë po mendoj se më e arsyeshme është që ta shtyjmë dhe ju ta keni të drejtën që ta bëni mocionin prapë në mbledhjen e ardhshme. A jeni dakord që ta shtyjmë për mbledhjen e ardhshme? Dakord.

Atëherë konstatoj që pika e pestë shtyhet për mbledhjen e ardhshme.

Pika e gjashtë e rendit të ditës:

6. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për administrimin e punës në zyrë

Komisionet parlamentare e kanë shqyrtuar Projektligjin për administrimin e punës në zyrë dhe Kuvendit i kanë rekomanduar miratimin e tij.

E ftoj kryetarin e Komisionit Funkcional për Arsim, Kulturë, Rini, Sport, Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media, deputetin Vehapi, që ta arsyetojë raportin me rekomandime.

IDRIZ VEHAPI: Faleminderit, zoti nënkryetar i Kuvendit,
Të nderuar deputetë,

Komisioni FunkSIONAL e ka shqyrtuar projektligjin, po ashtu këtë projektligj e kanë shqyrtuar edhe komisionet e përhershme të Kuvendit të Kosovës. Projektligji nuk përmban amendamente, prandaj kërkoj nga deputetët që të miratohet projektligji me nenet, të cilat janë si bazë propozuese. Faleminderit!

KRYESUESI: Ju lus që ta votojmë praninë, ose thirrni dikush të tjerët. I kemi 57 deputetë. Pesë minuta nuk po kanë durim që qëndrojnë, ç'është kjo punë kështu?!

Votojmë për praninë. Votojmë tash! Dy janë më pak. A ka pa kartelë? Votojmë edhe një herë edhe një herë për prezencë. Votojmë tash.

Regjia, edhe një herë votimin. Votoni, ju lutem! Në rregull, në sallë janë 64 deputetët, me elektronikë 61.

Votojmë tani për projektligjin. Faleminderit!

Konstatohet se me 61 vota për, asnjë kundër asnjë abstenim, Kuvendi e miratoi Ligjin për administrimin e punës në zyrë.

Pika e shtatë e rendit të ditës:

7. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për provimin e jurisprudencës

Komisionet parlamentare e kanë shqyrtuar Projektligjin për provimin e jurisprudencës dhe Kuvendit ia kanë rekomanduar miratimin e tij me amendamentet e propozuara. E ftoj kryetarin e Komisionit FunkSIONAL për Legjislacion, deputetin Arben Gashi. Nuk qenka është këtu. Dikush tjetër nuk ka çfarë të thotë për këtë ligj.

Shkojmë në votimin e amendamenteve.

Amendamenti 1.

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 2.

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 3.

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 4.

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 5.

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 6.

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 7.

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 8.

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 9.

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 10.

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 11.

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 12.

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Votojmë tekstin e Projektligjit në tërësi me amendamentet e miratuara. Lus deputetët të përgatiten për votim. Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tash!

Në sallë janë të pranishëm 64 deputetë, me elektronikë 91, për kanë votuar 52, 8 kanë abstenuar, asnjë kundër. Konstatohet që Kuvendi e miratoi Ligjin për provimin e jurisprudencës.

Atëherë, pika e tetë:

8. Zgjedhja e një anëtari të Komisionit për Kërkesa Pronësore

Propozimin e kryetarit të Gjykatës Supreme të Kosovës për emërimin e një anëtari të Komisionit për Kërkesa Pronësore e ka shqyrtuar Komisioni Funkcional për Legjislacion dhe ia ka rekomanduar Kuvendit për miratim.

E dëshiron fjalën dikush në emër të Komisionit? Jo. Shefat grupeve parlamentare, dëshironi ta thoni mendimin lidhur me propozimin? Jo. Deputetët? Jo.

Vazhdojmë me votimin e propozimit të kryetarit të Gjykatës Supreme për emërimin e zotit Adem Vokshi anëtar i Komisionit për Kërkesa Pronësore. Në sallë janë 63 deputetë. Ju lus të përgatiteni për votim. Votojmë tash!

Konstatohet se me 37 vota për, 18 kundër, 1 abstenim, Kuvendi e emëroi anëtarin e Komisionit për Kërkesat Pronësore, Adem Vokshi, me mandat njëvjeçar.

Me kështu, konstatohet që seanca e sotme mbyllet. Mirupafshim në seancën e ardhshme!

E përgatiti:
Njësia për Transkriptim dhe Lekturë